Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0028437/24
Data 20.06.2024

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

# *THËRRET*

**Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj,** e cila do të mbahet me datë **28.06.2024,** (ditë e premte), me fillim prej orën **10:00**, në Sallën e Kuvendit

**Mbledhja do të ketë këtë:**
**REND DITE**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2025-2027, dhe Raporti i Kryetarit të Komunës mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in, me Nr.04-052/01-0027698/24, i datës 13.06.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
4. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj, me Nr.02-110/01-0027864/24, i datës 14.06.2024, (Raporton drejtoresha e DSHMS-së, **znj. Rrezarta Hasani-Ibrahimi**);
5. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planin Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028, në Komunën e Skenderajt, me Nr.02.110/01-0027865/24, i datës 14.06.2024, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z. Alban Shala**);
6. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Rregullores Komunale për kushtet dhe mënyrat e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë në Komunën e Skenderajt, me Nr.02.110/01-0027862/24, i datës 14.06.2024, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z. Alban Shala**);
7. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit të Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027, në Komunën e Skenderajt, me Nr. 02-110/01-0027863/24, i datës 14.06.2024, (Raporton drejtoresha e DZHENIT-së, **znj. Besarta Meha-Ademi**);
8. Raport i Ndërmarrjes Komunale NPL, "Eko Natyra" SH.A. Skenderaj, për vitin 2023, me Nr.001-023/24-007, i datës 27.02.2024, (Raporton Aksionari i Ndërmarrjes **z. Behxhet Maliqi**);
9. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E SKENDERAJT / KUVENDI I KOMUNËS / REPUBLIC OF KOSOVA / MUNICIPALITY OF SKENDERAJ / REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA OPŠTINA

**KRYESUESJA E KUVENDIT**
znj. Adelina Spahiu
A. Spahiu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPSTINE
SKENDERAJ
Nr. No. 04-052/01-0027698/24
Data 13. 06. 2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor**

# KORNIZA AFATMESME E BUXHETIT 2025-2027

*Qershor 2024*

**Përmbajtja:**

Korniza Afatmesme e Buxhetit 2025-2027 ........ 1
Hyrje ........ 3

OBJEKTIVAT 2025-2027 ........ 4

KORNIZA FISKALE E KOMUNËS ........ 6

STRATEGJIA ZHVILLIMIT EKONOMIKO LOKAL ........ **Error! Bookmark not defined.**7

1. Zhvillimi ekonomik ........ 8

2. Arsimi, kultura, rinia e sporti ........ 9

3.Shëndetësia dhe mirëqenia sociale ........ 9

4. Shërbimet Publike ........ 10

TË HYRAT BUXHETORE ........ 11

Parashikimi i shpërndarjes së mjeteve buxhetore në kategori ekonomike për vitin 2025-2027 ........ 17

Parashikimi i të hyrave komunale (transferet qeveritare+ të hyrat vetanake) ........ 11

Plani i THV-ve për tri vitet e ardhshme: ........ 15

Buxheti 2025-2027 dhe Shpernadarja e tij sipas kategorive ekonomike

Programi i investimeve publike (PIP) ........ 17
PERFORMANCA E DREJTORIVE TË KOMUNËS: ........ 20

Zyra e Kryetarit ........ 20

Kuvendit Komunal ........ 21

# 1.Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore është dokumenti kryesor bazë i buxhetit për vitin 2025 dhe vlerësimet për dy vitet 2026-2027. Në marrëdhënjet fiskale ndërqeveritare ky dokument pasqyron kufijtë e përgjithshëm të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike dhe programeve për t'i përmbushur objektivat e përcaktuara nga Strategjitë zhvillimore komunale.

Korniza Afatmesme Buxhetore ( KAB), që po prezantojmë është një dokument i cili azhurnohet dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe të hyrave dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor dhe vlerësimet për dy vitet në vijim. Gjithashtu, KAB siguron mekanizmat e nevojshme përmes të të cilave objektivat prioritare të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës dhe integrohen në procesin buxhetor.

Hartimi i KAB-t bazohet në :

- Ligjin për financat e pushtetit lokal;
- Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale;
- Ligjin për kufijtë administrativë komunalë;
- Ligjin e buxhetit dhe
- Qarkorja Buxhetore 2025/01 e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve dhe të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2025-2027 gjithnjë duke u bazuar edhe në stategjinë e zhvillimit ekonomik lokal dhe planin zhvillimor komunal.

Janë tri faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



# 2.OBJEKTIVAT 2025-2027

Është e qartë tashmë se dokumenti Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) si një version i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), ka të përcaktuara edhe objektivat e saja, qëllim kryesorë ka krijimin e bazës për përgatitjen e buxhetit në këtë rast buxhetin për tri vitet e ardhshme 2025-2027, gjithashtu përkufizon kufijtë e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme dhe vënë kontekstin e vendosjes së shpenzimeve në sektor të caktuar.

Procesi buxhetor komunal gjatë hartimit të tij merr në konsideratë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Projektet kapitale shumëvjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë.

Objektivat e KAB të Komunës tonë janë:

- Hartimi i një procesi të mirëfilltë buxhetor nga i cili do të rezulton një planifikim buxhetor të qëndrueshëm për vitin 2025 dhe vlerësimet e dy viteve fiskale në vijim;
- Zhvillimi, promovimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës në të gjitha sferat e saja;
- Të sigurohet një planifikim real i shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore;
- Zhvillimi ekonomik, në të gjitha fushat,
- Përmirësimi i ambientit për të jetuar, arritja e standardeve;
- Avancimi i shërbimeve shëndetësore;
- Avancimi i zhvillimit të sistemit arsimor;
- Avancimi i zhvillimit të kulturës dhe sportit;
- Përkrah dhe ndihmojë zhvillimin e biznesit;
- Subvencionimet në bujqësi;
- Mirëmbajtja e hapësirave publike;
- Intensifikimi i kërkesave për përkrahje nga niveli Qendror etj.

## PRIORITETET E QEVERISË:

Objektivat strategjike të Qeverisë për buxhetin e vitit 2025 dhe projeksionet buxhetore për vitet 2026 dhe 2027 janë përcaktuar nëpërmjet Programit të Qeverisë, në dokumentet si: Programi i Qeverisë 2021-2025, Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillim 2030, Programi për Reforma në Ekonomi 2024-2026, si dhe Plani Kombëtar për Integrime Evropiane, janë dokumentet kryesore që përcaktojnë orientimin dhe zhvillimin e politikave qeveritare dhe sigurojnë bazën për përcaktimin e prioriteteve të politikave të përfshira në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2025-2027.

Zbatimi i prioriteteve të këtyre dokumenteve do të përbëjë pjesën më të madhe të kornizës fiskale që qeveria do të ndërmarrë me qëllim të ndërtimit të sistemit të qëndrueshëm të financave publike në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, të cilat sigurojnë rritje dhe zhvillim ekonomik dhe mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët. Kjo do të arrihet nëpërmjet vazhdimit të ri-dizajnimit të politikave fiskale, avancimit në menaxhimin e financave publike dhe sistemit financiar që sigurojnë llogaridhënie.

Me qëllim të formalizmit të ekonomisë, do të vazhdohet të punohet në drejtim të përmirësimit të mekanizmave inspektues për luftimin e evazionit fiskal dhe ekonomisë jo formale, me qëllim të sigurimit të konkurrencës së drejtë dhe të barabartë.

Implementimi i Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2022-2026, synon të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së financave publike. Aktualisht, është duke u hartuar Ligji i ri për Menaxhimin e Financave Publike, përmes të cilit synohet të adresohen një sërë sfidash dhe problemesh dhe të bëhet rregullimi i duhur ligjor në këtë fushë.

Fushat prioritare të Qeverisë të cilat duhet të fokusohet komuna për akomodimin e buxhetit për përiudhën 2025-2027 janë:[1]

1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik,
2. Zhvillimi i barabartë njerëzor,
3. Siguria dhe sundimi i ligjit dhe
4. Qeverisja e mirë,

[1] KASH 2025-2027 faqe 8-9

# 3.KORNIZA FISKALE E KOMUNËS

Konform përcaktimeve ligjore çdo organizatë buxhetore ka kornizën e saj fiskale mbi bazën e së cilës krijon të hyrat vetanake si njëra ndër burimet e financimit të buxhetit të Komunës. Seksioni mbi kornizën fiskale përbën elementin e parë të procesit që të dërgon në drejtim të përcaktimit të objektivave fiskale të komunës për periudhën e tri viteve të ardhshme.

Pra edhe pse komuna nuk e udhëheq drejtpërdrejt politikën makroekonomike, mjedisi i përgjithshëm ekonomik do të ndikojë në pasqyrën fiskale të komunës dhe si i tillë duhet trajtuar në këtë kornizë. Komponentët e politikës makroekonomike siç janë BPV pastaj inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh komuna në parashikimet e saj fiskale. Në këtë drejtim komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e rishikimit të politikës apo kornizës fiskale të komunës aty ku vlerësohet se ka hapësirë, duke ndërhyrë në rregulloret e brendshme të cilat do të jenë padyshim në funksion të rritjes së efikasitetit dhe të ardhurave të bizneseve, po ashtu rritje të trendit të të hyrave vetanake.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal

| *Përshkrimi* | *2024 (aktual)* | *2025* | *2026 (vlerësimi)* | *2027 (vlerësimi)* |
|---|---|---|---|---|
| **Indikatorët ekonomik komunal** | | | | |
| Popullësia e Komunës | 50,858 | 50,858 | 50,858 | 50,858 |
| Numri i bizneseve aktive që janë duke operuar | 670 | 700 | 720 | 750 |
| Numri i nxënësve | 8,248 | 8,101 | 7,850 | 7,750 |

Me Qarkoren Buxhetore 2025/01 komuna jonë ka pranuar kufijtë fillestar të financimit për Buxhetin e vitit 2025 si dhe vlerësimet 2026 dhe 2027, në kuadër të cilit ne kemi edhe planifikimin e të hyrave vetanake të bazuar në parametrat fiskal si dhe në performancën e inkasimit të kërkesave në të gjitha llojet e të hyrave.

# 4. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIKO-LOKAL

(prioritet strategjike zhvillimore)

Komuna e Skenderajt ka hartuar dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024-2028 si një projekt tejet i rëndësishëm për projektimin afatmesëm të zhvillimit të komunës tonë. Megjithatë trajtimi i SZHL-së në përmbajtjën gjenerale te dokumenti i KAB-it është mëse i domosdoshëm. Pra është e domosdoshmëri që të veprojë brenda një kornize të përgjithëshme (plani strategjik), në të cilën përcaktohen politikat dhe prioritetet afatgjata dhe afatmesme. Korniza Afatmesme Buxhetore shërben si një mjet për të trajtuar prioritetet e konsumit buxhetor të planeve të zhvillimit strategjik të cilat do të përfshihen në buxhetin e komunës për të realizuar atë gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare 2024-2028.

Një prej çështjeve më të rëndësishme në kuadër të kornizës afatmesme buxhetore është vendosja e prioriteteve zhvillimore duke pasur parasyshë parimin e kontinuitetit në investime kapitale me kornizën buxhetore, 2024-2028. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Skenderajt përfshinë një qasje të gjithanshme dhe largpamëse për të adresuar sfidat dhe mundësitë unike me të cilat ballafaqohet komuna. Duke diversifikuar bazën ekonomike, duke promovuar turizmin, duke angazhuar rininë, duke përmirësuar administratën dhe shërbimet publike dhe avancimin në zhvillimin kulturor dhe sportiv. Strategjia do të zbatohet përmes një sërë projektesh, nismash dhe partneriteteve.

Misioni:

Misioni Misioni ynë është që përmes shërbimeve sa më kualitative maksimalisht dhe në mënyrë sa më efikase t'i plotësojmë nevojat që presin qytetarët e Skenderajt dhe të gjithë atyre të cilët janë drejtuar komunës së Skenderajt, para se gjithash t'i plotësojmë të gjitha kërkesat ligjore dhe të tjera të gjitha palëve të interesuara.

Vizioni :

Vizioni ynë është që të jemi komuna e cila punon në pikëpamje kualitative të jetës së qytetarëve tonë, zhvillimin e ekonomisë dhe punësimin, sigurinë e qytetarëve, sigurimi i infrastrukturës.

Prioritetet Komunale :

Janë të identifikuara katër prioritetet e përgjithëshme zhvillimore të KAB-it të cilat burojnë nga Strategjia e Zhvillimit ekonomik lokal e që janë:

- Zhvillimi Ekonomik
- Zhvillimi i Turizmit
- Angazhimi i të rinjve dhe Zhvillimi i Edukimit dhe Aftësive
- Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
- Kujdesi Shëndetësor dhe Mirëqenies Sociale
- Zhvillimi i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
- Zhvillimi i Administratës dhe Shërbimet Publike
- Zhvillimi i Infrastrukturës Publike dhe Zhvillimi Urban

## a. ZHVILLIMI EKONOMIK

Objektivi parësorë i qeverisë tonë lokale mbetet zhvillimi ekonomik, komponentë zhvillimore e cila mundëson arritjen e realizimit të misionit institucional i cili ka të bëjë me ngritjen e mirëqenies qytetare. Komuna ka hartuar dhe ka aprovuar "Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024-2028", Strategjia e zhvillimit ekonomik për Komunën e Skenderajt fokusohet në rritjen e rrjedhave të ardhurave, zhvillimin e turizmit, nxitjen e sipërmarrjes dhe inovacionit dhe tërheqjen e investimeve. Këto nisma janë të ndërlidhura dhe krijojnë një qasje gjithëpërfshirëse për arritjen e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në komunë.

Strategjia përfshinë një qasje gjithëpërfshirëse për rritjen e të hyrave komunale është thelbësore për të përmbushur nevojat buxhetore për operacionet e komunës dhe projektet zhvillimore. Për të adresuar këtë sfidë mund të eksplorohen disa qasje me risi, për gjenerimin e të ardhurave.

Pra dokumenti Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal do të ndihmon dhe lehtëson edhe përcaktimin e prioriteteve zhvillimore si dhe do të jetë bazë e planifikimeve buxhetore për periudhën e vlefshmërisë së tij. Rritja e shërbimeve komunale Zgjerimi i fushës dhe cilësisë së shërbimeve komunale mund të jetë një nxitës i rëndësishëm i të ardhurave. Skenderaj mund të konsiderojë futjen e shërbimeve të reja ose përmirësimin e atyre ekzistuese, si menaxhimi i mbeturinave, parkingjet komunale, apo tarifat e licencimit.

Kapitalizimi i aseteve Teprica e zhvillimit dhe rritjes së infrastrukturës paraqet një mundësi për të kapitalizuar asetet komunale. Komuna mund të marrë në konsideratë dhënien me qira ose ne shfrytëzim të pronave të papërdorura ose të pashfrytëzuara, të tilla si toka ose ndërtesa, për zhvillim komercial ose rezidencial Partneritetet Publiko-Private (PPP) mund të jenë një mënyrë strategjike për të nxitur ekspertizën dhe investimet e sektorit privat për të përmirësuar shërbimet publike duke gjeneruar të ardhura për Komunën e Skenderajt.

Trashëgimia e pasur kulturore dhe vendet historike të Komunës së Skenderajt ofrojnë një bazë solide për zhvillimin e turizmit. Megjithatë, sfidat që lidhen me infrastrukturën, marketingun dhe promovimin e turizmit duhet të adresohen për të kapitalizuar plotësisht këtë potencial.Komuna do të punojë ngushtë me investitorët dhe biznese për të ofruar akses të avancuar dhe për të hequr pengesat burokratike. Kjo nënkupton përshpejtimin e procesit të lejeve, ofrimin e mbështetjes dhe udhëzimeve për investitorët, madje edhe ofrimin e tokës ose pronave komunale për përdorimin e tyre. Duke krijuar një mjedis mikpritës dhe miqësor për investitorët, Skenderaj mund të tërheqë investime dhe të nxisë rritjen ekonomike.

## b. ARSIMI, KULTURA, RINIA E SPORTI

Gjatë periudhës së azhurnimit të kësaj kornize buxhetore, komuna do të vazhdojë në avancimin e mëtejmë të kushteve infrastrukturore të sistemit arsimor, e cila padyshim se do të ndikojë drejtpërdrejt në ngritjen e mëtejme të cilësisë dhe sukseseve tjera në këtë sistem.

Viteve të fundit, në sistemin arsimor të Skenderajt është punuar mjaft në fushën e ndërtimit të objekteve të reja shkollore, renovimeve, trajnimit të personelit arsimor, ndërtimin e fushave sportive, instalimin i sistemit të ngrohjeve qendrore në nivel të të gjitha shkollave.

Do të vazhdohen investimet në arsim në këto fusha: ndërtimi i Instituionit të ri parashkollor në qytetin e Skënderajt, adaptimi i objekteve shkollore të pashfrytëzuara në institucione parashkollore, krijimi i qendrave për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, renovimi dhe pajisja me material didaktik- konkretizues për klasët parashkollore, digjitalizimi i shkollave, sigurimi i rrethojave të shkollave, pajisja e shkollave me mjete të teknologjisë informative, kabinete, mjete konkretizimi etj.

Kultura, Rinia dhe Sporti do të vazhdojë të mbetet ndër fokuset kryesore të qeverisë sonë lokale, investimi në këto dikastere ndihmon në ringjalljen ekonomike të qytetit dhe jemi në përpjekje të vazhdueshme që përmes trashëgimisë kulturore siq është projekti madhor ndërtimi i Muzeut dhe Bibliotekës së qytetit, të gjallërojmë jetën e qytetarëve por edhe për të tërhequr turistët dhe investitorët potencial. Fuqia e kulturës përveq shfaqjeve dhe organizimeve do të orientohet në qështjet që lidhën me barazinë gjinore, mjedisin, shëndetin, sfidat në arsim, paqen përmes dialogut ndërkulturor e ndërfetar.

Është investuar bukur mirë në infrastrukturën sportive dhe këto investime do të vazhdojnë edhe më tutje, siq është ndërtimi i tribunave të stadionit të qytetit dhe do të vazhdojë mbështetja institucionale përmes subvencionimeve, për të gjithë Klubet Sportive, OJQ-të si dhe Individët në fusha të ndryshme.

## c. SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

Sistemi shëndetësor primar në komunën tonë pothuajse në shumë segmente të tija gjatë viteve të fundit është kompletuar dhe se si i tillë tani më garanton ngritje të performancës në shërbime shëndetësore për qytetarët tonë.

Vazhdimi i modernizimit të QKMF-së dhe Qendrave Familjare me pajisje mjekësore në të gjitha objektet shëndetësore është i domosdoshem.Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale edhe për këtë përiudhë planifikimi është duke rritur aktivitetin e saj edhe në sferën e shërbimeve përmes projekteve siq është programi "Kujdesi shtëpiak për nëna dhe fëmijë", "Kujdesi paliativ", " Vizitat sistematike në shkolla" do të planifikojë gjithashtu ngritjen buxhetore për të avansuar edhe më tej efikasitetin e shërbimeve shëndetësore, pastaj ngritjen buxhetore për ndihmë financiare për personat e prekur nga sëmundje të ndryshme, rastet e dhunës në familje, rastes sociale.Sfidë mbetet furnizimi me barëra dhe material të nevojshëm,kompletimi i vazhdueshëm me pajisje të nevojshme mjekësore, aparature laboratorike etj.

## d. SHËRBIMET PUBLIKE

Komuna jonë në lëminë e shërbimeve publike qëndron në situatë relativisht të mirë, pasi që gjatë këtyre viteve në fushën e shërbimeve publike janë bërë investime të mëdha, sidomos në lëminë e infrastrukturës rrugore, ndriçimin e qytetit, gjelbërimin e qytetit, shtratin e Lumit Klina që përshkon qytetin, ndërtimi i kanalizimeve edhe në zonat rurale, ujesjellësave dhe investime tjera të nevojshme për komunitetin e komunës tonë. Megjithatë në këtë fushë ka edhe shumë për t'u bërë.Komuna ka bërë edhe një përparim në bashkëpunim me Kompaninë "Uniteti" në drejtim të eliminimit të deponive ilegale. Sfidë do të jetë mirëmbajtja dhe kujdesi ndaj këtyre investimeve të bëra, sidomos mirëmbajtja dhe pastrimi e hapësirave publike gjelbëruese, sheshit, rrugëve, trotuareve etj, shërbime të cilat do të kryhen nga Ndërmarrja Komunale "Eko-Natyra" SH.A. Megjithatë, Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 padyshim se do të përmbajë më shumë investime të cilat do të avancojnë edhe më shumë ngritjën e efikasitetit të shërbimeve publike, si një mision i institucioneve tona.

## POLITIKAT E REJA

Politikat e reja të cilat parashikohen të impementohen gjatë kësaj periudhe 2025-2027 duke mos u kufizuar vetëm në këto politika.

Hartimi i KAB-it komunal do të mbështetet në politikat e reja në arsim të cilat janë inicuar nga Ministria e Arsimit dhe në vazhdimësi të aprovuara nga Komisioni i Granteve në vitin 2025 si :

a) Punësimi/angazhimi edhe i një këshilltari për karrierë në Qendrën e Karrierës në shkollën fillore, profesor me kosto vjetore 7,680.00 euro;
b) Punësimi/angazhimi i një këshilltari për karrierë në Qendrën e Karrierës në shkollën profesionale, profesor me kosto vjetore 7,680.00 euro;
c) Punësimi i 18- punonjësve arsimorë për hapjen e institucionit parashkollor, me kosto vjetore 167,900.00 euro ( Institucioni Parashkollor do të ketë kapacitet deri 130 -fëmijë, do të krijojë të hyra vetanake rreth 50,000.00 Euro në vit).
d) Hapja e 3 - qendrave për zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme me bazë në komunitet, tre punëtorë, 21,200.00 euro në vit.

**Do të vazhdojnë politikat edhe për:**

e) Asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta dhe kategoria paga dhe shtesa për 15 (pesëmbëdhjetë) asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta, me kosto prej 70,890.00 euro, sipas qarkores;
f) Punësimi i pesë psikologëve/pedagogëve, si shërbime profesionale në shkolla, në ato shkolla ku nuk ka shërbyes të tillë profesionalë, të cilët do të lehtësojnë punën pedagogjike në shkollë si dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor;
g) Praktika profesionale dhe transporti i nxënësve për punë praktike apo biznes – shkollë si dhe mbulimi i sigurimeve shëndetësore në praktike për nxënësit e IAAP "Anton Çetta" në Skenderaj, me kosto prej 118,462.00 euro në kategorinë Mallra dhe Shërbime;

Do të vazhdojnë përpjekjet për integrimin e komunitetit (fshati Banjë me banorë kryesisht serb) në kuadër të arsimit parafillor, me staf prej 8 vetash sipas marreveshjës së Kryetarit të Komunës me përfaqësuesin e Zyrës Komunale për komunitete dhe kthim. Ky komunitet ende nuk është integruar në pajtueshmeri të plotë me sistemin dhe organogramin komunal të qasjës në buxhet duke respektuar LMFPP-në dhe Ligjin e vetëqeverisjes lokale dhe duke dhënë përgjegjësi për raportime financiare (shpenzimi i buxhetit , krijimi i THV-ve sipas rregulloreve komunale).

**Në Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:**

Edhe në vitin 2025 komuna planifikon që në mënyrë institucionale të përkrahë të gjitha lehonat e komunës nga kategoria e subvencione për çdo lindje të fëmijëve si mbështetje për gratë si shtyllë kryesore e familjës dhe shtetit. Sipas të dhënave nga sektori i gjendjës civile komunale mesatarisht numri i lindjeve në vit janë 800 lindje. Kosto e përgjithshme e financimit planifikohet të jetë 160,000.00€.

**Në sektorin e Zhvillimit ekonomik dhe të bujqësisë**

Në të dy programet komunale në Bujqësi dhe programin e Zhvillimit Ekonomik do të vazhdojë përkrahja e farmereve me makineri përcjellëse bujqësore, koshere të bletëve, serra, pemë dhe perime etj.

# TË HYRAT BUXHETORE

## Parashikimi i të Hyrave Komunale ( Transferet Qeveritare, të Hyrat Vetanake)

Në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2025 dhe orientimet për vitet 2026-2027, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2025 si dhe parashikimin afatmesëm 2026-2027. Kurse parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2025, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën nr.1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

## Burimet e Financimit Komunal për vitin 2025-2027

### Granti i Përgjithshëm [2]

Korniza Afatmesme Buxhetore përmban analizën me përmbajtje mbi segmentin e parashikimit të të hyrave buxhetore prej të dy burimeve të financimit por me fokus të hyrave vetanake pasi që totalet e granteve qeveritare janë të përcaktuara sipas formulës qeveritare të zbatuar nga Komisioni i Granteve.Ashtu siç theksuam edhe më lart Qarkorja Buxhetore 2025/01,karakterizohet me zbatimin e rezultateve të regjistrimit të

[2] KASH 2025-2027

popullsisë të vitit 2011,kritereve për shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm si dhe kritereve për Grantin Specifik për Arsim e Shëndetësi te cilët mbështetën në qasjen me sistem të hapur sipas LFPL të financimit.

Bazuar në të dhënat nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2025 është aprovuar në shumë prej 307.45 milion euro.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2025 është në shumë prej 307.45 milion euro. Të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2025 pritet të jenë 3,074.89 milion euro.

**Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2025-2027 (mil. Euro)**

| Përshkrimi | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë** | **2037.1** | **2676.3** | **2985.32** | **3227.19** | **3413.61** | **3603.46** |
| Zbriten: | | | | | | |
| Mbeshtetja buxhetore dhe grante | 10.5 | 10.5 | 18 | 22.5 | 22.5 | 22.5 |
| Tatimi në pronë | 41 | 44.59 | 49.34 | 45 | 50 | 55 |
| Grantet e percaktuara të donatorëve | | 12 | 12 | 12 | 12 | 12 |
| Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale | 46.9 | 54 | 56.18 | 70 | 73.5 | 77.2 |
| Të hyrat nga interesi | 3.4 | 3.1 | 3 | 2.8 | 2.5 | 2.2 |
| **B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komunal** | **1935.3** | **2552.11** | **2846.8** | **3074.89** | **3253.11** | **3434.58** |
| **C. Granti i përgjithshëm për komuna (10%)** | 193.53 | 255.211 | **284.68** | 307.489 | 325.311 | 343.458 |

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%)

**Tabela 2: Struktura e Grantit të Përgjithshëm për 2025-2027 sipas LFPL (mil. Euro)**

| Faktorët | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **GRANTI I PËRGJITHSHËM** | **193.53** | **255.211** | **284.68** | **307.49** | **325.31** | **343.46** |
| | | | | | | |
| Shuma Fikse | 3.6 | 3.6 | 3.6 | 3.6 | 3.6 | 3.6 |
| Popullsia (banorë) | 1780021 | 1780021 | 1780021 | 1780021 | 1780021 | 1780021 |
| Buxheti: 89% e shumës agregate | 169.04 | 223.93 | 250.16 | 270.40 | 286.30 | 302.40 |
| Zona komunale (km2) | 10,901 | 10,901 | 10,901 | 10,901 | 10,901 | 10,901 |
| Buxheti: 6% e shumës agregate | 11.40 | 15.10 | 16.86 | 18.20 | 19.30 | 20.40 |
| Komunitetet pakicë në komunë | 107,926 | 107,926 | 107,926 | 107,926 | 107,926 | 107,926 |
| Buxheti: 3% e shumës agregate | 5.7 | 7.5 | 8.4 | 9.1 | 9.7 | 10.2 |
| Popullsia e komunave pakicë | 62,031 | 62,031 | 62,031 | 62,031 | 62,031 | 62,031 |
| Buxhti: 2% e shumës agregate | 3.8 | 5.0 | 5.6 | 6.1 | 6.4 | 6.8 |

Sipas Qarkores në tabelën në vijim mund të vëreni se Granti i Përgjithshëm (8,450,648.00) ka rritje 8.02 % nga buxheti i aprovuar 2024, Granti për Arsim (7,286,969.00) ka një rritje 3.97% nga buxheti i aprovuar 2024 edhe pse janë kalkuluar politikat e reja. Kurse Granti për Shëndetësi (2,234,388.00) ka rënie 0.94 % nga buxheti i aprovuar 2024. Edhe në këtë vit vazhdon transferi i kompetencave nga niveli qendror për Shërbimet Rezidenciale (200,000.00).Plani i të hyrave vetanake komunale ka ndryshuar në krahasim me vitin aktual dhe është 1,709,466.00 ose 31.57% më i lartë. Në total buxheti për vitin 2025 nga të gjitha burimet është 6.99 % më i lartë sa buxheti i vitit fiskal aktual.

Kufijtë e grumbullimeve të të hyrave vetanake komunale janë planifikuar të jenë mbi nivelin e vitit të kaluar dhe sjellen afër kufirit të fuqisë reale ekonomike komunale. Ky planifikim do të krijoj hapësirë të mjaftueshme për realizimin në tërësi të tyre.

Të hyrat e planifikuara për vitin 2025 nga të gjitha burimet e financimit për programet specifike dhe krahasimi i tyre me vitin aktual 2024 është prezantuar në tabelën në vijim së bashku me diferencat e shprehura në shuma dhe përqindje:

| Burimet e financimit | | 2024 | 2025 | Raporti 2024/2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Granti i Përgjithshëm | 7,822,982.00 | 8,450,648.00 | 8.02% |
| 2 | Granti për Arsim | 7,008,587.00 | 7,286,969.00 | 3.97% |
| 3 | Granti për Shëndetësi | 2,255,488.00 | 2,234,388.00 | -0.94% |
| 4 | Sherbimet rezidenciale | 200,000.00 | 200,000.00 | 0.00% |
| 5 | Te hyrat vetjake komunale | 1,299,271.00 | 1,709,466.00 | 31.57% |

**Grafiku i buxhetit – raporti i vitit 2024/2025 sipas të gjitha burimeve të financimit**




**BUXHETI I KOMUNËS SKENDERAJ PËR VITIN 2025 DHE VLERËSIMET PËR VITET 2026-2027 SIPAS QARKORËS 2025/01**

Qarkorja Buxhetore e Ministrisë të financave përveq kufijve për vitin e ardhshëm fiskal 2025 ajo jep informacione dhe për vlerësimet për dy vitet buxhetore 2026-2027 ashtu siq është prezantuar në tabelë:

| Burimet e Financimit | Viti aktual | Plani buxhetor | Vlerësimet | |
|---|---|---|---|---|
| | 2024 | 2025 | Vlerësimet 2026 | Vlerësimet 2027 |
| Granti i përgjithshëm | 7,822,982.00 | 8,450,648.00 | 8,941,079.00 | 9,440,454.00 |
| Granti për arsim | 7,008,587.00 | 7,286,969.00 | 7,505,578.00 | 7,730,746.00 |
| Granti për shëndetësi | 2,255,488.00 | 2,234,388.00 | 2,340,745.00 | 2,452,164.00 |
| Transferi i Shërbim. Rezide. | 195,981.00 | 200,000.00 | 200,000.00 | 200,000.00 |
| Të hyrat vetanake | 1,299,272.00 | 1,709,466.00 | 1,816,054.00 | 1,926,096.00 |
| **GJITHSEJ TË HYRAT** | **18,582,310.00** | **19,881,471.00** | **20,803,456.00** | **21,749,460.00** |

Përveq të hyrave nga Granti i Përgjithshëm, Granti për Arsim dhe Shëndetësi të cilat ju nënshtrohen kriterëve të caktuar specifik për ndarje, komuna ka në dispozicionë edhe të hyrat vetanake të cilat realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal , Rregullorës së brendshme mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Ligjin mbi Tatimin në Pronë, Rregullores Komunale për ngarkesat dhe taksat si dhe dispozitave

tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktojë dhe inkasojë, por se kemi edhe të hyra tjera të cilat nuk bazohen në rregulloren tonë siç janë: të hyrat nga gjobat në trafik, gjobat e gjykatave dhe rrjedhin nga niveli qendror.

Edhe pse trendi i të hyrave vetanake në komunën tonë pothuajse vit pas viti ka shënuar progres, Administrata e Komunës respektivisht Drejtoria për Buxhet e Financa, do të trajtojë me kujdes burimet e mundëshme të hyrave, të studioj dhe analizoj me kujdes kornizën fiskale të komunës në mënyrë që të bëjë eliminimin edhe të atyre pengesave të cilat do të mundë të rrezikonin ecurinë pozitive të të hyrave vetanake.

**Tatimi në pronë** është i vetmi tatim që arkëton komuna dhe është një prej burimeve kryesore të të hyrave vetanake. Kjo e hyrë i kthehet qytetarit në mënyrë indirekte në projekte. Të hyrat nga Tatimi në Pronë rrjedhin nga pasuria individuale e qytetarëve. Në aplikim përveç të hyrave nga tatimi në objekte banimi po aplikohet edhe tatimi në tokë. Numri i përgjithshëm i obliguesve për tatim është rreth 12.500 (prona të banimit dhe afarizëm), por edhe prona ne tokë afër 72.500 parcela të ndara në pesë lloje të pronave (kategori të vlerësimit), parcela të cilat do të tatimohën ne vitet ne vijim te gjitha sipas normave të reja tatimore.
Për herë te parë gjatë vitit 2025 pronat e paluajtshme do të tatimohen sipas ndryshim-plotësim ligjit te ri per tatimin ne pronë, ku normat do te jenë progresive apo te përshkallëzuara sipas vlerës se pasurisë.

Synimet e Drejtorisë në vazhdimësi janë që të përfshihen të gjitha pronat e pa regjistruara për qëllime të Tatimit në Pronë dhe ndryshimet eventuale në pasuritë e regjistruara. Numri i tyre pritet të jetë 570, me bazë tatimore. Te hyrat vjetore për të gjitha pronat planifikohen te jenë në një shumë vjetore prej 344,960.00 € për vitin 2025, së bashku me tatimin mbi tokën me tendenca të ngritjës se kësaj të kësaj te hyre për vitet në vijim 2026 shuma 383,322.00 si dhe për vitin 2027 rreth 421,728.00 €.

## Plani i të Hyrave Vetanake për tri vitet e ardhshme:

Në vazhdim të kësaj kornize buxhetore do të paraqesim planifikimin e të hyrave vetanake nëpër zëra të hyrave 2025, si dhe vlerësimet për vitin 2026 si dhe për vitin 2027. Gjithnjë duke respektuar të dhënat nga Qarkorja Buxhetore 2025/01.
Të hyrat vetanake janë të planifikuara me një trend të rritjes sipas kufirit të percaktuar nga MF-ja, përsëri në bazë të Qarkores 2025/01 për çdo vit fiskal. Korniza Afatmesme Buxhetore është punuar sipas vlerësimeve të kërkesave aktule të MF dhe janë të bazuara në prioritetet sektoriale .
Sipas kërkesave të kufijve fillestar planifikimi i të hyrave vetanake komunale 2025-2027 shihet në tabelën në vijim:

| Planifikimi i të Hyrave Vetanake Komunale, për vitin 2025-2027 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Përshkrimi** | **Aktuali 2024** | **Parashikimi 2025** | **Parashikimi 2026** | **Parashikimi 2027** |
| 1 | Tatimi në pronë | 306,074.70 | 278,956.00 | 306,125.00 | 328,319.00 |
| 2 | Tatimi në tokë | 71,795.30 | 66,004.00 | 77,197.00 | 93,409.00 |
| 3 | Licencat dhe lejet | 28,000.00 | 55,000.00 | 60,500.00 | 55,550.00 |
| 4 | Certifikatat dhe dokumentet zyrtare | 56,550.00 | 48,000.00 | 52,800.00 | 57,080.00 |
| 5 | Taksat e pajisjeve motorike | | - | - | - |
| 6 | Lejet per ndertesa | 203,868.00 | 450,500.00 | 447,700.00 | 472,470.00 |
| 7 | Taksat tjera komunale | 150,000.00 | 145,000.00 | 159,500.00 | 175,450.00 |
| 8 | Taksat për Mbeturinat | - | - | - | - |
| 9 | Ngarkesat rregullatore | - | - | - | - |
| 10 | Te hyrat nga qiraja | 20,000.00 | 22,000.00 | 24,200.00 | 26,000.00 |
| 11 | Bashke-pagesat per arsim | 57,000.00 | 47,500.00 | 52,250.00 | 49,500.00 |
| 12 | Bashke-pagesat per shëndetësi | 22,400.00 | 27,500.00 | 30,250.00 | 33,275.00 |
| 13 | Ngarkesat tjera komunale | 12,500.00 | 105,450.00 | 115,995.00 | 119,460.47 |
| 14 | Shitja e aseteve | - | - | - | - |
| 15 | Të hyrat nga gjykatat | 25,000.00 | 30,000.00 | 33,124.30 | 36,436.73 |
| 16 | Të hyrat nga gjobat në trafik | 110,000.00 | 145,000.00 | 148,500.00 | 145,299.00 |
| 17 | Të hyrat nga Agjencioni Pyjor i Kosovës | 148.00 | 80.00 | 88.00 | 96.80 |
| 18 | Të hyrat tjera | 114,935.00 | 68,476.00 | 75,324.70 | 78,000.00 |
| 19 | Koncesioni | 121,000.00 | 220,000.00 | 232,500.00 | 255,750.00 |
| **Total** | | **1,299,271.00** | **1,709,466.00** | **1,816,054.00** | **1,926,096.00** |

**Parashikimi i shpërndarjes së mjeteve buxhetore në kategoritë ekonomike për vitin 2025, bazuar në kërkesat e domosdoshme komunale sipas prgrameve kryesore**

| SKENERA J | Drejtoritë/Programet | | Paga dhe Shtesa | Mallra dhe Shërbime | Shpenzime Komunale | Subvencione dhe Transfere | Shpenzime Kapitale | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **ADMINISTRATA KOMUNALE** | **267** | **2,215,600** | **1,629,465** | **150,800** | 1,147,000 | 4,642,948 | 9,785,813 |
| | Kryetari | 22 | 225,500 | 60,000 | - | 35,000 | 6,000 | 326,500 |
| | Prokurimi | 6 | 69,000 | 13,140 | | | | 82,140 |
| | Administrata dhe Personeli | 39 | 257,000 | 139,100 | - | - | - | 396,100 |
| | Çështjet gjinore | 3 | 23,500 | 11,400 | | | | 34,900 |
| | Inspektimet | 10 | 99,200 | 110,150 | | | | 209,350 |
| | Kuvendi Komunal | - | 259,800 | 31,000 | | | | 290,800 |
| | Buxhet dhe financa | 24 | 164,000 | 33,850 | | | 190,000 | 387,850 |
| | Sherbime publike | 39 | 318,500 | 743,500 | 147,000 | 127,000 | 724,000 | 2,060,000 |
| | Zyra e Komuniteteve | 8 | 53,500 | 17,000 | | | | 70,500 |
| | Bujqësia, Pylltaria dhe Zhv. rural | 20 | 87,600 | 36,545 | | 360,000 | | 484,145 |
| | Zhvillim Ekonomik, Inovacion, Ndërmarrësi dhe Turizem | 10 | 70,500 | 10,100 | | 120,000 | 170,000 | 370,600 |
| | Kadastër dhe Gjeodezi | 16 | 98,000 | 25,980 | | - | - | 123,980 |
| | Planifikimi Urban dhe Mjedisi | 12 | 94,000 | 290,000 | | - | 3,552,948 | 3,936,948 |
| | Kulturë, Rini dhe Sport | 21 | 157,000 | 40,850 | | 185,000 | - | 382,850 |
| | Administrata e arsimit | 10 | 68,000 | 21,550 | | 90,000 | - | 179,550 |
| | Administrata e shendetësisë | 10 | 59,500 | 16,600 | - | 230,000 | - | 306,100 |
| | Shërbimet Sociale | 17 | 111,000 | 28,700 | 3,800 | - | - | 143,500 |
| | SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR | 195 | 1,580,236 | 591,418 | 67,200 | - | 40,534 | 2,279,388 |
| | Sherbimet rezidenciale | 13 | 100,000 | 75,000 | 10,000 | - | 15,000 | 200,000 |
| | **ARSIM DHE SHKENCË** | **854** | **6,849,528** | **550,924** | **59,300** | - | 156,518 | 7,616,270 |
| | Arsimi parashkollor dhe çerdhet | 39 | 266,000 | 73,100 | 5,700 | - | - | 344,800 |
| | Arsimi fillor | 680 | 5,381,500 | 413,524 | 41,800 | - | 156,518 | 5,993,342 |
| | Arsimi i mesëm | 135 | 1,202,028 | 64,300 | 11,800 | - | - | 1,278,128 |
| **Totali i shpenzimit të buxhetit** | | **1,329** | **10,745,364** | **2,846,807** | **287,300** | **1,147,000** | **4,855,000** | **19,881,471** |
| | | % | 54.05 | 14.32 | 1.45 | 5.77 | 24.42 | 100.00 |

# Programi i investimeve publike (PIP)

Programi për Investime Publike (PIP) do të përfshijë të gjitha projektet e aprovuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2025-2027 nga ana e Kuvendit të Komunës me procedim sipas qarkores buxhetore.

Programi i investimeve publike(PIP) do të jetë pjesë e pakos së projekt-buxhetit të vitit 2025-2027, përmes hartimit të formularëve adekuat me arsyeshmërinë përkatëse nga secili program i organizatës tonë buxhetore. Projektet kapitale duhet të jenë në përputhje me planin kontabël, ku secili projekt gjatë hartimit të përmbajë edhe pjesën e shpenzimeve operative.

Pjesë e pandarë e kësaj kornize afatmesme buxhetore është edhe lista e projekteve kapitale për vitet 2025-2027 , e cila paraqitet në vazhdim Lista e projekteve për vitet fiskale 2025-2027 do të mund të modifikohet me propozime të reja në rast se do të ketë të tilla gjatë dëgjimeve buxhetore, pastaj nga ana e organeve relevante të Komunës të cilat janë përgjegjëse për hartimin e politikave zhvillimore të Komunës duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara për financim si dhe burimin e të ardhurave, dhe kështu nga propozuesi i buxhetit në këtë rast Kryetari i Komunës do të hartojë përfundimisht projekt-Buxhetin për vitet 2025-2027, për tu proceduar si i tillë në Kuvendin e Komunës për aprovim. Në vijim lista e projekteve sipas programeve për tri vitet e ardhshme.

## PROJEKTE KAPITALE PËR PERIUDHËN 2025-2027

| LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2025-2027 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **EMERTIMI I PROJEKTEVE** | **Statusi** | **2025** | **2026** | **2027** |
| 1 | Dron me pajisje përcjellëse | I ri | 6,000.00 | | |
| 2 | Bashkëfinancimi | | 190,000.00 | 250,000.00 | 400,000.00 |
| 3 | Blerja dhe mirëmbajtja e kamerave te hapësirave publike | Vazhdim | - | 10,000.00 | 10,000.00 |
| 4 | Riparimi dhe zgjerimi i vëndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre | Vazhdim | 144,373.20 | 144,000.00 | 10,000.00 |
| 5 | Blerja e pajisjeve motorike për mirembajtjen e qytetit | Vazhdim | 33,000.00 | 30,000.00 | 100,000.00 |
| 6 | Ndriçimi publik ne Qytet dhe Bashkësit Lokale | I ri | 546,626.80 | 550,000.00 | 480,000.00 |
| 7 | Sanimi i gropave dhe pjeseve te demtuar me kocka ne asfalt dhe trotuar | I ri | - | 30,000.00 | 100,000.00 |
| 8 | Zgjerimi, pastrimi I lumenjeve dhe largimi i dheut nga shembja. | I ri | - | 50,000.00 | 120,000.00 |
| 9 | Renovimi i objekteve Publike dhe kolektive të banimit | I ri | - | 30,000.00 | 150,000.00 |
| 10 | Smart City | I ri | 10,000.00 | 80,000.00 | 50,000.00 |
| 11 | Ndërtim i fshatit Antike ne B.L te Runikut | I ri | 25,000.00 | | |
| 12 | Shenjim i shtigjev te ecjes ne Çyçavicë | I ri | 35,000.00 | | |
| 13 | Ndërtimi i shëtitores natyrale dhe krijimi i hapësirave rekreative përgjatë shtratit të lumit Klina | Vazhdim | 40,000.00 | 40,000.00 | |
| 14 | Ndërtim i shtigjeve te çiklizmit ne Runik | I ri | | 80,000.00 | |
| 15 | Ndërtim te zonave rekreative në qytete | I ri | 40,000.00 | | 150,000.00 |
| 16 | Vendosja e një Billbordi me pika turistike në Skenderaj | Vazhdim | 20,000.00 | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 17 | Punimi i kanalizimit në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turiqec, Polac, Qirez, Runik, Likovc dhe Rezallë | Vazhdim | 166,153.90 | | 200,000.00 |
| 18 | Trotuaret dhe ndriqimi në BL Likovc,Klinë e Epërme, Polac,Runik,Turiqevc | Vazhdim | 45,000.00 | | |
| 19 | Unaza e brendshme 3 krahu kah Llausha | Vazhdim | 324,047.50 | | 100,000.00 |
| 20 | Kanalizimi fekal Izbicë, Rakinicë dhe Leqine | I ri | 100,000.00 | | |
| 21 | Ndertimi i kolektorit Llaushe - Aqarevë | I ri | 120,000.00 | 200,000.00 | 200,000.00 |
| 22 | Kanalizimi Syriganë, Banjë - Pemishtë | Vazhdim | 105,810.38 | | |
| 23 | Ndërtimi i fushave Sportive në qytet | I ri | 100,000.00 | | |
| 24 | Asfaltimi i rrugës në Lagjen 3 -Prekaz | Vazhdim | 185,860.60 | | |
| 25 | Segmenti 3 i rrugës "17 Shkurti" krahu prej urës deri në Klinë të Mesme | I ri | | 80,855.00 | |
| 26 | Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez | Vazhdim | 200,000.00 | 278,230.00 | |
| 27 | Rregullimi i subqendrës -Likovc | Vazhdim | 450,000.00 | | |
| 28 | Rregullimi i subqendrës -Runik | Vazhdim | 407,725.62 | | |
| 29 | Rregullimi i subqendrës -Qirez | Vazhdim | 252,250.00 | 395,473.86 | |
| 30 | Ndërtimi i Objektit të kompleksi i UÇK-së - Objekti Ç-së | I ri | 100,000.00 | - | |
| 31 | Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së | Vazhdim | | 233,553.22 | 400,000.00 |
| 32 | Ndërtimi i Objektit te kompleksi i UÇK-së -Objekti K-së | I ri | | 290,000.00 | 800,000.00 |
| 33 | Rregullimi i subqendrës - Klinë e Epërme | I ri | 80,000.00 | 250,000.00 | 250,000.00 |
| 34 | Rregullimi i subqendrës - Turiqevc | I ri | | | 300,000.00 |
| 35 | Tribunat ne stadiumin të qytetit | Vazhdim | 100,000.00 | 590,000.00 | 100,000.00 |
| 36 | Kanalizmi Klinë - Kuqicë | Vazhdim | 50,000.00 | 80,000.00 | |
| 37 | Ndertimi i urave ne Fshatrat; Aqarev,Llaush ,Kuqicë,Terrnafc,Tushil,Kllodernicë | Vazhdim | 200,000.00 | | |
| 38 | Asfaltimi,riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në qytet dhe BL Likovc,Turiqevc,Runik,Qirez | Vazhdim | 266,100.00 | | |
| 39 | Asfaltimi i rrugëve në fshatrat; Kuqicë,Qubrel,Kasterc,Vitak,Klladernic,Buroj,Vajnik, Abri,Tic,Klinë , Prekaz ,Mikushnic,Polac,Makerrmal,Rakinic,Llaush . | Vazhdim | 300,000.00 | | |
| 40 | Furnizimi me paisje mjekësore për 5 QMF dhe AMF | I ri | 25,534.00 | 660,730.24 | 660,730.24 |
| 41 | Renovimi I QKMF-se (Urgjences) | I ri | 15,000.00 | 619,316.53 | 619,316.53 |
| 42 | Instalimi i ngrohjes qendrore në AMF Kline dhe Rezalle | I ri | | 20,000.00 | 40,000.00 |
| 43 | Autombulance per nevojat e QKMF-se | I ri | | 70,000.00 | |
| 44 | Renovimi I AMF Polac, Qubrel,Llaushe, | I ri | | 65,000.00 | 60,000.00 |
| 45 | Furnizimi me paisje mjekesore per QKMF | I ri | | | 65,000.00 |
| 46 | Paisje mjekesore për Urgjencë | I ri | | 20,000.00 | 30,083.79 |
| 47 | Renovim i SHPMPF- Vendosja e Ashensorit | Vazhdim | 15,000.00 | | |
| 48 | Aneks I SHPMPF | I ri | | 15,000.00 | 15,044.28 |
| 49 | Ndërtimi i këndeve për lodra | Vazhdim | 22,904.00 | 100,000.00 | 250,000.00 |
| 50 | Tabela interaktive - Digjitale | I ri | 28,614.00 | 25,000.00 | |
| 51 | Laboratoret, kabinete e 8 lendeve te ndryshme | I ri | 35,000.00 | 25,755.00 | 43,289.44 |
| 52 | Renovimi i objekteve shkollore, rrethoja, ndricim etj | Vazhdim | 70,000.00 | | |
| | **TOTALI:** | | 4,855,000.00 | 5,312,913.85 | 5,703,464.28 |

Meqënse me Qarkorën e parë buxhetore pranohen vetëm kufijtë indikativ të cilët mund edhe të ndërrohen, Komuna KAB-in e ka përgaditur bazuar në kufijtë fillestar sipas Qarkores 2025/O1 edhe pse kërkesat janë shumë më të larta nga autorizuesit e progranmeve sidomos për shpenzime operative.

# PËRFORMANCA E DREJTORIVE TË KOMUNËS
# 1.ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

| ***Misioni*** |
|---|
| *Mbikëqyrja e përgjithshme e administrimit financiar të Komunës, ekzekutimi i vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson Komunën, nënshkruan të gjitha aktet e aprovuara nga Kuvendi Komunal, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të Komunës, bënë propozime për çështje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të komunës.* |

- **Objektivat**

  - Bënë përgatitjen e të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit Komunal;
  - Në sferën e legjislacionit të nivelit të qeverisjes lokale nxjerr Rregullore ,Vendime, Udhëzime të ndryshme etj. që kanë të bëjnë me një qeverisje sa më efikase dhe eficiente të të gjitha drejtorive të komunës;
  - Angazhohet për një punë me efikase të Asamblesë komunale dhe komisioneve të saj në realizimin e punëve dhe detyrave në të ardhmën që do të ndihmojnë në përshpejtimin e realizimit të programeve zhvillimore në nivelin komunal;
  - Koordinon punët me të gjitha Drejtoritë e Komunës, anëtarët e kuvendit komunal, Komiteteve dhe Komisioneve të KK-së, me subjektet relevante në nivelin qendror dhe lokal, OJQ-të, biznesin etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarit dhe për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me ketë edhe të ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e Komunës tonë;
  - Koordinon dhe menaxhon me burimet njerëzore brenda komunës;
  - Kujdeset për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshem financiarë.

**Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3-vjeçar**

**Zyra e Kryetarit:**

| | Kateg. e shpenzimeve ekonomike | VITET 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|
| | | Vlera në € | Vlera në € | Vlera në € |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 225,500.00 | 225,500.00 | 245,500.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 60,000.00 | 60,000.00 | 65,000.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | 35,000.00 | 45,000.00 | 35,000.00 |
| 5 | Investimet Kapitale | 6,000.00 | - | - |
| | **Gjithsej:** | **326,500.00** | **330,500.00** | **345,500.00** |

| *vitet* | *2025* | *2026* | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 20 | 20 | 20 |

# 2. Kuvendi Komunal

***Misioni***

*Kuvendi i Komunës së Skenderajt si organi më i lartë vendimmarrës në Komunë ka kompetenca të gjëra konform Ligjeve, Udhëzimeve Administrative dhe Rregulloreve të RK-së në nivel lokal. Kuvendi i Komunës aprovon buxhetin , korniza afatmesme buxhetore, rregullore komunale dhe dokumente tjera që janë me interesa reciproke Komunë-qytetar.*

**Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar**

**Kuvendi Komunal**

| | Kateg. e shpenzimeve ekonomike | VITET 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|
| | | Vlera në € | Vlera në € | Vlera në € |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 259,800.00 | 259,800.00 | 269,800.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 31,000.00 | 31,000.00 | 31,000.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | - | - | - |
| 5 | Investimet Kapitale | - | - | - |
| | **Gjithsej:** | **290,800.00** | **290,800.00** | **300,800.00** |

| *Vitet* | *2025* | *2026* | 2027 |
|---|---|---|---|
| Anëtarë të kuvendit | 31 | 31 | 31 |
| **Stafi i rregullt** | 3 | 3 | 3 |

# 3.Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

*Misioni*
*Misioni kryesorë i kësaj Zyre është që të ofrojë ndihma profesionale administrative dhe të ndihmojë në zhvillimin e gjithanshëm të gjitha komuniteteve të komunës me theks të posaçëm për minoritetet.*

- Objektivat:
  - Bashkëpunimi me komunitetet rreth çështjeve që kanë të bëjnë lidhur me kërkesat e që adresohen ndaj qeverisjes lokale
  - ofrimin e kushteve sa më të favorshme për një zhvillim të gjithmbarshëm ekonomik, arsimor dhe kulturor për komunitetet dhe me ketë edhe të minoriteteve që jetojnë në komunën tonë,
  - ndihmojë në krijimin e kushteve jetësore për të kthyerit.

**Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3-vjeçar**

**Zyra e Komuniteteve**

| | Kateg. e shpenzimeve ekonomike | VITET 2025 Vlera në € | 2026 Vlera në € | 2027 Vlera në € |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 53,500.00 | 53,500.00 | 54,500.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 17,000.00 | 17,000.00 | 17,000.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | - | - | - |
| 5 | Investimet Kapitale | - | - | - |
| | **Gjithsej:** | **70,500.00** | **70,500.00** | **71,500.00** |

| *vitet* | *2025* | *2026* | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 8 | 8 | 8 |

## 4. Drejtoria për Administratë dhe Personel

***Misioni***
*Misioni i Drejtorisë për Administratë është vazhdimi i ndërtimit të një administrate moderne, profesionale , efikase , transparente dhe të besueshme në shërbim të qytetarëve dhe të komunitetit të biznesit të Republikës së Kosovës , njëkohësisht të pa anshme në aspektin etnik, politik, fetar, gjinor etj. që është parakusht për një administratë të qëndrueshme dhe një qeverisje lokale funksionale.*

## Administrata dhe Personeli

| | Kateg. e shpenzimeve ekonomike | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 2025 | 2026 | 2027 |
| | | Vlera në € | Vlera në € | Vlera në € |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 280,500.00 | 280,500.00 | 291,500.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 150,500.00 | 191,400.00 | 201,400.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | - | - | - |
| 5 | Investimet Kapitale | - | - | - |
| | **Gjithsej:** | **431,000.00** | **471,900.00** | **492,900.00** |

| *vitet* | *2025* | *2026* | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 47 | 47 | 47 |

Me qëllim të identifikimit të shpenzimeve për çështje të barazisë gjinore dhe organizimin e aktiviteteve të cilat e promovojnë avansimin e gruas në shoqëri që nga viti 2022 komuna ka planafikuar nënkodin e veqant për çështje gjinore.

**OBJEKTIVAT e Administratës dhe personelit**

- Arritja e standardeve dhe nivelit të vendeve të zhvilluara në ofrimin e shërbimeve për qytetarë ,
- Transformimi ,standardizimi dhe funksionalizimi i sa më shumë shërbimeve elektronike ,
- Integrimi i sa më shumë programeve elektronike në lehtësim të shërbimeve për qytetarë,
- Avancimi i e-qeverisjes në koordinim dhe kontinuitet me MAPL-në dhe ASHI-në etj.

Objektivat e Përformancës do të vazhdojnë edhe me tutje si :

| *Matjet kryesore të përformancës* | *2025* | *2026* | *2027* |
|---|---|---|---|
| Transformimi i shërbimeve nga ato fizike në elektronike | 96% | 97% | 98% |
| Ulja e kohës së pritjes për qytetarë | 6' | 5' | 3' |
| Ulja e kohës së kryerjes së shërbimit | 3' | 2' | 2' |
| Kontroll i shërbimeve dhe raport i shpejtë dhe i saktë | 96% | 97% | 98% |
| | | | |

# 5. Drejtoria për Buxhet e Financa

***Misioni***

*Misioni i Drejtorisë për Buxhet e Financa është sigurimi i menaxhimit të përgjegjshëm, të drejtë dhe transparent të fondeve publike, krijimi i politikave fiskale të favorshme për nxitjen e investimeve të huaja dhe vendore me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal krijimi i një buxheti që rritë efikasitetin dhe efektivitetin e tij për alokimin e drejtë dhe me prioritet të resurseve në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë komunale.*

**Drejtoria funksionon përmes këtyre sektorëve :**

1. Sektori i Buxhetit dhe thesarit
2. Sektori i tatimit në pronë

Punën e vetë drejtoria do ta orientojë në :

a. Hartimin e draft buxhetit për vitin në vijim
b. Krijimin e një KAB-i të përgjegjshëm
c. Përgatitjen e pasqyrave financiare
d. Përgatitja e raporteve të rregullta sipas LMFPP
e. Raportimin e rregullt në KPF, Kuvend dhe MF
f. Krijimin e politika të favorshme fiskale
g. Zbatimin e buxhetit të aprovuar
h. Rritjen e efikasitetit ,efektivitetit dhe transparencës për shpenzimin e parasë publike
i. Krijimin e kushteve të favorshme për bizneset
j. Kujdesin ndaj pasurisë
k. Mbështetje komunitetit të biznesit

**Objektivat e drejtorisë:**

1. Ruajtja e stabilitetit buxhetor përmes politikave të kontrollit të brendshëm
2. Ruajtja e trendit të arkëtimit të hyrave vetanake, dhe rritja e burimeve të tyre,
3. Prioriteti i investimeve të taksa - paguesit me më shumë pjesëmarrje në të hyra vetanake të Komunës (tatimi në pronë)
4. Ekzekutimi i buxhetit bazuar në legjilacionin në fuqi me transparencë dhe llogaridhënie

Arritja e objektivave të lartë përmendura kërkon edhe politikat e veta të zbatimit drejt arritjës së rezultateve. Dy burime të qëndrueshme që ndikojnë në realizimin e objektivave të Drejtorisë janë të hyrat vetanake nga burimet e rregullta të taksave për regjistrimin e automjeteve dhe Tatimi në Pronë.

a) Taksat për regjistrimin e automjeteve janë te rregulluara sipas Rregullores komunale për Taksa , Tarifa dhe Ngarkesa
b) Tatimi në Pronë, është i vetmi tatim që arkëton Komuna dhe është një prej burimeve kryesore të të hyrave vetanake. Që nga viti i kaluar përveç tatimit në objekte është duke

u aplikuar edhe tatimi në tokë. Të hyrat nga TP i kthehen qytetarit në mënyrë indirekte në projekte. Të hyrat nga Tatimi në Pronë rrjedhin nga pasuria individuale e qytetarëve. Numri i tyre është 12500, me një mesatare prej 27.60 € euro në vit për një obligues. Synimet e Drejtorisë janë që gjatë tri viteve të ardhme të përfshihen të gjitha pronat e pa regjistruara për qëllime të Tatimit në Pronë dhe ndryshimet eventuale në pasuritë e regjistruara. Numri i tyre pritet të jetë 13,070, që do te shënoj rritjen e te hyrave vetanake për tri vite në vijim.(tabela e të hyrave vetanake faqe 17)

**Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar**

**Buxhet dhe financa**

| | | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Kateg. e shpenzimeve ekonomike** | **2025** | **2026** | **2027** |
| | | **Vlera në €** | **Vlera në €** | **Vlera në €** |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 164,000.00 | 164,000.00 | 174,000.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 33,850.00 | 33,850.00 | 52,000.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | - | - | - |
| 5 | Investimet Kapitale | 190,000.00 | 250,000.00 | 280,000.00 |
| | **Gjithsej:** | **387,850.00** | **447,850.00** | **506,000.00** |

| *vitet* | *2025* | *2026* | 2027 |
|---|---|---|---|
| Numri i të punësuarve | 24 | 24 | 24 |
| | | | |

- **Objektivat e Performancës**

| **Matjet Kryesore të Përformancës** | **2025** | **2026** | **2027** |
|---|---|---|---|
| Përgatitja e draft buxhetit për vitin në vijim | 1 | 1 | 1 |
| Përgatitja e KAB-it | 1 | 1 | 1 |
| Përgatitja e Qarkoreve Buxhetor | 2 | 2 | 2 |
| Rrjedha e parasë së gatshme | 2 | 2 | 2 |
| Raportimet e rregullta tremujore | 4 | 4 | 4 |
| Rishikimi i buxhetit aktual | 1 | 1 | 1 |
| Pasqyrat financiare vjetore | 1 | 1 | 1 |
| Ridestinimi i mjeteve | 1 | 1 | 1 |
| Shkresa të ndryshme për Ministritë e RK ( dezotimi ....) | 20 | 25 | 30 |
| Barazimet mujore me MF | 12 | 12 | 12 |
| Alo kimet mujore e të hyrave vetjake komunale | 12 | 12 | 12 |
| **Menaxhimi i shpenzimit të fondeve ne dispozicion** | **2025** | **2026** | **2027** |
| Zotimi mjeteve buxhetore | 1200 | 1250 | 1250 |
| Aprovimi i shpenzimeve | 4900 | 5200 | 4950 |
| Shpenzimi i mjeteve buxhetore | 4900 | 5200 | 4950 |
| Certifikimi | 4900 | 5200 | 4950 |
| Azhurnimi i mjeteve themelore-aseteve komunale | 2 | 2 | 2 |
| Regjistrimi pronave të reja – tatimi në pronë | 750 | 800 | 850 |

## 6. Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

*Misioni*

*Misioni i DGJKP – së është bashkëpunimi dhe krijimi i marrëdhënieve të ngushta me Agjencinë Kadastrave të Kosovës, Ministritë e linjës, Agjencitë e linjës si dhe institucionet tjera në nivel lokal dhe qendror të Republikës së Kosovës në fushën e gjeodezisë, kadastrat dhe pronësisë me qëllim të krijimit të kushteve për modernizimin e të dhënave nga këto fusha, mirëmbajtjen e regjistrave kadastral dhe ofrimin e shërbimeve sa më efikase, të shpejta dhe cilësore duke u mbështetur gjithnjë në legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë. Ngritja e cilësisë së shërbimeve përmes aftësimit të burimeve njerëzore me programet e reja të cilat do të aplikohen në fushën e gjeodezisë, kadastrit dhe pronësisë.*

Objektivat :

a. Respektimi i afateve ligjore në trajtimin e kërkesave dhe nxjerrja e vendimeve në përputhje me ligjet dhe afatet e parapara ligjore në fuqi ndaj këtyre kërkesave;
b. Funksionalizimi dhe integrimi i sistemit të SIKTK me Gjeodezinë;
c. Identifikimi i sistemit të adresave dhe regjistrimi i adresave;
d. Mirëmbajtja e evidencës së patundshmërive;
e. Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të shpejta duke respektuar legjislacionin në fuqi;
f. Implementimi i programeve elektronike të avancuara të cilat kanë mbështetje në ligjet e aplikueshme dhe të ofruara nga AKK.

**Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar**

**Kadastër dhe Gjeodezi**

| | | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Kateg. e shpenzimeve ekonomike** | **2025** | **2026** | **2027** |
| | | **Vlera në €** | **Vlera në €** | **Vlera në €** |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 98,000.00 | 98,000.00 | 99,000.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 25,980.00 | 26,000.00 | 25,980.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | - | - | - |
| 5 | Investimet Kapitale | - | - | - |
| | **Gjithsej:** | **123,980.00** | **124,000.00** | **124,980.00** |

| *Vitet* | *2025* | *2026* | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 20 | 20 | 20 |

| | *Matjet kryesore të përformancës* | *Planifikimi 2025* | *Planifikimi 2026* | *Planifikimi 2027* |
|---|---|---|---|---|
| | **Sektori për Gjeodezi** | | | |
| 1 | Kopje Plani | 690 | 650 | 740 |
| | Ndarje fizike | 95 | 98 | 100 |
| | **Sektori për Kadastër** | | | |
| | Certifikatë pronësie | 9400 | 9700 | 9800 |
| 2 | Regjistrim i pronës | 410 | 420 | 430 |
| | Regjistrim i hipotekave | 54 | 57 | 59 |
| | Informata periodike të ndryshme | 12 | 12 | 12 |
| | **Sektori për Pronësi** | | | |
| | Ndarja e pronës publike | 12 | 20 | 250 |
| | Vërtetim pronësie | 122 | 135 | 145 |
| 3 | Konkluzione për ndërprerje procedure | Sipas nevoje | Sipas nevoje | Sipas nevoje |
| | Rregullimi i statusit të pronës | Sipas nevoje | Sipas nevoje | Sipas nevoje |

## 7. Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit

***Misioni***

*Misioni i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit është planifikimi Urban ,zhvillimi dhe menaxhimi i projekteve kapitale si dhe zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në mbrojtjen e mjedisit.*

Orientimi i punës së Drejtorisë është :

1.**Planifikimi Urban**

- Hartimi i planeve rregulluese
- Hartimi i mikrolokacioneve dhe makrolokacioneve
- Hartimi i projekt propozimeve për projektet kapitale
- Hartimi i projekteve të detajuara për realizimin e këtyre projekteve si në projektet e infrastrukturës rrugore ,rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimeve rregullimin e trotuareve shesheve dhe zonave gjelbëruese ,në rregullimin e shtretërve të lumenjve ,terreneve sportive etj.
- Hartimin e projekteve të ndërtimit të lartë si : Institucionet shkollore ,shëndetësore ,sportive, të banimit ,afarizmit objekte fetare etj.

2.**Implementimi i Projekteve Kapitale**:

- Të gjitha projektet e hartuara të cekura më lartë Drejtoria me stafin e vet e bënë mbikëqyrjen në implementimin dhe realizimin e këtyre projekteve .
- Me stafin e Drejtorisë bëjnë pranimet teknike të projekteve të përfunduara
- Bëjnë implementimin e Planeve Rregulluese
- Lëshon Lejet e ndërtimit
- Me rastin e Lëshimit të Lejeve të Ndërtimit inkason edhe të hyrat financiare të vjelura përmes taksës administrative të Lejes ndërtimore dhe taksës në infrastrukturë.

3.**Mbrojtja e Ambientit**

- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjes të Ambientit angazhohet që të implementohen ligjet dhe rregulloret e hartuara prej Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa dhe rregulloret Komunale në Mbrojtjen e Ambientit.

**Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar**

**Planifikimi Urban dhe Mjedisi**

| | | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | Kateg. e shpenzimeve ekonomike | 2025 | 2026 | 2027 |
| | | Vlera në € | Vlera në € | Vlera në € |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 94,000.00 | 94,000.00 | 95,000.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 290,000.00 | 230,000.00 | 320,000.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | - | - | - |
| 5 | Investimet Kapitale | 3,552,948.00 | 3,976,054.00 | 4,009,380.49 |
| | **Gjithsej:** | **3,936,948.00** | **4,300,054.00** | **4,424,380.49** |

| *Vitet* | *2025* | *2026* | **2027** |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 13 | 13 | 13 |

# 8. Drejtoria për Shërbime Publike

*Misioni*

*Misioni i Drejtorisë për Shërbime Publike është ofrimi i shërbimeve të qytetarëve në mirëmbajtjen e rrjetit të Ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e hapësirave publike (Shesheve dhe Parqeve), ofrimin e shërbimeve në transportin Publik, Urban dhe Rural, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, monitorimin mbi menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave, mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve dhe hapësirave tjera publike, rregullimin e sigurisë në komunikacion (sinjalizimi i rrugëve) dhe ofrimin e ndihmës qytetarëve në rastet e Emergjencave, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera.*

**Drejtoria e Shërbimeve Publike funksionon përmes këtyre sektorëve:**

1. Sektori Për Shërbime Publike dhe
2. Sektori Për Mbrojtje dhe Shpëtim

Bazuar në sektorët e ndarë në dy fusha ashtu do të organizohen edhe punët dhe detyrat e secilit sektor për të realizuar misionin, për të arritur synimet tona si Drejtori.

**Vizioni** i Drejtorisë është ngritja e cilësisë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në fushat të cilat i ka të përcaktuara në misionin sajë.

**Objektivat e drejtorisë:**

a. Përmirësimi i cilësisë për shërbim me ujë të pijshëm
b. Monitorimi i trajtimit të ujërave të zeza
c. Mirëmbajtja dhe rregullimi i hapësirave publike (shesheve dhe parqeve)
d. Rregullimi i transportit publik në të gjitha vendbanimet
e. Mirëmbajtjen e ndriçimit publik
f. Grumbullimin, transportimin dhe deponimin e të gjitha llojeve të mbeturinave
g. Largimi i borës nga rrugët, hapja dhe zhbllokimi i rrugëve gjatë sezonit dimëror
h. Larja dhe pastrimi i rrugëve dhe shesheve gjatë sezonit veror
i. Sinjalizimi i rrugëve në qytet dhe rrugëve në zonat rurale
j. Ngritja e nivelit të gatishmërisë në intervenimet për raste emergjente dhe fatkeqësitë natyrore

Drejtoria përmes këtyre objektivave do të synojë arritjen e qëllimeve si dhe koordinimin dhe organizimin e punëve mes dy sektorëve dhe Policinë.

**Qëllimi** i Drejtorisë është ngritja e nivelit të shërbimeve efikase dhe cilësore ndaj qytetarëve si dhe përmirësimin e kushteve sociale për qytetarët në sektorët ku drejtoria ofronë shërbimet. Prandaj, për të arritur qëllimet patjetër duhet shtrirja e një serë aktivitetesh, ku për t'i zhvilluar këto aktivitete krijohen dhe implikime buxhetore si në shpenzimet e stafit për paga dhe mëditje po ashtu edhe ne mallra dhe shërbime, komunali dhe kapitale. Në tabelën e më poshtme kemi paraqitur të gjitha shpenzimet e mundshme në të gjitha kategoritë si:

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

| | Sherbime publike | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | Kateg. e shpenzimeve ekonomike | 2025 | 2026 | 2027 |
| | | Vlera në € | Vlera në € | Vlera në € |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 318,500.00 | 318,500.00 | 328,500.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 743,500.00 | 735,000.00 | 810,000.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | 147,000.00 | 147,000.00 | 155,000.00 |
| 4 | Subvencionet | 127,000.00 | 127,000.00 | 127,000.00 |
| 5 | Investimet Kapitale | 724,000.00 | 360,000.00 | 480,000.00 |
| | **Gjithsej:** | **2,060,000.00** | **1,687,500.00** | **1,900,500.00** |

| *vitet* | *2025* | *2026* | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 39 | 39 | 39 |

- Objektivat e Performancës

| Matjet kryesore të përformancës | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| Marrja e mostrave të ujit (analizat) | 24 | 26 | 28 |
| Trajtimi i ujërave të zeza në Impiant | 95% | 97% | 98% |
| Mbjellja e luleve dhe drunjtëve dekorues | 13000 | 15500 | 16000 |
| Regjistrimi i vijave të transportit Publik | 95% | 100% | 100% |
| Blerja e Kontejnerëve për mbeturina 120 litra | 1000 | 2500 | 3000 |
| Blerja e kontejnerëve për mbeturina 1m3 | 1000 | 1000 | 1000 |
| Grumbullimi, eliminimi dhe deponimi i mbeturinave | 70% | 85% | 90% |
| Largimi i borës nga rrugët dhe hapësirat publike | 95% | 97% | 98% |
| Larja dhe fshirja e rrugëve dhe shesheve | 90% | 96% | 98% |
| Vendosja e shenjave vertikale dhe horizontale | 90% | 95% | 98% |
| Intervenimet në shuarjen e zjarreve | 100% | 100% | 100% |
| Pastrimi i objekteve komunale | 100% | 100% | 100% |
| Sigurimi i objekteve komunale | 100% | 100% | 100% |

# 9. DREJTORIA PËR BPZHR

*Misoni i Drejtorisë për Bujqesi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka për objektive udhëheqjen e zhvillimit te qendrushem dhe konkurrues i fokusuar në trajnimin dhe mbeshtejen e fermerëve ne Komunën e Skenderajt.*

*Vizioni ynë eshte puna e përgjegjshme duke përdorur aftësitë profesionale dhe shkencore ne menyre qe te zhvillojmë sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.*

Objektivat:

a) Trajnimi dhe edukimi i fermerëve të cilët jetojnë në pjesën rurale të komunës
b) Keshilla tek fermerët për projekt dhe njoftimin i tyre për fondet e donatorëve të mundshëm
c) Përkrahja financiare projekteve nga MBPZHR së me bashkëfinancim me fermerët
d) Subvencionimi i fermerëve në sektorët e ndryshëm të bujqësisë
e) Bashkepunone me donatoret e ndryshëm ne mebeshtetje te fermerëve

**Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar**

**Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural**

| | | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Kateg. e shpenzimeve ekonomike** | **2025** Vlera në € | **2026** Vlera në € | **2027** Vlera në € |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 87,600.00 | 87,600.00 | 88,600.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 36,545.00 | 36,545.00 | 36,545.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | 360,000.00 | 380,000.00 | 430,000.00 |
| 5 | Investimet Kapitale | - | - | - |
| | **Gjithsej:** | **484,145.00** | **504,145.00** | **555,145.00** |

| vitet | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 20 | 20 | 20 |

- Fermerët e komunës do të trajtohen përmes Ministrisë së Bujqësisë dhe ZHR në mbjellën e grurit, misrit, subvencionimi i mbajtjes së lopëve , deleve shtimin e numrit të shoqërive të bletëve si dhe sigurimin e grandeve për mekanizëm të nevojshëm bujqësor. Gjithashtu drejtoria planifikon të vazhdojë me këshillime te ndryshme nga MBPZHR dhe zyra e këshillimeve .

- **Objektivat e Performancës**

| Matjet Kryesore të Performancës | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| Trajtimi i farmerëve nga fondi për zhvillin e bujqësisë | 210 | 230 | 260 |
| Kërkesat e vlerësuara të farmerëve për aplikim ne AZHRB | 0 | 320 | 340 |
| Organizimi panaireve | 1 | 2 | 2 |
| Subvencionimi i bujqëve nga fondi komunal për Subvencione | 100 | 200 | 350 |
| Bashkpunimi me donatorë dhe organizata | 750 | 600 | 800 |
| Mbrojtja dhe ruajtja e pyejeve | | | |
| Trajtimi i farmerëve nga fondi për zhvillin e bujqësisë | 210 | 230 | 260 |

# 10. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

*Misioni*

*Misioni i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) zhvillimi i aktiviteteve kulturore-sportive dhe angazhimi i rinisë në këto aktivitete, shenimin e datave historike dhe kremtimin e tyre. Organizon festivale, koncerte festive dhe humanitare , Gjithashtu, DKRS organizon mbajtjen e tubimeve përkujtimore, promovimin e librave, promovimin e kreativitetit në arte muze, arkivi dhe trashëgemisë kulturore dhe shumë aktiviteteve tjera që zhvillohen në kuadër të komunës.*

**Drejtoria funksionon përmes këtyre sektorëve:**

1. Sektori i Kulturës
2. Sektori i Rinisë
3. Sektori i Sportit dhe
4. Sektori i Bibliotekës

**Prioritetet:**

- Avancimi i jetës kulturore, rinore dhe sportive.
- Përmirësimi i infrastrukturës kulturore dhe sportive.
- Përkrahja e aktiviteteve të organizatave rinore joqeveritare dhe krijimi i hapësirave vepruese.
- Organizimi i garave të ndryshme sportive;
- Menaxhimi i hapësirave publike kulturore dhe sportive;
- Kujdesi për trashigiminë kulturore, arkiv dhe muzeun komunal
- Subvencionimin e të gjitha klubeve publike në sportet përkatëse

**Punën e vet Drejtoria do ta orientojë në:**

a) Udhëheqjen në mënyrë të drejtë me teatër, bibliotekë, arkiv, muze, stadiumin e qytetit, palestrën e sporteve në përputhshmëri me ligjet dhe aktet normative në fuqi
b) Kujdesin për formacione të tjera nga Kultura, Rinia, e Sporti që nuk kanë hapësirë e kushte punë;
c) Organizmin dhe shënimin e datave me rëndësi historike kur kërkohet;
d) Organizimin e debateve për zhvillim dhe avancim të kulturës dhe trashëgimisë kulturore
e) Gjetjen e mundësive për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
f) Grumbullimin e shënimeve faktike për të arriturat në Kulturë, Rini, Sport e Bibliotekë
g. Bashkëpunim të ngushtë dhe raportimi për punën e vet: Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini, Fe dhe Sport, kurdo që kërkohet;

h. Bashkëpunim me Drejtoritë komunale dhe në nivel qendror nga fushë veprimtaria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të këmbejë përvoja, si dhe me OJQ-të e organizata tjera;

Bashkpunim me MKRS, KOK , Federatat sportive dhe federaten e sportit shkollor, dhe Federatat vendore dhe ndërkombëtare sportive.

i. Respektimin dhe përkrahjen e asociacioneve, klubeve, shoqatave dhe krijimin e individë me aftësi të posaçme kreative pa bërë ndonjë dallim, racor, gjinor apo fetar;

j. Ofrimin e institucioneve të veta në shërbim të përgjithshëm të qytetarëve (me veprimtaritë primare që kryejnë ato, por në raste emergjente dhe veprimtari të tjera);

k. Joshjen e investitorëve, kërkimin e fondeve shtesë;

l. Organizimin e debateve për avancim dhe zhvillim të sportit;

m. Organizimin e anketave, seminareve e trajnimeve për kyçje të rinjve në aktualitetet rinore, evropiane e botërore;

n. Regjistrimin e grupeve, klubeve, kuvendeve etj.

Për të realizuar misionin e vet, Drejtoria planifikon të realizojë këto objektiva:

- Ruajtja e stabilitetit buxhetor përmes politikave të kontrollit të brendshëm.
- Shfrytëzimi racional i hapësirave kulturore dhe sportive duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë.
- Rritja e përkrahjes për grupet dhe individët që tregojnë sukses në fushën e artit, kulturës dhe sportit.
- Rritja e kujdesit për trashëgiminë kulturore

**Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar**

**Kulturë, Rini dhe Sport**

| | | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Kateg. e shpenzimeve ekonomike** | **2025** Vlera në € | **2026** Vlera në € | **2027** Vlera në € |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 157,000.00 | 157,000.00 | 158,000.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 40,850.00 | 40,850.00 | 42,000.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | 185,000.00 | 210,000.00 | 210,000.00 |
| 5 | Investimet Kapitale | - | - | - |
| | **Gjithsej:** | **382,850.00** | **407,850.00** | **410,000.00** |

| Vitet | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 21 | 21 | 21 |

Objektivat e përformancës

| *Nr* | *Përmbajtja e aktivitetit* | *Sektori* | *Afati* |
|---|---|---|---|
| 1. | Dita e Pavarësisë së Kosovës. . | K.R.S | 17 Shkurt |
| 2. | Beteja e Likoshanit dhe Çirezit. Akademi dhe aktivitete tj. | Kulturë | 28 Shkurt |
| 3. | Java kulturo-sportive "Epopeja e UÇK-së | K.R.S | 1-7 Mars |
| 4. | Turniri Memorial "Ilir Lushtaku" në futboll të vogël | Sport | 26 Mars |
| 5. | 28 Mars- Dita e përkujtimit të Martirëve të Skenderajt | K.R.S | 26,27 dhe 28 Mars |
| 6. | Liga komunale ne futboll te vogel | Sport | Gjatë tërë vitit |
| 7. | Turniri memorial në futboll të vogël "Ilaz Kodra" | Sport | Prill |
| 8. | Aktivitet për maturantët | Rini | Maj |
| 9. | Java e dhurimit të librit | Kulturë, biblioteka | Maj |
| 10. | Festivali i Teatrove shkollore dhe për fëmijë | Kulturë | 3,4,5 Qershor |
| 11. | Kolonia e Artistëve të artit figurativ | Kulturë, Rini | 15,16,17 qershor |
| 12. | Dita e Çlirimit të Skenderajt dhe përkujtimit te deshmorëve | K.R.S | 18 Qershor |
| 13. | Java e Diasporës | K.R.S | Korrik |
| 14. | Muaji rinor | K.R.S | Shtator |
| 15. | Aktivitete rinore për shënimin e datave ndërkombëtare | Rini | Gjatë gjithë vitit |
| 16. | Mbështetja e Qendrës Rinore Publike | Rini | Gjatë gjithë vitit |
| 17. | 28 Nëntori & Fest. Folk "Rapsodia Shqiptare" | K.R.S | 26,27 dhe 28 |
| **18** | Mbështetja financiare për Ansamblin ''Drenica" | Kulturë | Mars – Qershor |
| 18. | Aktivitetet Kulturore (Muzeu, Arkivi dhe Teatri). | Kulturë | Gjatë vitit |
| 19. | Përzgjedhja e më të mirëve në fushën e kulturës dhe sportit | K.R.S | Dhjetor |
| 20. | Aktivitete tjera kulturore: Promovime librash, ekspozita, etj. | Kult.Biblio. | Gjatë tërë vitit |
| 21. | Pritja e Vitit të Ri | Rini | Dhjetor |
| 22. | Organizimi i debateve dhe tryezave të ndryshme me të rinjtë | Rini | Gjatë gjithë vitit |
| 23. | Mbështetja e klubeve sportive | Sport | Gjatë gjithë vitit |

# 11. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK NDËRMARRËSI INOVACION DHE TURIZËM

***Misioni***
*Të Përmirësojë ambientin për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Të implementojë strategjitë për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2024-2028. Drejtoria synon të themelojë "partneritet" me komunitetin e bizneseve dhe e sheh rolin e saj si promovues të përmirësimit të infrastrukturës si bazë për zhvillim ekonomik. Drejtoria, gjithashtu ka për qëllim thjeshtësimin e rregulloreve dhe procedurave komunale që kanë të bëjnë me veprimtarin e bizneseve në Komunë*

**Zyra e zhvillimit ekonomik:**

Zyra e Zhvillimit Ekonomik përqendrohet në përmirësimin e ekonomisë në Skenderaj përmes: 1) ruajtjen dhe rritjen e bizneseve që aktualisht operojnë/veprojnë në Skenderaj, 2) inkurajimi i fillimit të bizneseve nga banorët e Komunes , inkurajimi i bizneseve të reja të vendosen në Skenderaj. Planifikon dhe punon me zyrat tjera komunale për të bërë planifikimin për projektet dhe për identifikimin e nevojave në infrastrukturë në fshatra dhe qytet. Sektori për planifikim mirëmban një listë për projektet prioritare, në baza dy-vjeqare.

**Njësia për biznese dhe investime**

Funksionalizimi i tërësishëm i ofrimit të shërbimeve ndaj bizneseve heqja e burokracisë dhe Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme përcjellëse për investitorë.

Ofrohen dhe shërbimet për biznese si

Regjistrimi i bizneseve të reja;

-Ndryshime të tjera në biznese;

-Ç'regjistrimi i bizneseve;

-Ndërrim i Certifikatave;

-Vërtetime;

-Informata;

**Njësia për Turizëm**

Përmirësimi i mekanizmave ekzistues dhe krijimi i mekanizmave të rinj institucional për bashkëpunim me shoqërinë civile; ambientalistët dhe ekspertët në fushat e zhvillimit të turizmit; Hulumtimi, planifikimi, hartimi i projekteve për donatorë të ndryshëm për mbështetje të projekteve në fushën e turizmit; Promovon turizmin duke shfrytëzuar hapësirat që ofron teknologjia bashkëkohore dhe forma te tjera; publikon informacione për turizmin në Skenderaj dhe realizon projkte ne fushën e turizmit.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

## Zhvillimi ekonomik, Ndërmarresi,Inovacion

| | | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | Kateg. e shpenzimeve ekonomike | 2025<br>Vlera në € | 2026<br>Vlera në € | 2027<br>Vlera në € |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 70,500.00 | 70,500.00 | 71,500.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 10,100.00 | 10,100.00 | 10,100.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | 120,000.00 | 130,000.00 | 150,000.00 |
| 5 | Investimet Kapitale | 170,000.00 | 250,000.00 | 200,000.00 |
| | **Gjithsej:** | **370,600.00** | **460,600.00** | **431,600.00** |

| *Vitet:* | *2025* | *2026* | *2027* |
|---|---|---|---|
| Burimet e pozitave | | | |

### Matjet kryesore të përformances

| Programi: burimet financiare | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|
| Administrata | 2500 | 3000 | 3500 |
| **Zyra për zhvilllim e komunikim** | | | |
| Regjistrimin e biznseve të reja | 180 | 190 | 200 |
| Trajnime për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të hapin biznes | 20 | 30 | 30 |
| Mbajtja e panaireve | 2 | 2 | 2 |
| Mbajtja e garës për ide inovative | 1 | 1 | 1 |
| **Zyra për planifikim ekonomik** | | | |
| Ndarja e granteve për Start-up | - | - | - |
| Participimi tek NVM që dëshirojnë me hap dege të re prodhuese | - | - | - |
| Krijimi i Qendrës për trajnime | | | |
| Krijimi i infrastrukturës së nevojhme për zhvillim ekonomik | | | |
| Sinjalizimi i pikave turisike | | | |

# 12. DREJTORIA PËR ARSIM

*Misioni*

*Misioni i Drejtorisë për Arsim është ngritja e cilësisë, menaxhimi dhe koordinimi i arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm si dhe përgjegjësia dhe transparenca në punë.*

**Drejtoria Komunale e Arsimit funksionon sipas këtyre sektorëve:**

1.Sektori i administratës

2.Sektori për buxhet dhe financa

3.Sektori i Arsimit i ndarë sipas niveleve:

-niveli parashkollor dhe fillor(0-1)

-niveli i mesëm i ulët (2)

-niveli i mesëm i lartë (3)

4.Sektori i shërbimeve teknike

Punën e vet drejtoria do ta orientojë :

- në menaxhimin dhe drejtimin efikas të punëve brenda drejtorisë,
- regjistrimin dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve në bankat shkollore,
- krijimin e kushteve të favorshme për punë në të gjitha institucionet shkollore,
- menaxhimi dhe koordinimi i arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë,
- pajisja e shkollave më mjete të nevojshme didaktike ,
- përfshirja në aftësimin profesional të mësimdhënësve, stafit profesional dhe drejtorëve të shkollave,
- ngritja e infrastrukturës shkollore - ndërtimit të objekteve të reja shkollore në këtë vit shkollor ndërtimi i dy objekteve shkollore investim i ministrisë së arsimit,
- renovimet dhe përgatitjet higjeno-teknike të shkollave,
- planifikimi dhe sigurimi i bursave për studentet e komunës brenda mundësive buxhetore.
- planifikimi dhe sigurimi i bursave brenda mundësive buxhetore për nxënësit më gjendje të rëndë ekonomike .

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

ARSIM DHE SHKENCË

| | | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | Kateg. e shpenzimeve ekonomike | 2025<br>Vlera në € | 2026<br>Vlera në € | 2027<br>Vlera në € |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 6,917,528.00 | 6,917,528.00 | 6,881,418.48 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 572,474.00 | 678,950.00 | 857,980.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | 59,300.00 | 59,300.00 | 62,700.00 |
| 4 | Subvencionet | 90,000.00 | 100,000.00 | 100,000.00 |
| 5 | Investimet Kapitale | 156,518.00 | 261,859.85 | 514,000.00 |
| | **Gjithsej:** | **7,795,820.00** | **8,017,637.85** | **8,416,098.48** |

| *vitet* | *2025* | *2026* | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 864 | 864 | 864 |

| *Matjet Kryesore të Performancës* | *2025* | *2026* | *2027* |
|---|---|---|---|
| Vizita në shkolla | 400 | 400 | 400 |
| Organizimi i Testit Shtetëror të Maturës | 2 | 2 | 2 |
| Organizimi i Testit të Arritshmërisë | 1 | 1 | 1 |
| Vlerësimet e brendshme | 100 | 100 | 100 |
| Organizimi i garave në nivel shkolle, komune, rajoni dhe republike | 45 | 45 | 45 |
| Mbajtja dhe organizimi i Ditëve të Shkollave | 27 | 27 | 27 |
| Vizita dhe kontrolla të administratës së shkollave | 100 | 100 | 100 |
| Vizita për renovime dhe mbikëqyrje të shkollave | 130 | 130 | 130 |
| Regjistrimi i inventarit në shkolla | 1 | 1 | 1 |
| Shpallja e konkurseve të rregullta dhe të jashtëzakonshme | 6 | 6 | 6 |
| Rrjedha e parasë | 1 | 1 | 1 |
| Deklarimi i faturave të papaguara | 12 | 12 | 12 |
| Zotimi i mjeteve buxhetore | 12 | 12 | 12 |
| Shpenzimi i mjeteve buxhetore | 12 | 12 | 12 |
| Takimet e rregullta me drejtorë shkollash, me zyrtarë të rajonit dhe të MASHT | 12+6+12 | 12+6+12 | 12+6+12 |
| Aktivitete sportive, kulturore | 9 | 9 | 9 |
| Aktivitete profesionale | 3 | 3 | 3 |

# 13. DREJTORISË PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE

***Misioni***
*DSHMS-ja ka për mision të vetin të sigurojë, përforcojë dhe ofrojë qasje në shërbime cilësore të kujdesit primar shëndetësor, staf mjekësor të shkathët dhe programe inovative si dhe të zhvillojë sistemin e ofrimit të mbrojtjes parësore shëndetësore sa më cilësore, duke u bazuar në nevojat e popullatës në tërë territorin e komunës si dhe përkujdesjen sociale për të gjithë banorët, veçmas të atyre me status të rëndë social, në kuadër të mundësive të saja . Funksionin e sajë e kryen përmes Kujdesit Primar Shëndetësor QKMF, Qendrës për Pune Sociale QPS, Shtëpisë së Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare SHPMPF dhe Administratës.*

**Objektivat e drejtorisë**

- Përmirësimi i menaxhimit në drejtim të caktimit të qartë të prioriteteve në lidhje me kujdesin shëndetësor si dhe involvimin e partnerëve në çështjet ku është e nevojshme një çasje gjithëpërfshirëse;
- Vendosja e një agjende të saktë në lidhje me aktivitetet, çasje stimulative në aplikimin e njohurive ekzistuese si dhe ofrimin e mundësisë për zgjerim të njohurive dhe shkathtësive për stafin, përmes zhvillimit të vazhdueshem profesional;
- Vendosja e normave dhe standardeve si dhe promovimi dhe monitorimi i implemetimit të tyre duke pas parasysh mjekësinë e bazuar në të dhëna bashkëkohore dhe artikulimin e çështjeve që kanë të bejnë me etikën profesionale;
- Ofrimi i mbështetjës teknike, inicimin e ndryshimeve dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale të qëndrueshëm;
- Monitorimi i gjendjes shëndetësore si dhe vlerësimin e trendëve shëndetësore në komunë.
- Përkrahja e aktiviteteve sociale përmes involvimit më të madh të QPS dhe SHPMPF (Shtëpisë se Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare) dhe partnerëve tjerë qeveritar dhe joqeveritar në rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale në komunë;
- Tani edhe me funksionalizimin e objektit të ri të QKMF-së do të ofrojmë një standardizim të infrastruktures moderne në kuadër te shërbimeve shëndetësore, ku do të mundësojmë efikasitet dhe sherbime më të shpejta më cilësorë dhe më bashkohore për qytetarët.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

## Drejtoria e Shëndetësisë dhe i Mirëqenjës Sociale:

| | | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | Kateg. e shpenzimeve ekonomike | 2025 | 2026 | 2027 |
| | | Vlera në € | Vlera në € | Vlera në € |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 1,850,736.00 | 2,001,529.15 | 2,047,222.24 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 711,718.00 | 886,300.00 | 900,300.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | 81,000.00 | 65,800.00 | 69,300.00 |
| 4 | Subvencionet | 230,000.00 | 230,000.00 | 235,000.00 |
| 5 | Investimet Kapitale | 55,534.00 | 215,000.00 | 220,083.79 |
| | **Gjithsej:** | 2,928,988.00 | 3,398,629.15 | 3,471,906.03 |

| vitet | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 235 | 235 | 235 |

1. Objektivat e Performancës

| *Matjet Kryesore të Përformancës* | *2025* | *2026* | *2027* |
|---|---|---|---|
| Vizita mjekësore | 200.000 | 210.000 | 215.000 |
| Shërbime përcjellëse shëndetësore (injeksione, infuzione, inhalime, pastrim dhe përpunim plagësh, EKG etj) | 300000 | 355000 | 260000 |
| Vizita mjekësore shtëpiake | 1000 | 1100 | 1200 |
| Vizita stomatologjike | 12000 | 15000 | 20000 |
| Vizita konsultative – specialistike (pediatri, radiologji, pulmologji, mjekësi pune ) | 40000 | 45000 | 50000 |
| Vizita gjinekologjike me rreth 400 lindje (materniteti, gjinekologjia, këshillimorja etj. ) | 8000 | 9000 | 10000 |
| Shërbime stomatologjike | 200000 | 220000 | 25000 |
| Shërbime laboratorike (analiza biokimike, hematologjie dhe bakteriologjike) | 90000 | 95000 | 100000 |
| Shërbime në röntgen dhe ultrazëri | 8000 | 8500 | 9000 |
| Vaksinimi i fëmijëve në teren | 20000 | 1900 | 1850 |
| Edukimi i vazhdueshëm profesional (mjekë dhe tek.) | 50 | 50 | 50 |
| Edukimi shëndetësor i popullatës në teren(13 QF x 2) | 45 | 50 | 55 |
| Bartja e pacientëve në QKU për trajtim të mëtejshëm) | 2000 | 1800 | 1700 |
| Bartja e pacientëve për dializë(10.000 km) trajtimi tri herë në javë | 19 | 20 | 22 |

# 14. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Deklarata e misionit

- *Që të zhvillojë dhe të siguroj me efektivitet dhe efikasitet:*
- *Kushtet higjieniko-sanitare dhe teknike në ambientet ku qytetarët e Skenderjt jetojnë, punojnë, edukohen, shërohen, argëtohen, etj.*
- *Normat dhe standardet e operatorëve që kryejnë veprimtari ligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie,*
- *Implementimin e masave dhe programeve preventive përmes zhvillimit dhe forcimit të inspektimeve kompetente ligjore.*

**Deklarata e Vizionit :** Vizioni i DI-së është mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e shëndetit publik, mbikqyrja dhe aplikimi i ligjeve për planin zhvillimor, rregullativ dhe urbanistik, përmes inspektimeve, vendimeve, pëlqimeve, evidentimeve dhe ndërmarrjen e masave ligjore ndaj subjekteve – operatorëve që kryejnë veprimtari joligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie duke siguruar kushte dhe ambient të shëndoshë për qytetarët e komunës.

**Deklarata e Qëllimit :** Mbikqyrja dhe aplikimi i ligjeve dhe akteve tjera ligjore në fushën e ndërtimit, tregut sanitar, veterinarisë, bujqësisë, mbrojtjes së ambientit, trafikut urban - komunikacionit, hidroekonomisë, rrugëve etj. Promovimi i kushteve higjieniko - sanitare dhe teknike në institucionet publike dhe private. Zhvillimi i resurseve humane dhe forcimi i llogaridhënies

**Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar**

**Inspektimet**

| | | VITET | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Kateg. e shpenzimeve ekonomike** | **2025** | **2026** | **2027** |
| | | **Vlera në €** | **Vlera në €** | **Vlera në €** |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 99,200.00 | 99,200.00 | 101,000.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 110,150.00 | 110,150.00 | 110,150.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | - | - | - |
| 5 | Investimet Kapitale | - | - | - |
| | **Gjithsej:** | **209,350.00** | **209,350.00** | **211,150.00** |

| *Vitet:* | *2025* | *2026* | *2027* |
|---|---|---|---|
| Burimet e pozitave | 10 | 10 | 10 |

# 15. DREJTORIA E PROKURIMIT

***Misioni***
*Drejtoria e Prokurimit është të sigurojë që proceset e prokurimit të jenë të efektshme transparente dhe të përgjegjshme duke ofruar vlerë maksimale për organizatën dhe duke mbështetur objektivat strategjike që i referohet procesit në të cilin autoritetet/entet kontraktore blejnë mallra, punë ose shërbime nga operatorët ekonomikë është garantimi i zbatimit të rregullave të legjislacionit në fushën e prokurimit publik. Në këto kushte, prioritet mbetet respektimi i parimeve të tilla si mos diskriminimi, trajtimi i barabartë, mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive, rritja e transparencës etj, të ndërlidhura me luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit dhe konsumatorit, etj.*

Drejtoria funksionon përmes një sektori te vetëm siç ishte edhe para themelimit te saj i tërë stafi pavarësisht punëve voluminoze mbetet i njëjtë.

**PUNËT E DREJTORISË SË PROKURMIT PUBLIK DO TË ORIENTOHEN NË :**

1. Planifikimi preliminar , përfundimtar , indikativ dhe Strategjia e prokurimit
2. Përgatitja e procedurave të prokurimit (furnizime , shërbime , kapitale ejt.)
3. Planifikim i buxhetit –analiza e nevojave
4. Përgatitjen e përgjigjejeve ndaj kërkesave për rishqyrtim dhe Ankesave nga OE
5. Përgatitja e raporteve të rregullta sipas LPP-së
6. Raportimin e rregullt në KRPP, ZKA
7. Krijimin e politika të favorshme në fushën e prokurimit
8. Krijimin e kushteve të favorshme për konkurrencë të mirëfilltë
9. Efikasiteti dhe Transparenca: Përmirëson menaxhimin financiar dhe rrit transparencën në proceset e prokurimit

Kjo qasje jo vetëm që ndihmon në përdorimin efikas të burimeve, por gjithashtu forcon kapacitetet institucionale për menaxhimin e prokurimit dhe përmirësimin e rezultateve financiare dhe operacionale.

| | **DREJTORIA E PROKURIMIT** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **VITET** | | |
| | **Kateg. e shpenzimeve ekonomike** | **2025** | **2026** | **2027** |
| | | **Vlera në €** | **Vlera në €** | **Vlera në €** |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 69,000.00 | 69,000.00 | 72,000.00 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 13,140.00 | 13,140.00 | 15,000.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | - | - | - |
| 4 | Subvencionet | - | - | - |
| 5 | Investimet Kapitale | - | - | - |
| | **Gjithsej:** | **82,140.00** | **82,140.00** | **87,000.00** |

| *vitet* | *2025* | *2026* | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Numri i të punësuarve** | 8 | 8 | 8 |

- Objektivat e Performancës

| Matjet Kryesore të Përformancës | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| Kostoja e prokurimit-Kosto totale te Pronësisë<br>Kostot e kursyera përmes Prokurimit<br>Kosto për njësi të blerë<br>Efikasiteti i Procesit te prokurimit-Ciklit të prokurimit<br>Koha përgjegjëses në prokurim<br>Menaxhimi i furnitorëve –Diversifikimi<br>Përformanca e financave<br>Inovacioni dhe Qëndrueshmëria<br>Përqindja e Prokurimeve te qëndrueshme<br>Trajnimi dhe zhvillimi i stafit<br>Komunikimet me KRPP, OSHP, AQP<br>Nr. i Ankesave ne Procedura | | | |
| **Menaxhimi i shpenzimit të fondeve ne dispozicion** | **2025** | **2026** | **2027** |
| Proceset dhe procedurat e prokurimit<br>Trajnimi dhe zhvillimi profesional i stafit -Certifikimi<br>Inovacioni dhe teknologjia | | | |

| | **KOMUNA:** | **VITET** | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Kateg. e shp. ekonomike** | **2025** | **2026** | **2027** |
| | | **Vlera në €** | **Vlera në €** | **Vlera në €** |
| 1 | Pagat dhe Mëditjet | 10,745,364.00 | 10,896,157.15 | 10,977,540.72 |
| 2 | Mallrat dhe Shërbimet | 2,846,807.00 | 3,100,285.00 | 3,494,455.00 |
| 3 | Shërbimet Komunale | 287,300.00 | 272,100.00 | 287,000.00 |
| 4 | Subvencionet | 1,147,000.00 | 1,222,000.00 | 1,287,000.00 |
| 5 | Investimet Kapitale | 4,855,000.00 | 5,312,913.85 | 5,703,464.28 |
| | **Gjithsej:** | **19,881,471.00** | **20,803,456.00** | **21,749,460.00** |

| *Vitet:* | **2025** | **2026** | **2027** |
|---|---|---|---|
| Pozitat e kërkuara | 1,329 | 1,329 | 1,329 |

Skenderaj,
Datë 13.06.2024

Kryetari i Komunës
z. Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr/No. 02-110/01-0027864/24
Data/Data 14 06 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opstina Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt i datës 03.12.2008, nenin 45, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-125, si dhe nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2020 Kujdesi Paræsor Shëndetësor, Kryetari i Komunës së Skenderajt z.Fadil Nura i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e rregullt të datës __________ 2024, të miratojë këtë:

## PROPOZIM

**I.** Për miratimin e Draft-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj.

**II.** Draft Statuti i cekur në pikën **I** të këtij propozimi është punuar në mënyrë profesionale nga komisioni i emëruar me Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.02-020/01-0013509/24, të datës 12.03.2024, sipas formës unike të përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

**III.** Drafti i cekur në pikën **I** ka kaluar procedurat e diskutimit publik, në bazë të udhëzimeve përkatëse për dhënien në diskutim publik të akteve komunale.

**IV.** Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**SHTOJCË:** Bashkëngjitur Drafti i Statutit të QKMF-së.

**Propozimi i dërgohet:**
- Arkivit
- Kuvendit të Komunës

**Kryetari i Komunës**

Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-020/01-0013509/24
Data.
Data. 12.03.2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, si dhe kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë Nr.05-486 të datës 29.01.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**(Për formimin e komisionit)**

1. Me këtë vendim **formohet** komisioni për përgatitjen (hartimin) e draftit fillestar të "Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF)" në Komunën e Skenderajt, në këtë përbërje:

   **1.1 Besnik Smakaj**, kryesues
   **1.2 Emine Shabani-Goxhuli,** anëtare
   **1.3 Herolinda Rukolli Pirraku**, anëtare
   **1.4 Lavdije Deliu,** anëtare
   **1.5 Ali Lutfiu,** anëtar

2. **Detyrë e komisionit** është që bëjë përgatitjen (hartimin) e draftit fillestar të projekt-aktit të cekur në pikën I në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Ligjore të Komunës së Skenderajt, duke siguruar që të zbatohen të gjitha procedurat dhe parimet e parashikuara me ligjet në fuqi dhe aktet nënligjore, dhe me pas draftin e projekt aktit ta rekomandojnë tek Zyra e Kryetarit të Komunës për vazhdim të procedurave të mëtutjeshme ligjore.

3. Kryesuesi i komisionit njëherit është edhe zyrtar përgjegjës i përcaktuar në nenin 5 të Rregullores Nr.02/2021, i cili do t'a udhëheq tërë procesin e hartimit të projekt aktit të cekur në pikën I të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi i'u dërgohet:**
- Arkivit
- Anëtarëve të komisionit

**Kryetari i Komunës**
Fadil Nura

**Republika e Kosovës**
**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada – Government***

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH

# STATUTI

# I

# QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

# STATUTE

# of the

# MAIN FAMILY MEDICINE CENTER

# STATUT

# GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE

| Kompetencat e Kuvendit Komunal | Competencies of the Municipal Assembly | Nadležnosti Skupštine Opštine |
|---|---|---|
| Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 45, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125, nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor dhe sipas nenit 14 paragrafi 14.2 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr. 01-110-385, të datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur më datën ________________. | In support of Article 12, paragraph 12.2, point d) of Law No. 03/L-040 om Local Self – Govermment, related to Article 45, paragraph 1 and 2 of Law of Health No. 04/L-125, Article 6 of Administrative Instruction No. 04/2020 Primary Health Care and according to Article 14 paragraph 14.2 of the Statute of Municipality of Skenderaj No. 01-110-385, dated 03.12.2008, the Assembly of the Municipality of Skenderaj at the meeting held on ________________. | Na osnovu člana 45, stavke 1. i 2. Zakona o zdravlju br. 04/L-125,<br>U prilog članu 12, stav 12.2, tačka d) Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, u vezi sa članom 45, stav 1 i 2 Zakona o zdravstvu br. 04/L-125, član 6 Administrativnog uputstva br. 04/2020 Primarna zdravstvena zaštita i prema članu 14 stav 14.2 Statuta opštine Srbica br. 01-110-385, od 03.12.2008,<br>Skupština opštine Srbica na sednici održanoj ________________. |
| Miraton: | Adopts the following: | Usvaja: |
| **STATUTIN<br>E<br>QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE** | **STATUTE<br>OF THE<br>MAIN FAMILY MEDICINE CENTER** | **STATUT<br>GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE** |
| **Neni 1<br>I - Dispozitat e përgjithshme** | **Article 1<br>I – General provisions** | **Član 1<br>I - Opšte odredbe** |
| Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF, | This Statute regulates: general provisions, designation and headquarter, activity of MFMC, legal status, representation and presentation, structure of the institution, leadership and bodies of the institution, continuous institutional development, supervision of MFMC, general acts of MFMC, | Ovim Statutom se uređuju: opšte odredbe, naziv i sedište, delovanje GCPM-a, pravni status, zastupanje i prikazivanje, struktura institucije, rukovodstvo i tela institucije, |

| | | |
|---|---|---|
1.For the fulfillment of special tasks, the Board of Directors, through the director of MFMC, establishes Professional Bodies in MFMC, such as:

1.1.Professional Council;
1.2.MFMC Disciplinary Commission;
1.3.MFMC Complaints Commission;
1.4.Committee on Quality and Safety of Health Services;

**Član 16**

1.Direktor ima zadatak da tokom rada i odluka koje donosi Upravni savet, skrene pažnju:

1.1.Ukoliko su predloženi akti u suprotnosti sa relevantnim zakonima, odnosno u suprotnosti sa opštim aktima GCPM-a;

1.2.Ukoliko je predloženi akt u suprotnosti sa Programom rada GCPM-a;
1.3.Ukoliko predloženi akt ne doprinosi cilju.

**Član 17**
**Tela GCPM-a**

1.Da bi ispunio posebne zadatke, Upravni savet, preko direktora GCPM-a, formira profesionalna tela pri GCPM-u, kao što su:

1.1.Profesionalni savet;
1.2.Disciplinska komisija GCPM-a;
1.3.Komisija za žalbe GCPM-a;

<table>
<tr>
<td>3.Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF, sipas nevojës, mund të formojë edhe trupa të tjerë profesional në QKMF.<br><br>Neni 18<br>Këshilli Profesional<br><br>1.Këshilli Profesional është trup këshillëdhënës i Drejtorit të QKMF.<br><br>2.Këshilli Profesional përbëhet nga Udhëheqësit e Departamenteve, Udhëheqësit e Sektorëve dhe Njësive, Shefit të Barnatores qendrore si dhe Kryeinfermieri/ja e QKMF, sipas nenit 9 të këtij Statuti.<br><br>3.Kryetar i Këshillit Profesional, sipas detyrës zyrtare, është Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare të QKMF.<br><br>4.Këshilli Profesional harton Rregulloren e punës për punën e Këshillit.<br><br>5.Kryetari i Këshillit Profesional i kryen këto punë:<br>5.1.Përgatit, thërret dhe udhëheq takimet e Këshillit Profesional;<br>5.2.Verifikon rendin e ditës së takimeve;</td>
<td>1.5.Professional Ethics Commission.<br><br>2.The members of the professional bodies are appointed by the Director of MFMC.<br><br>3.The Board of Directors, if necessary, may establish other professional bodies in the MFMC through the Director of MFMC.<br><br>Article 18<br>Professional Council<br><br>1.The Professional Council is an advisory body to the MFMC Director.<br><br>2.The Professional Council consists of the Heads of Departments, the Heads of Sectors and Units, the Head of the Central Pharmacy and the Head Nurse of the MFMC, in accordance with article 9 of this Statut.<br><br>3.According to the official duty, the Head of the Department of Family Medicine of MFMC is the Chairman of the Professional Council.<br><br>4.The Professional Council drafts the Rules of Procedure for the work of the Board.<br><br>5.The Chairman of the Professional Council performs the following tasks:</td>
<td>1.4.Komitet za kvalitet i sigurnost zdravstvenih usluga;<br>1.5.Etičko – profesionalna komisija.<br><br>2.Članove stručnih tela imenuje direktor GCPM-a.<br><br>3.Upravni savet, preko direktora GCPM-a, prema potrebi, može da formira i druga profesionalna tela u GCPM-u.<br><br>Član 18<br>Profesionalni savet<br><br>1.Profesionalni savet je savetodavno telo direktora GCPM-a.<br><br>2.Profesionalni savet se sastoji od rukovodioca Odeljenja, rukovodioca Sektora i Jedinica, šefa centralne Apoteke kao i glavne medicinske sestre GCPM-a, prema članu 9. ovog Statuta.<br><br>3.Predsednik Profesionalnog saveta, prema službenoj dužnosti, je rukovodilac Odeljenja porodične medicine GCPM-a.<br><br>4.Stručni savet izrađuje Pravilnik o radu Saveta.</td>
</tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| 5.3.Siguron mbajtjen e procesverbalit të takimeve.<br><br>6.Kryetari i Këshillit Profesional është i obliguar ta thërrasë mbledhjen brenda 3 (tri) ditëve, nga dita kur këtë e kërkon drejtori i QKMF.<br><br>7.Këshilli Profesional i QKMF, përveç detyrave të parapara me ligj, i kryen edhe këto detyra:<br>7.1.Shqyrton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike;<br>7.2.Propozon Këshillit Drejtues dhe drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë;<br>7.3.Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale;<br>7.4.Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve shëndetësor në përsosje profesionale<br><br>7.5.Kërkon raport me shkrim nga profesionistët shëndetësor për njohuritë e fituara nga ZhVP; | 5.1.Prepares, convenes and chairs the meetings of the Professional Council;<br>5.2.Verifies the agenda of meetings;<br>5.3.Ensures that the minutes of the meetings are kept.<br><br>6.The Chairman of the Professional Council is obliged to call the meeting within 3 (three) days, from the day upon which this is requested by the director of the MFMC.<br><br>7.In addition to the duties provided by law, the Professional Council performs also these duties:<br>7.1.Reviews and decides on the need and professional reasons for the implementation of new diagnostic and therapeutic methods and procedures;<br>7.2.Proposes to the Board of Directors and the director taking of professional measures to improve the organization of work and conditions for the conduction of the activity;<br>7.3.Proposes the structure of internal supervision, related to the work of health employees as well as measures for improving the professional performance;<br>7.4.Reviews the need for continuous professional development and proposes to the director the sending of health | 5.Predsednik Stručnog saveta obavlja ove poslove:<br>5.1.Priprema, saziva i vodi sastanke Stručnog saveta;<br>5.2.Utvrđuje dnevni red sastanaka;<br>5.3.Obezbeđuje vođenje zapisnika na sastancima.<br><br>6.Predsednik Stručnog saveta je obavezan da sazove sastanak u roku od 3 (tri) dana, od trenutka kada to zahteva direktor GCPM-a.<br><br>7.Profesionalni savet GCPM-a, osim zadataka predviđenih zakonom, obavlja i ove zadatke:<br>7.1.Razmatra i odlučuje o potrebama i profesionalnim razlozima za primenu novih dijagnostičkih i terapeutskih metoda i postupaka;<br>7.2.Predlaže Upravnom savetu i direktoru preduzimanje stručnih mera za poboljšanje organizovanja rada i uslova za razvoj delatnosti;<br>7.3.Predlaže strukturu unutrašnjeg nadzora, u vezi sa radom zdravstvenih radnika kao i mere za poboljšanje profesionalnog rada;<br><br>7.4.Razmatra potrebu za kontinuirani profesionalni razvoj i predlaže direktoru |

| | | |
|---|---|---|
| 7.6.Shqyrton dhe vendos për çështje të tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit Profesional.<br><br>**Neni 19**<br>**Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore**<br><br>1.Në QKMF funksionon Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore.<br><br>2.Komiteti për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore (në vazhdim vetëm Komiteti) është një ekip multi-disciplinar i cili përbëhet nga:<br>2.1.1Drejtori i institucionit;<br>2.1.2Drejtori i infermierisë, Kryeinfermieri në QKMF;<br>2.1.3Koordinatori për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;<br>2.1.4Drejtori shëndetësor, Kryeshefi i Departamentit në MF;<br>2.1.5Drejtori operativ-administrates, Kryeshefi i administratës në KPSh;<br><br>2.2Varësisht nga institucioni shëndetësor, ky komitet mund të ketë edhe anëtarë të tjerë; | employees to professional development programs/opportunities;<br>7.5.Requires written reports from health professionals on the knowledge gained from the CPD;<br>7.6.Reviews and decides on other matters, which are submitted to the Professional Council by the director.<br><br>**Article 19**<br>**Committee on Quality and Safety of Health Services**<br><br>1.There is a Committee on Quality and Safety of Health Services which operates within the MFMC.<br><br>2. The Committee on Quality and Safety of Health Services (hereinafter referred to only as: the Committee) is a multi-disciplinary team consisting of the:<br>2.1.1Director of Institution;<br>2.1.2Director of Nursing Ward, Head Nurse at the MFMC;<br>2.1.3Coordinator for ensuring the quality and safety of health services;<br>2.1.4Health Director, Chief of Department in the PHC;<br>2.1.5Director of Operations-Administration, Chief of Administration in the PHC; | da se zdravstveni radnici šalju na profesionalno obučavanje;<br><br>7.5.Traži pismeni izveštaj od zdravstvenih stručnjaka o znanju stečenom od KPR-a;<br><br>7.6.Razmatra i odlučuje o ostalim pitanjima, koja direktor postavlja pred Upravnim savetom.<br><br>**Član 19**<br>**Komitet za kvalitet i sigurnost zdravstvenih usluga;**<br><br>1.U GCPM funkcioniše Komitet za obezbeđivanje kvaliteta zdravstvenih usluga.<br><br>2.Komitet kvaliteta i obezbeđivanje zdravstvenih usluga (u nastavku samo Komitet) je više-disciplinska ekipa koja se sastoji od:<br>2.1.1 Direktora ustanove;<br>2.1.2. Direktora nege, Glavne sestre u GCPM-u;<br>2.1.3. Koordinator za obezbeđivanje kvaliteta i obezbeđivanje zdravstvenih usluga;<br>2.1.4. Direktor zdravlja, Glavni šef odeljenja u PM-u;<br>2.1.5.Operativni-administracioni direktor, Glavni šef administracije u ISZ-u; |

| | | |
|---|---|---|
| 2.3Detyrat dhe përgjegjësitë e komitetit janë të bazuara në dispozitat e statutit të institucionit shëndetësor. | 2.2Depending on the health institution, this committee may have other members, as well;<br>2.3The duties and responsibilities of the committee are based on the provisions of the statute of the health institution. | 2.2.Zavisno od zdravstvene ustanove, ovaj komitet može imati i druge članove;<br><br>2.3.Zadaci i odgovornosti komiteta su osnovane prema odredbama statuta zdravstvene ustanove. |
| **Neni 20**<br>**Komisioni Etik-Profesional**<br><br>Komisioni Etik - Profesional është trup i cili denoncon rastet e shkeljeve sipas ligjit për odat e profesionistëve shëndetësor. | **Article 20**<br>**Professional Ethics Commission**<br><br>The Professional Ethics Commission is a body that reports the cases of violations pursuant to the law on chambers of healthcare professionals. | **Član 20**<br>**Etičko-profesionalna komisija**<br><br>Eričko-profesionalna komisija je telo koje osuđuje slučajeve kršenja po zakonu za komore zdravstvenih stručnjaka. |
| **Neni 21**<br><br>Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjerë përcaktohen me aktet nënligjore, të nxjerra nga Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga MSH. | **Article 21**<br><br>Duties and responsibilities of other bodies are defined by sub-legal acts, issued by the Board of Directors, through the Director of MFMC, if they are not defined by other acts of the MoH. | **Član 21**<br><br>Zadaci i odgovornosti ostalih tela se određuju podzakonskim aktima, usvojenih od Upravnog saveta, preko direktora GCPM-a, ukoliko one nisu određene ostalim aktima od strane MZ. |
| **Neni 22**<br>**Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional**<br><br>1.Institucionet shëndetësore në KPSh janë të obliguara që të mundësojnë dhe përkrahin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësorë. | **Article 22**<br>**Continous Professional Development**<br><br>1.Health institutions in the PHC are obliged to enable and support the continuous professional development of their health employees. | **Član 22**<br>**Kontinuirani profesionalni razvoj**<br><br>1.Zdravstvene ustanove u ISZ-u su dužne da omoguće i podrže kontinuiran stručni razvoj njihovih zdravstvenih radnika. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është i obligueshëm për të gjithë profesionistët shëndetësore në KPSh, dhe zbatohet sipas planprogramit, të aprovuar nga Odat e Profesionisteve Shëndetësorë.<br><br>3.Për zhvillimin e aktiviteteve, nga paragrafi 2 i këtij neni përgjegjës janë Koordinatorët dhe trajnuesit në Programet e Mjekësisë Familjare dhe të Infermierisë Familjare, të cilët duhet të kenë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale dhe caktohen sipas Termave të Referencës të hartuara nga Ministria e Shëndetësisë.<br><br>4.Financimi i ZHVP të profesionistët shëndetësor bëhet nga buxheti i QKMF-së dhe burime të tjera bazuar në aktet normative në fuqi.<br><br>**VI-Mbikëqyrja e QKMF**<br><br>**Neni 23**<br>**Llojet e mbikëqyrjes në QKMF**<br><br>1.QKMF i nënshtrohet mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme në pajtim me dispozitat në fuqi që sigurohet përmes DKShMS dhe autoriteteve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. | 2.Continuous professional development is mandatory for all health professionals in the PHC, and is implemented according to the curriculum, approved by the Chambers of Health Professionals.<br><br>3.Persons responsible for conducting the activities, from paragraph 2 of this article are the Coordinators and trainers in the Family Medicine and Family Nursing Programs, who must have adequate academic and professional training and are appointed pursuant to the Terms of Reference drafted by the Ministry of Health.<br><br>4.The financing of CPD of health professionals is carried out using the MFMC budget and other sources based on normative acts in force.<br><br>**VI- Supervision of the MFMC**<br><br>**Article 23**<br>**Types of supervision in the MFMC**<br><br>1.The MFMC is subject to internal and external legal and professional supervision in accordance with the provisions, which is ensured through the MDHSW and authorities designated by the Ministry of Health | 2.Kontinuirani stručni razvoj je obavezan za sve zdravstvene stručnjake u ISZ-u, i primenjuje se prema planu i programu usvojenom od Komore zdravstvenih stručnjaka.<br><br>3.Za razvoj aktivnosti, iz stava 2 ovog člana 31, odgovorni su koordinatori i treneri u Programima porodične medicine i porodične nege, koji treba da imaju adekvatno akademsko i profesionalno zvanje i koji se određuju po opisu zadataka izrađenom od Ministarstvu zdravlja.<br><br>4.Finansiranje KPR-a zdravstvenih stručnjaka se obavlja iz budžeta GCPM-a i ostalih izvora na osnovu normativnih akata na snazi.<br><br>**VI- Nadzor GCPM-a**<br><br>**Član 23**<br>**Vrste nadzora u GCPM-u**<br><br>1.GCPM se podvrgava unutrašnjem i spoljnom nadzoru u skladu sa odredbama na snazi koje |

| | | |
|---|---|---|
| 2.Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme, të cilën e propozon Këshilli Drejtues i QKMF.<br><br>3.Mbikëqyrja e QKMF përfshin:<br>3.1.Mbikëqyrjen dhe inspektimin e objekteve të KPSH për infrastrukturën dhe menaxhimin e objekteve;<br>3.2.Mbikëqyrjen dhe inspektimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, sipas normave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria;<br>3.3.Mbikëqyrjen dhe monitorimin e raporteve dhe procedurave financiare, për menaxhimin e fondit të alokuar, të paraparë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe rregullat e Prokurimit Publik.<br><br>**VII- Aktet nga veprimtaria e Institucionit**<br><br>**Neni 24**<br>**Aktet e përgjithshme**<br><br>1.Me propozim të Drejtorit, Këshilli Drejtues i QKMF nxjerr këto akte të përgjithshme: | 2.Internal supervision of professional work is carried out in the manner provided by the regulation on internal supervision, which is proposed by the Board of Directors of the MFMC.<br>3.Supervision of the MFMC includes:<br>3.1.Supervision and inspection of PHC facilities regarding the infrastructure and management of facilities;<br>3.2.Supervision and inspection of the provision of quality health services, according to the norms and standards set by the Ministry;<br>3.3.Supervision and monitoring of financial reports and procedures, in relation to the management of the allocated fund, provided by the Ministry of Health, Ministry of Finance and Public Procurement rules.<br><br>**VII- Institution activity acts**<br><br>**Article 24**<br>**General acts**<br><br>1.At the proposal of the Director, the MFMC Board of Directors issues the following general acts:<br>1.1.Regulation on internal organization and systematization of job positions; | pružaju, koje se osigurava preko ODZSZ-a i vlasti određene od Ministarstvo zdravstva.<br><br>2.Unutrašnji nadzor stručnog rada se obavlja na način predviđen Pravilnikom o unutrašnjem nadzoru, koji predlaže Upravni savet GCPM-a.<br><br>3.Nadzor GCPM-a uključuje:<br>3.1.Nadzor i obavljanje inspekcije objekata PZN-a za infrastrukturu i rukovodstvo objekata;<br>3.2.Nadzor i obavljanje inspekcije pružanja kvalitetnih zdravstvenih usluga, prema normama i standardima određenih od Ministarstva;<br>3.3.Nadzor i nadgledanje finansijskih izveštaja i procedura, za upravljanje izdvojenim fondom, predviđenim od Ministarstva zdravstva, Ministarstva finansija i pravilima Javne nabavke.<br><br>**VII- Akti za delatnost institucije**<br><br>**Član 24**<br>**Opšti akti**<br><br>1.Na predlog direktora, Upravni savet GCPM-a usvaja ove opšte akte: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1.Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;<br>1.2.Rregulloren për punë;<br>1.3.Rregulloren për mbrojtjen në punë;<br>1.4.Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit;<br>1.5.Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;<br>1.6.Rregulloren për rendin shtëpiak;<br>1.7.Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme;<br>1.8.Rregulloren për parandalimin e infeksioneve;<br>1.9.Rregullore të tjera për mbarëvajtjen e punës në QKMF. | 1.2.Rules of procedure;<br>1.3.Regulation on protection at work;<br>1.4.Fire Protection Regulation;<br><br>1.5.Regulation on internal accounting;<br><br>1.6.Regulation on house rules;<br>1.7.Regulation on internal supervision;<br><br>1.8.Regulation on prevention of infections;<br>1.9.Other regulations on the progress of work in the MFMC. | 1.1.Pravilnik o unutrašnjem organizovanju i sistematizaciji radnih mesta;<br>1.2.Pravilnik o zaštiti na radu;<br>1.3.Pravilnik o zaštiti na radu;<br>1.4.Pravilnik o zaštiti protiv požara;<br><br>1.5.Pravilnik o unutrašnjem računovodstvu;<br>1.6.Pravilnik o kućnom redu;<br>1.7.Pravilnik o unutrašnjem nadzoru;<br><br>1.8.Pravilnik o sprečavanju infekcija;<br><br>1.9.Ostale Pravilnike o radu u GCPM-a. |
| **VIII- Pronësia, Buxheti dhe Financat** | **VIII-Ownership, Budget and Finance** | **VIII- Imovina, budžet i finansije** |
| **Neni 25**<br>**Pronësia** | **Article 25**<br>**Ownership** | **Član 25**<br>**Imovina** |
| 1.QKMF ka në shfrytëzim mjetet dhe pasurinë, e cila është pronë e Kuvendit Komunal. | 1.The means and property in use by the MFMC are in the ownership of the Municipal Assembly. | 1.GCPM koristi sredstva i imovinu, koja je imovina Skupštine Opštine. |
| 2.QKMF si institucion i KPSh është përvetësuese e fondit për financim nga Buxheti i Kosovës. | 2.The MFMC as an institution of PHC is the beneficiary of the financing fund from the Kosovo Budget. | 2.GCPM kao institucija PZN-a je korisnik fonda za finansiranje iz budžeta Kosova. |
| 3.Pasurinë e QKMF e përbëjnë asetet, të drejtat dhe të mirat materiale, me të cilat QKMF ka të | 3.The property of MFMC consists of assets, rights and material goods, which the MFMC is | 3.Imovinu GCPM-a čine oprema, prava i materijalna dobra, sa kojima GCPM ima pravo |

| | | |
|---|---|---|
| drejtë të disponojë në pajtim me aktet ligjore në fuqi.<br><br>**Neni 26**<br>**Buxheti**<br><br>1.Çështjet buxhetore dhe financiare të QKMF administrohen në mënyrë transparente, në pajtim me legjislacionin në fuqi për përdorimin e fondeve nga Buxheti i Kosovës, si dhe me të gjitha procedurat, në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Financave.<br><br>2.Buxheti dhe llogaritë e QKMF përfshijnë tërë shpenzimet operative të njësive punuese.<br><br>3.Prokurimi i QKMF bëhet në pajtim me rregullat e Prokurimit Publik sipas Ligjit në fuqi dhje akteve nën-ligjore.<br><br>4.Drejtori mund të kërkojë auditim të jashtëm dhe të monitorojë shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.<br><br>**Neni 27**<br>**Financimi** | entitled to possess in accordance with the legal acts in force.<br><br>**Article 26**<br>**Budget**<br><br>1.MFMC budgetary and financial issues relating to the the use of funds from the Kosovo Budget are administered in a transparent manner, in accordance with the legislation in force and all procedures, pursuant to the guidelines of the Ministry of Finance.<br><br>2.The budget and MFMC financial accounts include all operating expenses of the working units.<br><br>3.Procurement in the MFMC is carried out in accordance with the rules of Public Procurement pursuant to the Law in force and sub-legal acts.<br><br>4.The director may request an external audit and monitor the proper use of the funds.<br><br>**Article 27**<br>**Financing**<br><br>1.In accordance with the Law on Health of Kosovo, the Law on Local Self-Government, | da raspolaže u skladu sa zakonskim aktima na snazi.<br><br>**Član 26**<br>**Budžet**<br><br>1.Budžetska i finansijska pitanja GCPM se upravljaju na transparentan način, u skladu sa uredbama o korišćenju fondova iz budžeta Kosova, kao i sa svim procedurama, u skladu sa uputsvima Ministarstva finansija.<br><br>2.Budžet i računi GCPM-a obuhvataju sve operativne troškove radnih jedinica.<br><br>3.Nabavka u GCPM se obavlja u skladu sa pravilima Javne nabavke prema Zakonu na snazi i podzakonskim aktima.<br><br>4.Direktor može da zahteva spoljnu reviziju i da posmatra pravilno korišćenje sredstava.<br><br>**Član 27**<br>**Finansiranje**<br><br>1.GCPM koristi finansijske izvore u skladu sa Zakonom o zdravstvu Kosova, Zakonom o lokalnoj samoupravi, iz budžeta Kosova, |

| | | |
|---|---|---|
| 1.QKMF shfrytëzon burimet financiare në harmoni me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nga Buxheti i Kosovës, Buxheti i Komunave dhe nga burimet e tjera, të parapara me ligjet përkatëse.<br><br>2.Procedura dhe forma e bashkëpagesës për shërbimet e ofruara në QKMF përcaktohet me akt nënligjor bazuar në Ligjin për Shëndetësi.<br><br>**Neni 28**<br>**Shtojca**<br><br>Aneksi 1 është pjesë përbërëse e këtij Statuti.<br><br>**IX- Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**<br><br>**Neni 29**<br>**Perioda kalimtare dhe shfuqizimi**<br><br>1.Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë të këtij Statuti, mbeten aktet që janë në fuqi dhe që nuk janë në kundërshtim me këtë Statut.<br><br>2. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i QKMF-së në Skenderaj Nr. 01-110/04-0035371/21 i datës 15.07.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Statutin Nr. 01-110/04-0014864/22, të datës 05.04.2022. | the MFMC uses the financial resources from the Kosovo Budget, Budget of Municipalities and other sources, as provided for by relevant laws.<br><br>2.The procedure and form of co-payment for the services provided at the MFMC is determined by a sub-legal act based on the Law on Health.<br>**Article 28**<br>**Annex 1**<br><br>Annex 1 is an integral part of the present Statute.<br><br>**IX- Transitional and final provisions**<br><br>**Article 29**<br>**Transitional period and repeal**<br><br>1.Until the issuance of sub-legal acts based on this Statute, the acts that are in force and that are not in conflict with this Statute shall remain in force.<br><br>2.Upon the entry into force of this Statute, the Statute of the MFMC in Skenderaj is repealed, the Statute of MFMC of Skenderaj No. 01- | budžeta opština i iz ostalih izvora predviđenih dotičnim zakonima.<br><br>2.Procedura i oblik participacije za usluge pružene u GCPM-u se određuju podzakonskim aktom na osnovu Zakona o zdravstvu.<br><br>**Član 28**<br>**Dodatak**<br><br>Dodatak1 je sastavni deo ovog Statuta.<br><br>**IX- Prelazne i završne odredbe**<br><br>**Član 29**<br>**Prelazni period i obesnaživanje**<br>1.Do usvajanja podzakonskih akata na osnovu ovog Statuta ostaju na snazi postojeći akti koji nisu u suprotnosti sa ovim Statutom.<br><br>2.Stupanjem na snagu ovog Statuta obesnažuje se Statut GCPM-a u Srbici br. 01-110/04-0035371/21 od 15.07.2021. godine, dopunjen i izmenjen Statutom br. 01-110/04-0014864/22, od 04.05.2022.<br><br>**Član 30**<br>**Stupanje na snagu** |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 30**<br>**Hyrja në fuqi**<br><br>Ky Statut hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, dhe brenda shtatë (7) ditësh pas publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt. | 110/04-0035371/21 dated 15.07.2021, supplemented and amended by Statute No. 01-110/04-0014864/22, dated 04.05.2022.<br><br>**Article 30**<br>**Entry into force**<br><br>This Statute enters into force fifteen (15) days after registration in the Protocol Office of the Ministry of Administration and Local Government, and within seven (7) days after publication on the official website of the Municipality of Skenderaj. | Ovaj Statut stupa na snagu petnaest (15) dana nakon registracije u Kancelariji za protokol Ministarstva administracije i lokalne samouprave, iu roku od sedam (7) dana od dana objavljivanja na zvaničnom sajtu opštine Srbica. |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

# Procesverbal nga takimi i Komisionit për Hartimin e Statutit të QKMF-së në Skenderaj

Datë: 22.03.2024, ora 13:00

Vendi: Komuna Skenderaj / Salla e Bordit

Kryesues i mbledhjes: Kryesuesi i Komisionit, Besnik Smakaj

Në mbledhje morën pjesë: **Dr.Emine Goxhuli, znj.Lavdije Deliu dhe znj.Herolinda Rukolli Pirraku**

Në mbledhje mungon anëtari Ali Lutfiu, për shkak të një rasti në familje.

Procesmbajtës: Besnik Smakaj

**Qëllimi i takimit**: Shqyrtimi i formës unike të statutit të QKMF- ve dhe harmonizimi me nevojat e QKMF - së në Skenderaj.

**Besnik Smakaj:** Së pari ju përshëndes dhe ju uroj mirëseardhje.

E kemi thirrur sot këtë takim për të diskutuar rreth hartimit të Statutit të QKMF-së në Skenderaj,

Ne si Zyre Ligjore e Komunës së Skenderajt e kemi shikuar formën unike të statutit dhe kemi ndërhyrë tek baza ligjore e statutit dhe tek emërtimet, mirëpo për pjesën që I takon fushës së mjekësisë e kemi dërguar tek ju si anëtar të këtij komisioni dhe ekspert të fushës, në mënyrë që të ndërhyni në pjesët ku e shihni të nevojshme.

Andaj, fjala është për ju.

**Lavdije Deliu:** Ne e kemi dërguar edhe në Email formën e statutit me ndryshimet përkatëse, ku I kemi shënjuar me shenjë të kuqe, në mënyrë që ta shihni se ku kemi ndërhyrë.

**Besnik Smakaj:** Në rregull, e kam pranuar E-mailin.

**Lavdije Deliu:** Kemi ndërhy vetëm tek pjesa e vitit të themelimit dhe tek kriteret e përzgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit e kemi shenjuar me ngjyrë të kuqe, për arsye se e kemi diskutuar në mbledhjen e Këshillit Drejtues çështjen e mundësisë së rregullimit me status të zgjedhjes së zv.drejtorit.

Po ashtu kërkesë e drejtorit Dr.Bashkim Nura, ka qenë që me u përcaktu edhe kriteret për zgjedhjen e zv drejtorit të QKMF-së mirëpo kushtet dhe kriteret nuk përcaktohen me Statut për këtë arsye nuk e shënjova me të kuqe, por nëse doni e shtojmë.

**Emine Goxhuli:** Sa i përket vitit të themelimit, data e themelimit faktikisht viti kur është ndërruar emërtimi nga Shtëpia e Shëndetit në emërtimin Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare është n viti 2006, ndërsa Institucioni në bazë të librit amëz ka filluar punën në vitete 50-ta.

**Besnik Smakaj:** Në rregull, po besoj që kemi hapsirë me i përfshi të dy vitet në një fjali.

Një çështje tjetër është edhe emërtimi i QKMF-së me emrin "Dr. Fatmir Fazlija". Në statutin unik nuk ceket mirëpo e kemi vendin për emërtim sipas Komunës dhe aty mundemi me përfshi edhe emrin.

**Emine Goxhuli:** Të gjitha QKMF-të tani janë me emra dhe pajtohëm që edhe ne ta përfshijmë në Statut.

Edhe pjesëmarrësit e tjerë pajtohen dhe kjo pikë evidentohet në procesverbal.

**Emine Goxhuli:** Do të kisha propozu leximin e secilës pike të draftit të statutit.

**Besnik Smakaj:** Pajtohëm

**Lavdije Deliu:** Fillon leximin e Draft - Statutit në tërësi por me theks të veçantë në pikat ku është nderhyrë.

Komisioni pajtohet që të ndërhyhet në:

Nenin 14, paragrafi 2, pika 1, tek kriteret e përzgjedhjes së drejtorit, të futet fjalia "në rast mungese".

Neni 2, paragrafi 3, QKMF Fillon punën në vitet 1948-50, kurse emërtimin si QKMF e ka marrë në vitin 2006.

Neni 3, paragrafi 1, të përfshihet emri "Dr.Fatmir Fazlija".

Besnik Smakaj: Në rregull, faleminderit Lavdije.

Nëse nuk keni me shtu edhe diçka, propozoj që ta mbyllim takimin.

Pjesëmarrësit pajtohen dhe nënshkruhen në listen e pjesëmarrjes.

Kryesuesi mbylli takimin në ora: 13: 30.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. No. 02-110/01-0027865/24
Data Data 14.06.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opstina Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt i datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës së Skenderajt z.Fadil Nura i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e rregullt të datës ________ 2024, të miratojë këtë:

**PROPOZIM**

**I.** Për miratimin e Draft - Planit Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028 në Komunën e Skenderajt.

**II.** Draft-Plani Lokal i cekur në pikën **I** të këtij propozimi është punuar në mënyrë profesionale nga komisioni i emëruar me Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.09-052/01-0026181/24, të datës 04.06.2024, konform legjislacionit në fuqi në Republikës së Kosovës.

**III.** Drafti i cekur në pikën **I** ka kaluar procedurat e diskutimit publik, në bazë të udhëzimeve përkatëse për dhënien në diskutim publik të akteve komunale.

**IV.** Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**SHTOJCË:** Bashkëngjitur Draft-Palni i cekur në pikën **I** të këtij propozimi.

**Propozimi i dërgohet:**
- Arkivit
- Kuvendit të Komunës

**Kryetari i Komunës**

Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY
SKENDERAJ

Nr. 09-060/01-0026190/24
Data 04 06 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Shërbime Publike**
Direkcija za Javne Službe
Department for Public Services

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **04.06.2024** |
| **PËR/ZA/TO:** | **Zyrën Ligjore** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Arkivit** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Drejtori i Shërbimeve Publike- Alban Shala** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Propozim** |

Pas përfundimit te draft-Planit Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028, nga grupi punues për hartimin e këtij plani dhe mbajtjes se diskutimit publik, kërkoj nga zyra ligjore qe te propozoj si pike te rendit te ditës ne mbledhjen e ardhshëm te Komitetit për Politike dhe Financa.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 09-052/01-0026181/24
Data 04 06 2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Shërbime Publike**
Direkcija za Javne Službe
Department for Public Services

| | |
|---|---|
| DATA: | 04.06.2024 |
| PËR/ZA/TO | Zyrën e Kryetarit të Komunës se Skenderaj, z. Fadil Nura |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Drejtorit për Shërbime Publike, z. Alban Shala |
| NGA/OD/FROM; | Kryesuesi i Grupit Punues, z. Gani Kerolli |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | **RAPORT:** Hartimi i Draft Planit për Transportin Rrugor Lokal për Komunën e Skenderaj. |

Ne bazë të vendimit me nr.02-020/01-0011290/24 të datës 27.02.2024 nga zyra e kryetarit për formimin e Grupit Punues: Hartimi i Draft Planit për Transportin Rrugor Lokal për Komunën e Skenderaj me ketë përbërje:

1. Gani Kerolli-Kryesues, ____________
2. Besnik Smakaj-Anëtar, ____________
3. Brahim Smajli-Anëtar, ____________
4. Feriz Dajaku-Anëtar, ____________
5. Kreshnik Smakiqi-Anëtar, ____________
6. Hajzer Shala-Anëtar, ____________
7. Arben Zabeli-Anëtar, ____________

Gjatë punës për Hartimin e Draft Planit për Transportin Rrugor Lokal për Komunën e Skenderaj, drafti është hartuar nga grupi punues i përbërë prej shtata anëtareve. Ne baze të punës dhe dinamikes për hartimin e këtij drafti është marre ne konsideratë baza ligjore, udhëzimet administrative dhe rregullore për transportin rruguar ne Republikanë Kosovës.

Grupi punues ka organizuar edhe diskutimin publike sipas njoftimit publike të datës 20.05.2024 me nr.02-060/01-0023610/24 ne bazë të njoftimit për diskutimin publike, që ka qenë nga data 10.05.2024 deri më datën 31.05.2024 ne sallën e Kuvendi Komunal ne Skenderaj.

Ne diskutimin publik kanë marre pjesë mbi 16 qytetare , ku është bërë prezantimi, ku nuk kemi marre as një vejte apo komente për "Draft Planin për Transportin Rrugor Lokal për Komunën e Skenderaj.

Ne ketë raport keni të bashkangjiture procesverbalin e pjesëmarrjeve gjate diskutimit publik.

Ne ketë raport është bashkangjiture edhe "Draft Planin për Transportin Rrugor Lokal për Komunën e Skenderaj 2024-2028".

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr.
No. 02-020/01-0011290/24
Data
Data 27.02.2024

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13, nenit 58 pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, dhe pas shqyrtimit të kërkesës së DSHP-së Nr.09-020/01-0010735/24 të datës 22.02.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
# PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

I. **Formohet** grupi punues për hartimin e "Draft Planit për Transportin Rrugor Lokal për Komunën e Skenderajt", në këtë përbërje:

1. **Gani Kerolli** – DSHP, kryesues
2. **Besnik Smakaj** – Zyra Ligjore, anëtar
3. **Brahim Smajli** – DI, anëtar
4. **Feriz Dajaku** – DUMA, anëtar
5. **Kreshnik Smakiqi** - DGJKP, anëtar
6. **Hajzer Shala** – DShP, anëtar
7. **Arben Zabeli** – DA, anëtar

I. **Detyrë** e grupit punues nga pika **I** e këtij vendimi është hartimi i "Draft Planit për Transportin Rrugor Lokal për Komunën e Skenderajt"

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- DSHP-së
- Anëtarëve të grupit punues

**Kryetari i Komunës**

Fadil Nura

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr.
No. 02-060/01-0023610/24
Data.
Data. 20.05.2024

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Bazuar në ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Skenderajt, Udhëzimin Administrativ nr. 04/2023 për Administratë të hapur në Komuna (MAPL), Komuna e Skenderajt lëshon këtë

Njoftim publik

Lidhur me organizimin e konsultimit me qytetarë për Draft-Planin Lokal të Transportit Rrugor 2024-2028

Draft-Plani Lokal i Transportit Rrugor 2024-2028 do të jetë në konsultim publik nga data 10.05.2024 deri me datë 31.05.2024, ndërsa diskutimi publik me qytetarë do të mbahet me datë 28.05.2024, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 14:00.

Komentet dhe sugjerimet mund t`i dërgoni deri me datën 31.05.2024 në ora 16:00, në emailat e zyrtarëve: gani.kerolli@rks-gov.net dhe jeton.rushiti@rks-gov.net.

Për më shumë detaje për Draft-Planin Lokal të Transportit Rrugor 2024-2028, mund të vizitoni vegzën e mëposhtme

https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42380&fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTEAAR07K1sCy1FDDJwGW5uFR1iVxGn9Lh9NOFBw86WNARQz58iTimAqw6_pfxg_aem_AXVj9sZsPqZvST1d0OxkFxO2UnakEvwFlTBBN7TgIA8_PtE5lJKAX8la6-xmNYGn88id4MhJvULSMViiCPK3wmyY

Amir Lushtaku

Udhëheqës për Komunikim me Publikun

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

# PLANI LOKAL I TRANSPORTIT RRUGOR
# 2024-2028

**Skenderaj: 2024**

*Ne bazë të vendimit me nr.02-020/01-0011290/24 të datës 27.02.2024 nga zyra e kryetarit për formimin e Grupit Punues: Hartimi i Draft Planit për Transportin Rrugor Lokal për Komunën e Skenderaj me ketë përbërje:*

- **Grupi Punues:**

1. Gani Kerolli-Kryesues
2. Besnik Smakaj-Anëtar
3. Brahim Smajli-Anëtar
4. Feriz Dajaku-Anëtar
5. Kreshnik Smakiqi-Anëtar
6. Hajzer Shala-Anëtar
7. Arben Zabeli-Anëtar



## Përmbajtja:

1. Fushëveprimi i planit ........ 3
2. Korniza ligjore ........ 4
3. Synimet dhe vizioni ........ 4
4. Objektivat ........ 5
5. Infrastruktura e transportit ........ 6
6. Transporti Publik në Komunën e Skenderajt ........ 8
7. Transporti ndër-urban........ 9
8. Transporti publik-Urbano-Periferik ........ 10
9. Vend-parkingjet. ........ 11
10. Infrastruktura rrugore ........ 12
11. Analiza e gjendjes ekzistuese ........ 15
12. Siguria në trafik ........ 15
13. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal ........ 16
14. Trafiku për këmbësorë ........ 16
15. Trafiku për çiklistë ........ 16
16. Ngarkesa e trafikut ........ 18
17. Infrastruktura rrugore për personat me nevoja të veçanta ........ 18
18. Siguria në trafik në afërsi të shkollave ........ 19
19. Krijimi i shtigjeve për çiklistë ........ 22
20. Mirëmbajtja e rrugëve ........ 23
21. Plani i monitorimit ........ 23
22. Plani i veprimit, prioriteti dhe aktivitetet për vitin 2024-2028 ........ 24

## 1. FUSHËVEPRIMI I PLANIT

Plani Lokal i Transportit Rrugor është një plan strategjik zhvillimor nga fusha e komunikacionit për komunën e Skenderajt. Me këtë plan, tentohet fillimi i planifikimit të transportit rrugorë të qëndrueshëm dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.
Nga aspekti i komunikacionit, ky plan do të shërbejë si bazë e mirë për përpilimin e planeve dhe projekteve në komunën e Skenderajt, të cilat ndërlidhen me fushën e komunikacionit.
Gjatë hartimit të planit janë marrë në konsideratë trendët dhe zhvillimet më bashkëkohore në fushën e komunikacionit të qëndrueshëm urban dhe rural. Në këtë mënyrë, realizimi i Planit Lokal të Transportit Rrugor për komunën e Skenderajt ka për qëllim uljen e shkallës së motorizimit, duke promovuar forma të tjera të lëvizjes, si zhvillimin e çiklizmit dhe krijimin e hapësirave për ecje në këmbë, përkatësisht krijimin e kushteve infrastrukturore me qëllim të akomodimit të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion.
Sfidat e planifikimit bashkëkohor në pjesën urbane ka të bëjë me sfidat ditore për përmbushjen e kërkesave për lëvizje, përkatësisht gjetjen e alternativave ambientale të qëndrueshme dhe krijimin e kushteve për lëvizje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.
Ndërgjegjësimi i rritur i qytetarëve lidhur me përdorimin e mënyrave aktive, të pastra dhe efikase të transportit, si ecja, çiklizmi dhe transporti publik, siguron një mënyrë më të efektshme për përmbushjen e kërkesave për lëvizje ditore.

Hartimi i Planit Lokal të Transportit Rrugor mundëson krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të transportit dhe lëvizjeve të tjera (lëvizjeve të motorizuara dhe të pa motorizuara) me qëllim që të krijojnë:

- sigurimin e qasjes sa më të lehtë për lëvizjet ditore dhe shërbime të tjera
- përmirësimin e shkallës së sigurisë ne transportin rrugor,
- zvogëlimin e ndotjes së ambientit nga automjetet e transportit rrugor,
- rritjen e efikasitetit dhe ekonomicitetit gjatë transportit të njerëzve dhe të mallrave
- rritjen e atraktivitetëve mjedisore ne zonat urban dhe rurale.

Më këtë plan përcaktohen qartë objektivat dhe synimet për zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës së transportit në tërësi, për ndërtimin e rrugëve funksionale, që lidhen me fshatrat e komunës dhe qytetet e tjera, me çka do të krijohen kushte për transport të sigurt dhe respektimin e kritereve të nevojshme për ruajtjen e mjedisit jetësor.
Me këtë plan, përveç çështjeve thelbësore që kanë të bëjnë me infrastrukturën e transportit, me ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e saj, janë paraparë aktivitete përkatëse për komunën e Skenderajt.

## 2. KORNIZA LIGJORE

Plani Lokal i Transportit Rrugor për komunën e Skenderajt është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Skenderaj, për lëvizje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, për përmirësimin e cilësisë së jetesës, krijimin e ambientit të pastër dhe të shëndoshë mjedisor dhe social. Plani Lokal i Transportit Rrugor për komunën e Skenderajt bazohet në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë si:

- Ligji Nr. 02/L-70 për Sigurinë në komunikacionin rrugor
- Ligji Nr. 2004/1 dhe Ligji nr. 04/L-179, 16 maj 2013, për Transportin rrugor
- Ligji Nr. 2003/11 mbi rrugët
- Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale
- Ligji Nr. 04/L-076 për policinë
- Ligji Nr. 2012/04-L-174për planifikimin hapësinor
- Ligji Nr. 03/l-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Ligji Nr. 03/l-025 për mbrojtjen e mjedisi.
- Rregullore komunale për transport rrugor nr. 1-110-32837
- Rregullore komunale për autotaksi numër 1-110-32825
- Udhëzimi Administrativ për sinjalizim rrugor nr. 09/2017

## 3. SYNIMET DHE VISIONI

### 3.1 Synimet

• Ndërtimi i shtigjeve për çiklistë dhe këmbësorë përgjatë rrugëve urbane dhe rurale,

• Ndërtim i shiritave për gjatë rrugëve urbane dhe rurale ne zonat turistike etj.

• Zgjerimi i infrastrukturës rrugore ne zonat me interes lokale dhe kombëtar për rritjen e turizmit,

• Ndërtimi dhe zgjerimi i qendrës së qytetit më infrastrukture moderne,

• Sigurimi i ambientit të qëndrueshëm të lëvizjes se lire duke dekurajuar përdorimin e automjeteve private dhe duke inkurajuar transportin publike, ecjen dhe çiklizmin.

• Përkrahja e transportit me autobusë apo me minibusë me qëllim të përparimit dhe forcimit të tij si formë kryesore e lëvizjes.

• Largimi i ndotjes akustike (zhurmave) nga zonat e banimit, posaçërisht nga zona e ndjeshme urbane me qëllim të rritjes së cilësisë të jetesës por edhe zvogëlimit të ndikimit të gazrave të rrezikshme në mjedis.

• Përkrahja e përdorimit të biçikletave si mjet transporti, sigurimi i hapësirës së nevojshme dhe dhënia e përparësisë në trafik.

**3.2 Vizioni**-Komuna e Skenderajt qytet ekologjik me vlera të trashëgimisë kulturore artiste dhe turistike, i cili siguron qasje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik më ambient të pastër dhe kushte të mira për jetë të shëndetshme.
Në kuadër të plotësimit të vizionit për komunën e Skenderajt, janë përcaktuar pesë objektiva strategjike kryesore. Secila prej objektivave strategjike shtjellohet me anë të aktiviteteve përkatëse të cilat do të trajtohen gjatë hartimit dhe finalizimit të Planit Lokal i Transportit Rrugor 2024-2028.

## 4. OBJEKTIVAT

• Ndërlidhja me komunat e tjera dhe rrugët e komunës së Skenderajt, përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajta e infrastrukturës së transportit rrugor.
• Përmirësimi i kualitetit të shërbimeve, krijimi i ambientit të favorshëm dhe të sigurt rregullativë për ngritjen e cilësisë së shërbimeve në fushën e transportit dhe komunikacionit.
• Përmirësimi i sigurisë në komunikacion dhe mbrojtja e mjedisit.

### 4.1 Objektivi -I - Rritja e sigurisë në trafik

Përcaktimi i masave teknike për rritjen e sigurisë në trafik dhe të çështjeve me interes do të ndihmojë institucionet në nivelin komunal në përcaktimin e prioriteteve, veçanërisht në afërsi të zonave urbane dhe rurale afër shkollave.
Pas evidentimit të vendeve në afërsi të shkollave, të cilat konsiderohen si vende me rrezikshmëri të lartë, do të përdoren metodat dhe masat e përshtatshme për lesimin e qarkullimit të trafikut.
Për zhvillimin e qendrës së qytetit të Skenderajt janë planifikuar katër projekte, që përfshin:

- Ndërtimin e stacionit të autobusëve
- Ndërtimin e parkingjeve ne qytet dhe zonat për rreth,
- Ndërtimin e tregut të gjelbër të qytetit etj.
- Ndërtimi i rrugës se re qe lidhe rrugët ekzistuese (Rr. Sala dhe Hamit Jashari me Rr.17 Shkurti).

Ndërtimi i rrugës “Miftar Bajraktari” qe lidhet me rrugën regjionale “Arben Haliti”

### 4.2 Objektivi -II- Zhvillimin e sistemit për rregullimin dhe menaxhimin e trafikut

Cilësia e infrastrukturës në sektorin e transportit dhe rrugëve urbane është gjithashtu një nga objektivat e rëndësishëm për realizimin e projektit të qendrës dhe rregullimit të pjesës rurale.
Një plan i tillë duhet të realizohet për të siguruar në mënyrë të veçantë:
- Përmirësimin e kushteve të qarkullimit për të gjithë pjesëmarrësit në trafik (zvogëlimin e aksidenteve rrugore, vendosja e tabelave informuese, vendosja e ndriçimit të mjaftueshëm në hapësirat publike) etj.
- Zvogëlimin e ndotjes dhe respektimin e vlerave mjedisore
- Zvogëlimin e shpenzimeve publike dhe private
- Përshtatjen e infrastrukturës për personat me nevoja të veçanta (ndërtimi i hyrjeve dhe daljeve me laura dhe vendosja e sinjalistikës për personat me nevoja veçanta).

Në rregullimin e udhëkryqeve të trafikut në pjesën rurale.
Rrjeti rrugor në komunën e Skenderajt i plotëson kushtet për lëvizje të lirë dhe një jetë më cilësore për persona me nevoja të veçanta dhe familjet e tyre.

### 4.3 Objektivi -III- Krijimi i hapësirave për lëvizjen e lirë për mjetet të pa motorizuara dhe ekologjike ne zonat urbane dhe rurale,

Ecja në këmbë është forma më e vjetër dhe më universale e udhëtimit. Që njerëzit të ecin në mënyrë të sigurt, të përshtatshme, efikase dhe të qetë, u nevojitet një mjedis dhe infrastrukturë e projektuar mirë, e cila i përmbushë nevojat e tyre për lëvizje të lirë. Një vend i privilegjuar që zotëron qyteti i Skenderajt janë dhe parqet e qytetit në anët e saj, përkatësisht zona më atraktive e qytetit. Një pjesë e këtyre papaqëve dhe zonave të gjelbëria , kryesisht gjatë verës shndërrohet në shëtitore dhe zona të qeta që shërbejnë si vend për ecje të qytetarëve.

### 4.4 Objektivi -IV- Krijimi i shtigjeve për çiklistë ne zonat turistike,

Një nga objektivat më të rëndësishëm në kuadër të këtij plani ka për qëllim rritjen e përdoruesve të biçikletave në qytetin e Skenderajt dhe ndërlidhjen funksionale të shtigjeve për çiklistë me zonat rurale. Me këtë objektiv synohet zvogëlimi i trafikut, rritja e cilësisë së ajrit, ulja e kërkesës për parkim dhe përmirësimi i shëndetit publik. Kjo do të arrihet duke krijuar shtigje të reja për çiklistë, duke përmirësuar sigurinë e çiklizmit dhe institucionalizimin e çiklizmit ne komune e Skenderajt.

### 4.5 Objektivi -V- Përshtatja e infrastrukturës rrugore për persona me nevoja të veçanta

Në kuadër të këtij plani, vëmendja është përqendruar më tepër në përshtatjen e infrastrukturës rrugore për personat me nevoja veçanta , sidomos në kalimet në rrugë dhe në vendkalimet për këmbësorë (vendosja e sinjalistikës për personat me nevoja të veçanta).

## 5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT

Transporti i njerëzve dhe i mallrave në territorin e komunës se Skenderajt bëhet përmes transportit rrugor dhe ai hekurudhor. Komuna e Skenderajt posedon një rrjet të rrugëve që ofrojnë lidhje të mira me komunat e tjera.

Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale që administrohen nga niveli qendror, është: 69.5 km në total brenda komunës është në gjatësi prej 405 km. Rrugët lokale janë në gjatësi prej 335.5 km dhe janë përgjegjësi e komunës. Kompanitë private të licencuara nga Ministria e Infrastrukturës Rrugore u ofrojnë shërbime qytetareve për linjat urbane dhe linjat nder urbane, ndërsa nuk ofron shërbim për menaxhimin e linjave të autobusëve,

Planifikimi i transportit për komunën e Skenderajt i paraprin organizimi urbano-periferik sipas planti zhvillimor lokal, duke analizuar zhvillimet e formës urbano-periferik, ndër-urbane, shfrytëzimin e tokës, qasjen në pjesë të ndryshme të qytetit, fshatrat dhe pjesët malore.



Foto: *Projekti i stacionit të autobusëve ne Skenderaj.*




Burim HZK: *Harta 1-Rrjeti rrugorë në Komunën e Skenderaj.*




Burim HZK :*Harta 2- Infrastrukturës rrugore 2020*-2028.

## 6. TRANSPORTI PUBLIK NË KOMUNËN E SKENDERAJT

Pas viti 1999, në komunën e Skenderajt transporti publik ishte organizuar përmes kompanisë publike për transportin publik, me ato mjete që kishin mbetur nga N.T.P. "Kosovatransi" deri në privatizimin e kësaj kompanie, pastaj në mënyrë graduale filluan që të operojnë edhe transportuesit privat. Sot në komunën e Skenderajt operojnë 10 Operator Ekonomik të transportit privat, të cilat e mbulojnë territorin e Komunës së Skenderaj.

## 7. TRANSPORTI PUBLIK NDËR-URBAN

Transporti publik ndër-urban i udhëtarëve ka për shërbim vend ndalimet e autobusëve linjat e autobusëve që qarkullojnë dhe shërbejnë për qytetarët e Skenderajt, janë kryesisht ato të linjave transite Skenderajt-Mitrovicë, Skenderaj – Drenas – Prishtinë, Skenderaj – Klinë dhe Mitrovicë– Klinë e Epërme - Pejë, ku mbledhja e udhëtareve behet ne vend ndalime.

- Linjat jashtë territorit të komunës janë:
  a. Skenderaj- Drenas-Prishtinë,
  b. Skenderaj-Mitrovicë,
  c. Skenderaj-Klinë,

Transporti me autobus organizohet në disa forma dhe atë: transport ndërkombëtar, transport nder urban dhe transport urbano-periferik.
Këto kategori janë të ndara edhe sipas menaxhimit, ku transporti ndërkombëtar dhe nder urban menaxhohet nga Ministria e Infrastrukturës, kurse transporti urbano-periferik menaxhohet nga komuna. Në mungesë të autobusëve nëpër disa fshatra ku ka lëvizshmëri më të vogël, linjat janë të mbuluara me kombibus privat, të cilët pajisen me leje nga DSHP-ja.

## 8. TRANSPORTI PUBLIK- URBANO –PERFERIK

Transporti publik bëhet nga operatoret ekonomik privat të autobusëve të cilët janë të licensuar nga Ministria e transportit dhe planifikimit hapësinor.
Në terë territorin e komunës se Skenderajt vend ndalime për automjete e transportit publik janë gjithsej 71, ndërsa numri i automjeteve motorike të regjistruar si auto taksi janë 10, si dhe 2operator ekonomik radio taksi me nga 5 automjete.
Transporti publik do të vazhdojë të ofrojë shërbim nga operatoret privatë, sidomos në drejtim të zonës urbane dhe zonave rurale, si dhe qendrave të tjera.
Rrjetit te shtigjeve për këmbësore, biçikleta dhe hapësira publike duhet t'i kushtohet një planifikim i detajuar dhe ndërlidhës përmes hapësirave publike, parqeve e shtigjeve dhe gjithashtu t'i kushtohet rendësi lehtësimit te lëvizjes se personave me nevoja të veçanta.

Komuna e Skenderajt duhet të parasheh edhe këto kushte planifikuese:

- Infrastruktura rrugore duhet të planifikohet në shkallë të përshtatshme në harmoni me funksion të qendrave dhe kërkesave kombëtare e regjionale.
- Gjatë procesit të përcaktimit të zonave të ndërtimit, duhet të dëshmohet se është shmangur kostoja e lartë në masat zhvillimore dhe mirëmbajtje.
- Ndërtimi rrugëve duhet t'i respektojë rregullat vitale për një rasnport të qëndrueshëm dhe orientimi i mbrojtjes së mjedisit etj.
- Koncepti detaj i mobilitetit (përfshirë edhe transportin publik, këmbësor dhe trafikun për çiklist) Ky koncept duhet të përcillet me plan detaj për zhvillim turistik.
- Problemet teknike lidhur me sigurinë e rrugëve (gjerësia e rrugëve, kalimet e rrezikshme, pjerrtësia), dukshmëria duhet të përfshihen dhe të lehtësohen me masa të përshtatshme.

Në përgjithësi në komunën e Skenderajt parkimi nuk është shume problem qe paraqitet në pjesën urbane, konkretisht në qendër të qytetit ku dihet se ka një hapësirë të përcaktuar që i plotëson kushtet dhe kriteret për parkim publik komunale.
Hapësirat ekzistuese qe shërbejnë si parkime janë në prona private dhe ndërtesave të banimit kolektive dhe qendrave tregtare-bizneseve.
Me arritjen e zhvillimit efikas të infrastrukturës do të thotë jo vetëm mundësia e një qarkullimi të lirë dhe funksional, por edhe arritja e një ambienti të pastër pa ndotje me menaxhimin e duhur të mbeturinave dhe gjelbërimin e hapësirave publike.
Operatorët transportues privat respektojnë linjat e caktuara duke respektuar edhe orarin i cili paraprakisht është i publikuar.

- **Linjat brenda territorit të komunës janë:**
  - Skenderaj-Klladernic-Runikë,
  - Skenderaj-Runik-Pemishtë,
  - Skenderaj-Runik-Izbicë,
  - Skenderaj-Runik-Syriganë,
  - Skenderaj-Rezallë-Likoc-Ticë,
  - Skenderaj-Rezall-Abri e Poshtme,
  - Skenderaj-Makerrmal-Murgë,
  - Skenderaj-Rakinicë,
  - Skenderaj-Çirez,
  - Skenderaj-Prelloc-Kozhicë-Çirez,
  - Skenderaj-Vajnik-Izbicë,
  - Skenderaj-Kuçicë,
  - Skenderaj-Tërnac-Kuçiçë,
  - Skenderaj-Tushilë,
  - Skenderaj-Krasaliq-Kozhicë,
  - Skenderaj-Prekaz i Poshtëm-Mikushnicë-Prekaz i Epërme,
  - Skenderaj-Mikushnicë-Lubavec,
  - Skenderaj-Prekaz i Epërm-Mikushnicë,
  - Skenderaj-Kryshec,
  - Skenderaj-Açarevë,
  -

**Transporti i nxënësve në Insitucionet e Arsimit Parauniversitar**

Drejtoria Komunale e Arsimit bën transportin e organizuar për nxënësit me nevoja të veçanta në klasë të bashkangjitura, klasë të rregullta në shkolla të komunës se Skenderajt, si dhe për nxënësit me nevoja të veçanta që ndjekin mësimin në Qendren Burimore në Pejë.

Gjithashtu bazuar në Ligjin e Arsimit Parauniversitar nr. 04/L-032 neni 15 paragrafi 5.1, Drejtoria Komunal e Arsimit bën pagesa për transport për nxënësit të cilët janë brenda distance prej 4 kilometra, në të gjitha shkollat e komunës së Skenderajt.




Burim HZK: *Harta 3-Transporti publik në Komunën e Skenderajt 2020-2028*

## 9. VEND-PARKINGJET

Në komunën e Skenderajt janë 30 lokacione të parkingjeve, , këto lokacione me parkingje kanë hapësirë për prej 1,610 vend parkingje, prej tyre janë 52 vend parkingje me persona me nevoja të veçanta .



Foto: *Shenjëzimi i vend parkingjeve-Skenderaj*

Pas përfundimit të shenjëzimit të hapësirave për parking për banorët rezidentë të objekteve banesore në rrugën “Fehmi e Xhevë Lladrovci” në Skenderaj, ka nisur shenjëzimi tjetër i parkingjeve edhe për banorët e ndërtesës në rrugën “Ahmet Delia”, afër sheshit “Adem Jashari”.
Me këtë rast, kompania e kontraktuar nën mbikëqyrje të inspektorëve nga Drejtoria e Inspekcionit, ka përfunduar procesin e shenjëzimit, duke i hapë rrugë kështu procesit të aplikimit për parking, nga ana e banorëve rezidentë.

## 10. INFRASTRUKTURA RRUGORE

Pozita gjeografike e komunës së Skenderajt në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme rajonale dhe nacionale, si dhe rrjeti rrugor lokal mundësojnë qarkullim me të mirë dhe mjaft efikas me të gjitha vendbanimet e territorit.

Në komunën e Skenderajt ekziston niveli i disa kategorive te rrugëve , duke filluar prej rrugëve regjionale, lokale deri tek ato të pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Skenderajt përbehet nga:

- Rrugët regjionale – R-101, R-102, R – 105, R-304, këto rrugë lidhin Skenderajn me komuna tjera,
- R-101 është Rruga Skenderaj - Istog dhe Skenderaj-Mitrovicë,
- R-102 - Skenderaj - Drenas
- R – 105 – Skenderaj – Klinë- dhe Polac – Vushtrri
- R- 304 – Marinë – Cerevik – Kiev, të cilat lidhin komunën tone me komunat e përafërta.




Burim PZHK: *Harta 4- Konceptit të zhvillimit Hapësinor-PZHK 2017-2025*




Burim HZK; *Harta 5- Planet Rregulluese të Hollësishme të Propozuara-HZK-Skenderaj 2020-2028*

## 11. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

Gjendja ekzistuese e trafikut në komunën e Skenderajt është vlerësuar e mirë. Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese në trafik janë trajtuar problemet kryesore nga fusha e trafikut dhe transportit në komunën e Skenderajt . Nga analiza e bërë, si dhe bazuar edhe në vrojtimet e pjesshme të bëra në terren nga inxhinieret komunal, është evidentuar se disa pjesë të rrugëve kanë nevoje për mirëmbajtje dhe rehabilitim. Këto rrugë për momentin mirëmbahen me fonde të kufizuara, sidomos mirëmbajtja e sinjalizimit të rrugëve. Mund të pritet që, gjendja e tyre të përkeqësohet shumë shpejt dhe të ulet shkalla e sigurisë rrugore, nëse në vitet e ardhshme nuk vihen në dispozicion fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

## 12. SIGURIA NË TRAFIK

Me qëllim që të kemi një pasqyrë më të qartë të gjendjes ekzistuese të sigurisë në komunën e Skenderajt, nga Policia e Kosovës janë marrë të dhënat për numrin e aksidenteve, pasojat dhe faktorët të cilët kanë shkaktuar aksidente. Prandaj, burimi i statistikave të prezantuara në këtë kapitull është siguruar nga sistemi informativ i Policisë së Kosovës - Stacioni Policor në Skenderaj.
Gjithnjë duke u bazuar në të dhënat e Policisë së Kosovës, numri i përgjithshëm i aksidenteve në komunën e Skenderajt është në formë tabelore e paraqitur.

| Përshkrimi | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Aksidente me dëme materiale | 30 | 60 | 39 | 40 | 20 | 189 |
| Aksidente me lëndime | 89 | 93 | 92 | 93 | 24 | 391 |
| Aksidente fatale | 4 | 1 | 0 | 3 | 0 | 8 |
| Persona të lënduar | 208 | 239 | 223 | 192 | 48 | 910 |

*Burim: Te dhënat zyrtare nga stacioni Policor ne Skenderaj.*




*Grafikoni: Paraqitje e përgjithshme e aksidenteve ne komunën e Skenderajt.*

## 13. SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL

Gjendja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në komunën e Skenderajt është në nivel të kënaqshëm. Vijat gjatësore të rrugëve dhe shigjetat e drejtimit janë të dukshme. Në pjesën rurale mungon sinjalizimi horizontal, rrjeti rrugor në komunën e Skenderajt është i pajisur me sinjalizimin përkatës vertikale.
Në rrjetin rrugor te fshatrave ka mungese te shenjave per emërtimin e vendbanimeve, me këtë rast shkaktohet konfuzitët në orientim, sidomos për drejtuesit e mjeteve të cilët nuk kanë njohuri paraprake me kushtet e rrugës dhe të terrenit.

## 14. TRAFIKU PËR KËMBËSORË

Në qytetin e Skenderajt, sipërfaqet për lëvizje të këmbësorëve janë relativisht të kënaqshme. trotuaret shtrihen përgjatë rrugës kryesore në të dy anët e rrugës dhe janë të ndara fizikisht nga pjesa e rrugës në të cilën lëvizin automjetet dhe mundësojnë lëvizje të lirë dhe të sigurt.
Zona më e frekuentuar e qendrës së qytetit është me gjerësi të mjaftueshme dhe në sipërfaqet e dedikuara për këmbësorë mundësohen lëvizje për këmbësorë por mungojnë shtigje të përshtatshme të shënuara për çiklistë. Me ndërtimin e qendrës së qytetit t'i jepet prioritet shtigjeve për çiklistë.
Nga ana tjetër, në disa pjesë periferike dhe pjesën rurale të qytetit të Skenderajt mungojnë trotuaret po ashtu në disa pjesë të rrugëve, konsiderohet si të rrezikshme.

## 15. TRAFIKU PËR ÇIKLISTË

Qytetarët e Skenderajt janë të favorizuar nga terreni i rrafshët i qytetit dhe shtrirja e madhe e këtij terreni në drejtim të fshatrave përreth. Por, përkundër këtij terreni mjaft të përshtatshëm për zhvillimin e çiklizmit, një formë e tillë e lëvizjes nuk është promovuar sa duhet.
Me qëllim të analizës dhe vlerësimit të elementeve gjeometrike të rrugës, ku planifikuesit në terren duhet për të vlerësuar si të domosdoshme dhe prioritet që profilet të jenë të mjaftueshëm të rrugëve dhe ndërlidhjen funksionale të qytetit të Skenderajt me fshatrat me anë të shtigjeve për biçikletë, lidhjen e vendeve me trashëgimi kulturor si Kompleksi Memorial Adem Jashari ne Prekaz.
Kjo nismë përfshinë katër shtigje, të cilat janë emëruar si në vijim:
Shtegu i çiklistëve ne Rr. "Fadil Rrustemi"

1. Shtegu i çiklistëve nr Rr."17 Shkurti "
2. Shtegu i çiklistëve Rr. Sala e Hamit Jashari"
3. Shtegu i ciklisteve "Merita Murtezi".
4. Shtegu i ciklisteve Rr.Heroinat e Jashareve"
5. Shtegu i ciklisteve- Shtabi i UÇK-së –Likoc

Nga kjo nismë përfitojnë të gjithë qytetarët dhe turistët, ku tani e tutje kanë mundësi që këtë sport ta ushtrojnë edhe në qytetin e Skenderajt !
Skenderaj po përmbushet çdo ditë dhe po merr formatin e një destinacioni favorit turistik dhe vendor!

Drejtoria për Zhvillimin Ekonomik, shtigjet për ecje i ka paraqitur më ortofoto ne bashkëpunim më kompaninë "ARMIRING SH.P.K, aty ku orientohen pothuajse i tërë komuniteti! Tani edhe më tej po punohet në pjesën teknike që këto shtigje të jenë së shpejti të qasshme për dashamirët e sportit !




Burim HZK: *Harta 6- Shtigjet e ecjes ne fshatin Tushilë ne Skenderaj.*

## 16. NGARKESA E TRAFIKUT

Për nevoja praktike janë të rëndësisë së veçantë karakteristikat e mospërputhshmërisë kohore të qarkullimit të automjeteve në periudha të ndryshme kohore. Periudha dhe zgjatja e numërimit varet nga qëllimet dhe mënyra e planifikimit.
Rezultatet më të mira do të fitohen kur numërimi të bëhet përmes numëruesve automatik, në periudha më të gjata kohore (12 ose 24 orë në tërësi). Në mungesë të kohës dhe kufizimeve të tjera, për nevoja të ngarkesës së trafikut në komunën e Skenderajt është bërë numërimi manual. Janë përpiluar formularët e numërimit në të cilët është bërë ndarja e intervaleve kohore 15 minutëshe dhe ndarja e mjeteve varësisht nga struktura. Është zgjedhur një ditë karakteristike brenda javës (një ditë më e ngarkuar) dhe matjet janë realizuar në periudha të ndryshme kohore brenda ditës: nga ora 7.00-8.00 dhe nga ora 12.00-13.00.
Me qëllim të mbledhjes së të dhënave për fluksin e automjeteve në qytetin e Skenderajt, janë zgjedhur pikat karakteristike në të cilat është bërë matja e numrit të automjeteve në rrugë dhe në hyrje të udhëkryqeve.
Përpos automjeteve motorike, me qëllim të caktimit të strukturës së qarkullimit, janë bërë edhe matjet e numrit të këmbësorëve dhe biçikletave të cilat qarkullojnë brenda orës.
Sa i përket strukturës së qarkullimit, automjetet e udhëtarëve dominojnë me rreth 65%, ndërsa automjetet e rënda dhe autobusët përbëjnë rreth 10%. nga lëvizjet e pa motorizuara, lëvizjet kryesisht realizohen duke ecur në këmbë (20% këmbësorë), ndërsa rreth 5% e lëvizjeve realizohen me biçikleta.

## 17. INFRASTRUKTURA RRUGORE PËR PERSONAT ME NEVOJA VEÇANTA

Një sfidë e vazhdueshme që e vështirëson kërkimin në këtë fushë është mungesa e të dhënave të sakta për personat me nevoja veçanta. Megjithëse Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka nxjerrë një udhëzim administrativ me anë të cilit obligohet rregullimi i kushteve teknike dhe mënyra e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me nevoja veçanta. Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit kane ndërmarr hapa konkretë me partneritet me organizatat përkatëse për persona me nevoja veçanta duke marr masat adekuate në përshtatje me kriteret teknike në mënyrë që të gjitha vendkalimet në rrugë dhe vendkalimet për këmbësorë, t'u mundësojnë qasje edhe personave me nevoja të veçanta.
Në projektet e ardhshme duhet të kenë në konsiderate këto prioritete:

- Qasja e lirë dhe e sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, në punë, në shkollë, objektet e rëndësisë së veçantë, shërbimet e nevojshme ditore, etj.
- Siguria në trafik: qytetarët me nevoja të veçanta duhet të ndihen plotësisht të sigurt gjatë lëvizjes në hapësirat publike, rrugë, sheshe, parqe, vende rekreative etj.
- Ruajtja e ambientit: zhvillimi dhe promovimi i lëvizjeve të pa motorizuara do të ndikojë në uljen e shkallës së motorizimit dhe mbrojtjen e ambientit.

## 18. SIGURIA NË TRAFIK NË AFËRSI TË SHKOLLAVE

Siguria në trafik në përgjithësi dhe siguria e nxënësve në afërsi të shkollave në veçanti ka ngjallur shqetësim publik dhe është vlerësuar njëra prej brengave kryesore në komunën e Skenderajt.

Me qëllim të rritjes së sigurisë në afërsi të shkollave, në kuadër të këtij plani janë paraparë metodat fizike për kontrollin e trafikut, përkatësisht pengesat fizike të cilat ndikojnë në qetësimin e trafikut. Me nocionin metoda fizike për kontrollin e trafikut nënkuptojmë të gjitha ato procedura të cilat në thelb janë veprime të trafikut dhe të cilat ndikojnë në sjelljen e drejtuesve të automjeteve. Ato përfshijnë edhe qetësimin e trafikut në udhëkryqe dhe në akse rrugore, si dhe përparësitë për këmbësorë dhe për çiklistë. Masat më të shpeshta për zvogëlimin e shpejtësisë dhe rritjen e sigurisë në trafik janë masat për qetësimin e trafikut.

Në parim, qetësimi i trafikut është kombinim i një numri më të madh masash që kanë për qëllim zvogëlimin e efekteve negative nga përdorimi i automjeteve motorike dhe çojnë deri te ndryshimi i sjelljes së ngasësve dhe zvogëlimi i shpejtësisë maksimale të lëvizjes në trafik, duke përfshirë këto masa për qetësimin e trafikut:

- zvogëlimi i shpejtësisë në afërsi të shkollave dhe në zonat tjera të rëndësishme;
- krijimi i kushteve në rrugë për paralajmërimin dhe detyrimin e ngasësve që të ngasin në mënyre të qetë dhe me kujdes;
- përmirësimin dhe mbjellja e gjelbërimit në dy anët e rrugëve, përmirësimi i mjedisit;
- zvogëlimin e numrit aksidenteve të trafikut.






**Skenari i parë** – është skenar i cili e ruan gjendjen ekzistuese të ndërtuar, mirëpo duke i bërë ndryshimet në hapësirat publike, rritjen e funksionalitetit të hapësirës, rritjen e gjallërisë me aktivitetet e ndryshme, lehtësimin e qasjes për këmbësorët, çiklistet dhe personat me aftësi të kufizuara, largimin e mjeteve të motorizuara dhe përmirësimin e peizazhit arkitektonik të ndërtesave ekzistuese. Po ashtu, rëndësi duhet ti jepet trashëgimisë kulturore dhe rregullimin e monumenteve të cilat e rrethojnë ketë lokacion, përcjellë me aktivitetet dhe manifestimet e ndryshme që organizohen në Skenderaj.

**Skenari i dytë** – skenari i dytë është skenari i cili bazohet në transformimin e tërësishëm të lokacionit. Po ashtu lejohet zhvendosja e tyre në ato prona ku komuna i ka posedim .
Gjithashtu, ky propozim merr parasysh edhe ndërhyrjet ne infrastrukturën e trafikut dhe atë teknike.
Pra, lejohet zhvendosja e rrugës me qëllim të rritjes së hapësirës publike me qëllim të promovimit të lëvizjes aktive dhe uljes së lëvizjes pasive.
Në ketë drejtim duhet të merren parasysh edhe fuqizimi i aktiviteteve dhe manifestimeve të ndryshme në hapësirën e re të krijuar duke e promovuar trashëgiminë kulturore dhe monumentet qe ndodhen aty.



Foto: *Sheshi Adem Jashari ne Skenderaj.*

Trashëgimia e Komunës se Skenderajt duhet të jetë e promovuar në Skenderaj më elementet tradicionale duhet të janë prezent në zgjidhjen e propozuar me synim qe të promovohet sa ma shumë ky sektor me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në të ardhmen.

Promovimi i aktiviteteve kulturore, shoqërore dhe tradicionale duhet të janë pjesë përbërëse e zgjidhjes së propozuar. Konkurrenti duhet të ofrojë ide të reja se si mundët ndryshimi i ri i pjesës qendrorë të qytetit të ketë ndikim në rritjen e aktiviteteve të lartë përmendura.



Foto: *Muzeu i qytetit ne Skenderaj.*

## 19. KRIJIMI I SHTIGJEVE PËR ÇIKLISTË

Plani për rritjen e përdoruesve të biçikletave në qytet synon zvogëlimin e trafikut, rritjen e cilësisë së ajrit dhe përmirësimin e shëndetit publik. Kjo do të arrihet duke krijuar shtigje të reja për çiklistë, duke përmirësuar sigurinë e çiklizmit dhe institucionalizimin e çiklizmit.

Një pjesë simbolike e qytetarëve të Skenderajt lëvizin rregullisht me mjete ekologjike transporti si, ecja në këmbë dhe ngasja e biçikletave.

✓ Prandaj, me qëllim të promovimit dhe avancimit të kësaj forme të lëvizjes, rekomandohet:

• ndërhyrje përmirësuese në rrjetin rrugor duke marrë në konsideratë krijimin e shtigjeve për çiklistë dhe duke siguruar jo vetëm zgjerimin e tyre, por edhe vazhdimësinë e tyre.
• krijimi i vend parkimeve të biçikletave më pranë akseve kryesore të shtigjeve për çiklistë, si dhe pranë objekteve të rëndësisë së veçantë, duke siguruar përdorimin e disa llojeve të transportit.
• Lidhjen e objekteve të trashëgimisë kulturore me shtigje të çiklistëve
• krijimi i programeve për edukimin e fëmijëve dhe të rinjve për përdorimin e biçikletave, si një mënyrë e shëndetshme dhe argëtuese udhëtimi.

## 20. MIRËMBAJTJA RRUGËVE

Është e rëndësisë së veçantë që komuna të bëjë edhe planifikimin e duhur buxhetor në lidhje me mirëmbajtjen projekteve të propozuara, por edhe të investimeve të mëhershme që janë bërë në fushën e transportit rrugor. Në mënyrë që të arrihet kjo, komuna duhet që patjetër ta bëjë inventarizimin e aseteve në fushën e infrastrukturës rrugore si dhe të ketë një data baze të saktë të digjitalizuar duke krijuar edhe këto kushte:

- Krijimi i një sistemi për këmbësorët, një sistemi të sigurt të përshtatshëm dhe të integruar me të gjitha aspektet e tjera të sistemit të transportit.
- Krijimi i lehtësirave për lëvizje të këmbësorëve duke u dhënë këmbësorëve të njëjtën rëndësi me llojet e tjera të transportit gjatë shpërndarjes së hapësirës së përbashkët publike.
- Përmirësimi i infrastrukturës së këmbësorëve që përfshinë, ndërhyrjen nëpër udhëkryqe për t'i bërë më të sigurta për kalimtarët,
- Përmirësimi i trotuareve dhe pajisja e tyre me ndriçim,
- Përmirësimi dhe plotësimi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal në vendkalimet për këmbësorë, përpilimi i një udhërrëfyesi dhe hartave për ecje në këmbë.
- Sigurimi i hartave për vendet me interes për t'u vizituar në tërë komunën e Skenderajt,
- Organizimi i ditëve të veçanta, këtu përfshihet organizimi i "Ditës pa automjete të motorizuara"

## 21. PLANI I MONITORIMIT

Plani i monitorimit është një dokument me të cilin monitorohet realizimi i masave të propozuara në kuadër të planit. Për përcjelljen e realizimit të planit është përgjegjës përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike.

Ky plan për komunën e Skenderajt është një dokument strategjik dhe realizimi i tij varet nga përshtatja dhe dinamika e realizimit të planeve tjera në nivel komunal në përputhshmëri me draftin e PZHK-ës dhe hartat zonale si dhe duke pasur parasysh faktin se monitorimi dhe realizimi e këtij plani është e nevojshme mbështetja jo vetëm nga drejtoritë përkatës por edhe nga drejtorit e tjera në nivel komunal, por edhe nga niveli qendror.

-Me miratimin e këtij plani, Drejtoria për Shërbime Publike, së paku një herë brenda vitit i raporton Kuvendit Komunal lidhur me realizimin e masave të parapara për periudhën e caktuar.

## 22. PLANI I VEPRIMIT, PRIORITETE DHE AKTIVITETET PËR VINITN 2024-2028

Plani i veprimit do të specifikohet çdo vit me planin e punës- planifikimet e projekteve konkrete.

Kjo tabele e vlerësimit dhe monitorimit mundet të përdoret në revidimin e planit të ri ku paraqitet shqyrtimi i zbatimit të planit.

**Tabela 1.**

| **Korniza e veprimit dhe monitorimit të aktiviteteve** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi- I-** | **Përshkrimi i Aktiviteti** | **Përgjegjësi** | **Afati** | **Buxheti** |
| **Rritja e sigurisë në trafik** | Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | DI | 2024-2026 | 150,000 |
| | Ndërtimi shtigjeve për çiklistë dhe parkingjet për biçikleta | DUMA | 2025-2026 | 50,000 |
| | Sipërfaqe të lira për lëvizje të pa motorizuara dhe rekreacion | DZHENIT | 2025-2027 | 60,000 |
| | Ndërtimi i parkingjeve dhe mirëmbajta | DUMA | 2026-2028 | 40,000 |
| | Infrastruktura rrugore për personat me nevoja te veçanta | DSHP | 2025-2028 | 70,000 |

Tabela 2.

| Korniza e veprimit dhe monitorimit të aktiviteteve | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi-II-** | **Përshkrimi i Aktiviteti** | **Përgjegjësi** | **Afati** | **Buxheti** |
| **Zhvillimin e sistemit për rregullimin dhe menaxhimin e trafikut** | Ndërtimi i trotuareve ne zonat rurale | DUMA | 205-2028 | 150,000 |
| | Mirëmbajta e rrugëve Dimërore | DSHP | 2024-2025 | 112,000 |
| | Vendosja, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sinjali-stikës rrugore | DSHP | 2024-2026 | 120,000 |
| | Mirëmbajta e rrugëve verore | DSHP | 2024-2025 | 81,000 |

Tabela 3.

| Korniza e veprimit dhe monitorimit të aktiviteteve | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi-III-** | **Përshkrimi i Aktiviteti** | **Përgjegjësi** | **Afati** | **Buxheti** |
| **- Krijimi i hapësirave për lëvizjen e lirë për mjetet të pa motorizuara dhe ekologjike ne zonat urbane dhe rurale,** | Ndërtimi i trotuareve ne zonat rurale | DZHENIT | 2026-2028 | 180,000 |
| | Mirëmbajta e rrugëve verore dhe dimërore | DSHP | 2025-2026 | 230,000 |
| | Vendosja, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sinjali-stikës rrugore | DHSP | 2026-2027 | 120,000 |
| | Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | DSHP | 2027-2028 | 90,000 |
| | Ndërtimi i shtigjeve për ecje | DZHENIT | 2026-2028 | 60,000 |

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. No. 02-110/01-0027862/24
Data Data 14 06 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opstina Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt i datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës së Skenderajt z.Fadil Nura i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e rregullt të datës _________ 2024, të miratojë këtë:

## PROPOZIM

**I.** Për miratimin e Draft-Rregullores Komunale për Kushtet dhe Mënyrat e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë në Komunën e Skenderajt.

**II.** Draft-Rregullorja e cekur në pikën **I** të këtij propozimi është punuar në mënyrë profesionale nga komisioni i emëruar me Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.02-020/01-0023210/24, të datës 17.05.2024, konform legjislacionit në fuqi në Republikës së Kosovës.

**III.** Drafti i cekur në pikën **I** ka kaluar procedurat e diskutimit publik, në bazë të udhëzimeve përkatëse për dhënien në diskutim publik të akteve komunale.

**IV.** Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**SHTOJCË:** Bashkëngjitur Draft-Rregullorja e cekur në pikën **I** të këtij propozimi.

**Propozimi i dërgohet:**
- Arkivit
- Kuvendit të Komunës

**Kryetari i Komunës**
Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr./No 09-060/01-0027125/24
Data/Data 10-06-2024


**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Shërbime Publike**
Direkcija za Javne Službe
Department for Public Services


| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **10.06.2024** |
| **PËR/ZA/TO:** | **Zyrën Ligjore** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Arkivit** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Drejtori i Shërbimeve Publike- Alban Shala** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Propozim** |

Pas përfundimit te draft-**Rregullores Komunale për Kushtet dhe Mënyrën e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë**, nga grupi punues për hartimin e kesaj rregullore dhe mbajtjes se diskutimit publik, kërkoj nga zyra ligjore qe te kontrolloj dhe nje here pjesen ligjore dhe te propozoj si pike te rendit te ditës ne mbledhjen e ardhshëm te Komitetit për Politike dhe Financa.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPSTINA
SKENDERAJ
Nr. 09-346/01-0027777/24
Data 14 06 2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Shërbime Publike**
Direkcija za Javne Službe
Department for Public Services

| | |
|---|---|
| DATA: | 10.06.2024 |
| PËR/ZA/TO | Zyrën e Kryetarit të Komunës se Skenderaj, z. Fadil Nura |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Drejtorit për Shërbime Publike, z. Alban Shala |
| NGA/OD/FROM; | Kryesuesi i Grupit Punues, z. Hajzer Shala |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | **RAPORT: -Rregullores Komunale nr. 01/2024 për Kushtet dhe Mënyrën e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë** |

Ne bazë të vendimit me nr.02-020/01-0023210/24 të datës 17.05.2024 nga zyra e kryetarit për formimin e Grupit Punues: për Kushtet dhe Mënyrën e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë:

1. Hajzer Shala-Kryesues ________
2. Brahim Smajli-Anëtar ________
3. Besnik Smakaj -Anëtar ________

Sipas gjendjes ne teren është parë nevoja qe te hartohet mënyra e bllokimit dhe zhvendosjes se Automatëve me Automarimangë në Komunën e Skenderaj.

Grupi punues ka organizuar edhe diskutimin publike sipas njoftimit publike të datës 05.06.2024 me nr. 02-020/01-0023210/24 ne bazë të njoftimit për diskutimin publike, që ka qenë nga data 26.05.2024 deri më datën 05.06.2024 ne sallën e Kuvendi Komunal ne Skenderaj.

Ne diskutimin publik kanë marre pjesë mbi 18 qytetare, ku është bërë prezantimi, ku nuk kemi marre as një vejte, me disa komente për Kushtet dhe Mënyrën e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë.

Ne ketë raport keni të bashkangjiture procesverbalin e pjesëmarrjeve gjate diskutimit publik.
Ne ketë raport është bashkangjiture edhe Draft Planin për **Kushtet dhe Mënyrën e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë.**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. No. 09-060/01-0027125/24
Data Data 10-06-2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

# RREGULLORE KOMUNALE
PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E BLLOKIMIT DHE ZHVENDOSJES SË AUTOMJETEVE ME AUTOMERIMANGË

**Skenderaj**

**Kuvendi i Komunës së Skenderajt:**
Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 pika c, të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjelokale; nenit 2 paragrafi 9, nenit 99 paragrafi 1, nenit 101 paragrafi 1 dhe nenit 102 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 02/L-70 - Për sigurinë në komunikacionin rrugor; dhe nenit 12 pika c, të Statutit të Komunës së Skenderaj: Nr. 01-110-385, të datës 03.12.2008, në mbledhjen e mbajtur më ____/____.2024, miraton këtë:

# RREGULLORE KOMUNALE Nr. ____/____/2024 PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E BLLOKIMIT DHE ZHVENDOSJES SË AUTOMJETEVE ME AUTOMERIMANGË

## I . Dispozitat e përgjithshme

### Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kompetencat dhe kushtet për mënyrën e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve të ndaluara dhe të parkuara në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor, në territorin e Komunës së Skenderajt.

### Neni 2

Mbikëqyrjen, në kuptim të nenit paraprak e bënë Policia e Kosovës, përmes njësitit të nivelit Komunal, atij Regjional dhe njësiteve tjera kompetente për mbarëvajtjen sa më të mirë të komunikacionit rrugor.

### Neni 3

Bllokimin, zhvendosjen e automjeteve të ndaluara ose të parkuara në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor e bënë subjekti afarist, personi juridik (në tekstin e mëtejmë Operatori), i përzgjedhur nga Komuna mbi bazën e procedurave të Ligjit mbi prokurim publik nr 2003/17.

### Neni 4

**Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë për bllokim dhe zhvendosje të automjetit.**

Për ushtrim të veprimtarisë për bllokimin, zhvendosje të automjeteve Operatori duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme dhe atë:

- Të ketë certifikatën e biznesit të regjistruar pranë Ministrisë për Tregti dhe Industri
- Licencën për këtë lloj veprimtarie të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit

- Lejen Komunale për zhvillim të biznesit të lëshuar nga Komuna e Skenderajt
- Dëshminë e pronësisë ose qiramarrjes së objektit administrativ (zyrës) dhe lokacionin për vend parkim dhe ruajtje të automjeteve të zhvendosura i cili do të ketë hapësirë të mjaftueshme për parkim të së paku 25 automjeteve. Vendparkimi duhet të jetë i rrethuar dhe me roje fizike 24 orë në ditë. Lokacioni i vendparkingut për ruajtje të automjeteve duhet të jetë në distancë më së largu 3 km nga qendra e Qytetit .
- Dëshminë e pronësisë së paku të dy (2) automerimangave për ngritjen dhe zhvendosjen e automjeteve të parkuara në kundërshtim me rregullat e Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor
- Të posedoj së paku tetë (8) bllokues të rrotave (ngjyrë të verdhë)
- Sigurimi i shërbimit 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, si dhe rojën fizike për ruajtjen e automjeteve të zhvendosura dhe të deponuara në vendparkimin e operatorit.
- Fuqinë e nevojshme punëtore,
    a. së paku dy (2) vozitës me kategori përkatëse,
    b. së paku dy (2) ndihmës vozitës,
    c. një punëtorë për punët e administratës për pranim – dorëzim të automjeteve të zhvendosura.
- Operatori duhet të ketë sistemin funksional të radiolidhjes, telefonin fikse dhe atë mobile.

**Neni 5**

**Automjetet për ushtrim të veprimtarisë në kuptim të kësaj rregulloreje duhet të plotësojnë këto kushte:**

- Të jenë të regjistruara,
- Të jenë në gjendje të rregull teknike,
- Të destinuara për ngritje dhe bartje të automjeteve,
- Sistemi i ngritjës së automjeteve të jetë funksional,
- Të ketë paisje të parapara për këtë lloj veprimtarie,
- Të ketë dritën vezulluese – rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur në vend të përshtatshëm në auto – merimangë.
- Të ketë shenjat identifikuese për ushtrim të veprimtarisë të përcaktuar sipas dispozitave ligjore.

**Neni 6**

## III. Kushtet dhe mënyra e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve

Zyrtarët e autorizuar sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje, Policia e Kosovës, pas konstatimit të ndalimit apo parkimit të automjetit përkatës në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin rrugor, japin urdhëresë në formë të shkruar për bllokim ose zhvendosje të automjetit përkatës.

## Neni 7

Urdhëresa për bllokim ose zhvendosje të automjetit përmban:

- Numrin e urdhëresës
- Datën
- Kohën (orën)
- Emërtimin e saktë të lokacionit (rruga, sheshi etj.)
- Lloji i automjetit dhe regjistrimi i targave
- Përshkrimi i kundërvajtjes
- Të dhënat e urdhërdhënësit

## Neni 8

Pjesëtarët e Policisë së Kosovës, pas konstatimit të kundërvajtjes, përmes radiolidhjes, telefonisë fikse ose telefonisë mobile, e njoftojnë Operatorin, i cili është i obliguar që në afatin sa më të shkurtë kohor të shkoj në vendin e ngjarjes dhe në prezencë të pjestarëve të Policisë së Kosovës të ndërmerr masa për bllokim apo zhvendosje të automjetit përkatës .

## Neni 9

Operatori, në vendin e ngjarjes, është i obliguar që të:

- Merr urdhëresën, nga pjesëtari i Policisë së Kosovës, në formë të shkruar për bllokim, zhvendosje të automjetit.
- Në mënyrë të qartë të fotografojë automjetin, para se të bëhet bllokimi ose zhvendosja e të njëjtit.
- Evidentojë të gjitha të dhënat sipas nenit 7 të kësaj Rregulloreje
- Të përpilojë procesverbalin me të gjitha të dhënat sipas këtij neni dhe i njëjti të nënshkruhet nga urdhërdhënësi - pjesëtari i Policisë së Kosovës dhe personi i cili e bënë bllokimin ose zhvendosjen e automjetit.

## Neni 10

Fletëpagesa për lirimin e automjetit të bllokuar, të zhvendosur, përveç shumës së paguar përmban edhe këto të dhëna :

- Llojin e automjetit dhe regjistrimin e targave,
- Emrin mbiemrin dhe numrin e letërnjoftimit të pronarit apo të shfrytëzuesit të automjetit,
- Datën e bllokimit, zhvendosjes së automjetit dhe
- Datën e lirimit të automjetit.

**Neni 18**

Automjeti i zhvendosur i cili nuk merret nga ana e pronarit në afatin kohor prej gjashtë (6) muajsh , për të cilin pronari i automjetit është informuar në mënyrë të rregullt, do ti bëhet vlerësimi nga një komision ekspertësh dhe do ti caktohet vlera. Komisioni i ekspertëve do të jetë i përbërë nga ekspertët e komunës, Policisë së Kosovës, Shërbimit Doganor të Kosovës dhe operatorit.

Në rastet kur shpenzimet e zhvendosjes dhe ruajtjes së automjetit e tejkalojnë shumën e vlerësuar të automjetit, mjeti do të shitet përmes ankandit publik. Shpenzimet e vlerësimit të ekspertëve, sipas paragrafit paraprak, llogariten në shpenzimet e zhvendosjes dhe ruajtjes së automjetit.

Nëse automjeti pas tri ankandeve publike nuk mund të shitet, i njëjti duhet të asgjësohet (shitet në hekurishte si hekur i vjetër) në bazë të një vendimi të cilin e nxjerr komisioni i posaçëm.

Komisioni tre anëtarësh formohet prej Komunës, Policisë së Kosovës dhe Shërbimit Doganor të Kosovës.

Mënyra e shitjes së automjeteve përmes ankandit publik, do të specifikohen me Rregullore të posaçme.

**Neni 19**

Për automjetet e braktisura, të cilat me urdhëresën e Policisë së Kosovës, zhvendosen në vendparkim të operatorit, shpenzimet i bartë pronari i fundit sipas të dhënave të Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve.

Në rastet kur automjeti i zhvendosur, nga pronari nuk merret në afatin kohor prej gjashtë (6) muajsh, iniciohet procedura sipas kushteve të parapara me këtë Rregullore.

**Neni 20**

Bazuar në Ligjin për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor tarifat për bllokim, zhvendosje të automjeteve do të jenë përgjegjësi e Policisë së Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Njëzet e pesë përqind (25 %) nga tarifat për bllokim, zhvendosje të automjeteve, do të derdhen në xhirollogari të Komunës komfor dispozitave të Ligjit mbi Financat Publike.

Të hyrat e inkasuara do të destinohen për krijim të kushteve për rregullim të komunikacionit rrugor.

## IV. Zbatimi i Rregullores

**Neni 21**

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e punëve në përmbushjen e obligimeve të operatorit komfor dispozitave të kësaj Rregulloreje .

Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik është përgjegjëse për mbikëqyrje dhe kontroll në aspektin financiar mbi bazat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike.

Drejtoritë e lartcekura, në funksion të mbarëvajtjes së punëve, mund të nxjerrin udhëzime përkatëse të cilat janë obligative për operatorin.

**Neni 22**

Përgjegjësitë dhe të drejtat e Komunës dhe Operatorit më afërsisht përcaktohen me kontratë të veçantë.

## Hyrja ne fuqi

**Neni 23**

Rregullorja hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr. No. 02-110/01-0027863/24
Data. Data. 14.06.2024

Komuna Skenderaj
Opstina Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt i datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës së Skenderajt z.Fadil Nura i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e rregullt të datës _________ 2024, të miratojë këtë:

## PROPOZIM

I. Për miratimin e Draft-Planit e Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara 2024-2027 në Komunën e Skenderajt.

II. Draft-Plani i cekur në pikën **I** të këtij propozimi është punuar në mënyrë profesionale nga komisioni i emëruar me Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.02-020/01-0023210/24, të datës 17.05.2024, konform legjislacionit në fuqi në Republikës së Kosovës.

III. Drafti i cekur në pikën **I** ka kaluar procedurat e diskutimit publik, në bazë të udhëzimeve përkatëse për dhënien në diskutim publik të akteve komunale.

IV. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**SHTOJCË:** Bashkëngjitur Draft-Plani i cekur në pikën **I** të këtij propozimi.

**Propozimi i dërgohet:**
- Arkivit
- Kuvendit të Komunës

**Kryetari i Komunës**

Fadil Nura

Republika e Kosovës
Skenderaj Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPSTINE
SKENDERAJ
Nr.
No. 02-060/01-0020388/24
Data.
Data. 25.04.2024

Kuvendi i Komunës
Opstina Skenderaj
Municipality of Assembly

Bazuar në ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Skenderajt, Udhëzimit Administrativ nr. 04/2023 për Administratë të hapur në Komuna (MAPL), Komuna e Skenderajt lëshon këtë:

Njoftim publik

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Draft-Planin e Veprimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Skenderajt

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 25.04.2024 deri me datën 10.05.2024 ndërsa diskutimi publik me qytetarë do të mbahet me datë 07.05.2024, në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar nga ora 14:00.
Komentet dhe sugjerimet mund t`i dërgoni deri me datën 10.05.2024 në ora 16:00, në emailat e zyrtarëve: baki.beqiri@rks-gov.net dhe jeton.rushiti@rks-gov.net .

Për më shumë detaje për Draft-Planin e Veprimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Skenderajt mund t`i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Faqen zyrtare të komunës në internet në rubrikën e konsultimeve publike:
https://kk.rks-gov.net/skenderaj/wp-content/uploads/sites/27/2024/04/Drafti-final-i-PLV-Skenderaj_V2024_2024.docx

Platformën qendrore për Konsultime Publike:
https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/08-45-31-25042024/Drafti-final-i-PLV-Skenderaj_V2024_2024.docx

Amir Lushtaku

Udhëheqës për Komunikim me Publikun

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPSTINE
SKENDERAJ
Nr.
No. 02-020/01-0018002/24
Data.
Data. 11.04.2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, dhe pas shqyrtimit të kërkesës së DZHENIT Nr.12-111/01-0017666/24 të datës 08.04.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**(Mbi formimin e grupit punues)**

1. **Formohet** grupi punues për hartimin e: **"Draft - Planit Lokal të Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara"**, në këtë përbërje:

   **1.1 Gentiana Zeqiri**, nga Shoqëria Civile, **kryesuese;**
   **1.2 Besarta Meha Ademi**, Drejtoreshë e DZHENIT, **anëtare**
   **1.3 Alban Berisha**, Drejtor i DKRS-së, **anëtar**
   **1.4 Baki Beqiri**, Zyrtar nga DZHENIT, **anëtar**
   **1.5 Edona Gashi**, Zyrtare nga DZHENIT, **anëtare**
   **1.6 Dritan Syla**, Zyrtar nga DBPZHR- ja, **anëtar**

2. **Detyrë** e grupit punues është që konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, të hartojnë "Draft-Planin Lokal të Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara", për Komunën e Skenderajt, duke bashkëpunuar dhe bashkërenduar aktivitetet me Shoqatën "Handikos" e cila nga projekti i fituar nga programi Rajonal për Demokraci Lokale Reload 2, në bashkëpunim me Drejtorinë e ZHENIT, kanë filluar procedurat për hartimin e dokumentit në fjalë.

3. Ky vendim hyn në fuqi diten e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi i'u dërgohet:**
- Arkivit
- DZHENIT
- Anëtarëve të grupit punues

**Kryetari i Komunës**
Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E SKENDERAJ • KRYETARI I KOMUNËS

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm**

| | |
|---|---|
| **Data/Date:** | 13.06.2024. |
| **Nga/Od/From** | Grupi punues për hartimin e Draft-Planit për Punësimin e Përsonave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027 |
| **Për/Za/To:** | Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, Adelina Spahiu |
| **Tema/Subjekat/Subject** | Raporti për ecurinë e hartimin e Draft-Planit për Punësimin e Përsonave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027- komentet dhe trajtimi i tyre nga grupi punues |

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me 11.04.2024, kryetari i komunës, Fadil Nura ka formuar grupin punues për hartimin e Planit për Punësimin e Përsonave me Aftësi të Kufizuara 2024-2027. Duke u bazuar në kërkesen për hartimin e ketij plani që rrjedh nga projekti i mbeshtetur nga porgrami RELOAD 2 dhe Komuna e Skenderajt.

-Grupi punues është në këtë përbërje:
Gentiana Zeqiri, kryesuese; Besarta Meha Ademi, anëtare; Alban Berisha, anëtar; Baki Beqiri, anëtar; Edona Gashi, anëtare; Dritan Syla antarë

**Takimet**

Me 25.03.2024, është mbajtur takimi i parë i grupit punues i udhëhequr nga kryeuesja e grupit, Gentiana Zeqiri dhe në pjesëmarrje të të gjithë anëtarëve tjerë. U prezantua Draft-Plani dhe u dhanë rekomandimet.

Në këtë takim anëtarët kanë diskutuar për rëndësinë e planit që nga përmbajtja, bazën ligjore të nevojshme si dhe listën e indikatorëve të cilat duhët të realizohen me qëllim të informimit publik. Grupi punues u dakordua që ky draft-Plan të dalë në diskutim publik nga data 24.04.2024 deri me 10.05.2024 kurse diskutimi publik të mbahet me datë 07.05.2024 në sallën e Kuvendit Komunal nga ora 14:00.

KONSULTIMI PUBLIK

Konsultimi publik filloi në orën 14:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

Konsultimin e shpalli të hapur udhëheqësi i grupit punues Gentiana Zeqiri e cili në pika të shkurtëra prezantoi përmbajtjen e Draft Planit të veprimit për punesimin e personave me aftesi te kufizuara 2024-2027, i cili ka për qëllim t'i ofroj kesaj kategorie te ndjeshme të shoqërisë, qasje me të lehtë të trajnimi, aftësimi dhe punësimi. Si dhe u prezantua puna e grupit në punëtorin dy ditore dhe të arriturat që kanë pasur qëllim draf planin.
Gjithashtu u prezantua se ky dokument është i mbështetur nga programi Reload 2 në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt.
Publikimi në webfaqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike

Komentet – Janë dhënë gjithsej 3 komente dhe të triat janë pjesë e draft-Planit

| Tema | Zyra | Pjesëmarrës | Vendi<br>Data | Komentet | 1.Njoftimi<br>2.Lajmi |
|---|---|---|---|---|---|
| Plani për Punësimin e Personave me Aftësi te Kufizuara 2024-2027 | Zyra për Informim<br>Zyra e Kuvendit | F M T<br>14 5 19 | Salla e Kuvendit<br>07.05.2024 | 17 komente nga Demokracy Plus ne emali prej te cilave 4 janë marre për bazë | 1. https://kk.rks-gov.net/skenderaj/wp-content/uploads/sites/27/2024/04/Njoftin-publik.pdf<br>2. https://kk.rks-gov.net/skenderaj/news/njoftim-publik-lidhur-me-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-draft-planin-e-veprimit-per-punesimin-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-ne-komunen-e-skenderajt/ |

Ashtu siç është bërë edhe njoftimi publik për qytetarët, të njëjtit kanë pasur mundësi që komentet, vërejtjet apo sugjerimet e ndryshme t`i japin edhe në mënyrë elektronike tek emailat e zyrtarëve. Ne mënyre elektronike kemi pranuar komente nga Demokraci plus e cila ka jep 17 komente teknike prej te cilave 4 janë rregulluar.

Grupi punues takimin e fundit e ka mbajtur me datë 10.05.2024 në të cilin janë diskutuar komentet e mbledhura. Kryesuesja e komisionit Gentiana Zeqiri ka thënë që të gjitha komentet që kane qene te arsyetuara janë dhënë gjatë fazës së konsultimit publik janë përfshirë në plan dhe janë pjesë e tij. Meqë faza e konsultimit publik ka përfunduar, atëherë unë në emër të këtij komisioni një raport mbi procesin e konsultimit publik do të ja dërgoj kryetarit të komunës dhe me siguri që ky Plan do të dërgohet shpejt për miratim në Kuvendin e Komunës.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

Vendimi për caktimin e grupit punues për hartimin e planit

Njoftimin publik për konsultimin publik

Listat e nënshkrimeve të anëtarëve në takimet e mbajtura

Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Baki Beqiri

Anëtarë i Grupit punues

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E SKENDERAJT · REPUBLIC OF KOSOVO · MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

# Plani i Veprimit për Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar në Komunën e Skenderajt 2024-2027

# Përmbajtja:


1. Parathënie: ...3

2. Plani Lokal i Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (2024-2027) ...4

3. Falënderime: ...5

4. Metodologjia: ...6

5. Objektiva 1 ...7

5.1 Objektiva 2 ...9

6. Objektivi specifik 1: Krijimi i kushteve dhe mundësive të barabarta për Punësimin e PAK në komunën e Skenderajt: ...10

6.1 Objektivi specifik 2: Aftësimi dhe riaftësimi profesional për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar në Skenderaj: ...14

## 1. Parathënie:

Plani lokal i veprimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Skenderajt është një plan nder sektorial që synon krijimin e kushteve për punësim për personat me aftësi të kufizuara. Duke u bazuar edhe në dokumentet e nivelit nacional, ky plan ka për fokus zhvillimin e kapitalit njerëzor (ku përfshihet identifikimi, ngritja e kapaciteteve, krijimi i kushteve për punësim dhe vetëpunësim) si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe ngritje të cilësisë së jetës për këtë kategori të shoqërisë.

Në këtë proces janë përfshirë personat me aftësi të kufizuara, organizatat e shoqërisë civile të cilat veprojnë në Skenderaj, si dhe përfaqësuesit institucional siç janë kuvendaret e kuvendit komunal të komunës së Skenderajt dhe përfaqësues nga drejtoritë komunale për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Plani lokal i veprimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara 2024-2027 është hartuar nëpërmjet një procesi të gjerë konsultativ, është zhvilluar një punëtori dy ditore me përfshirjen e të gjithë akterëve relevant institucional dhe joqeveritar me qëllim vendosjen e objektivave strategjike dhe aktiviteteve që do të ndikojnë në rritjen e mundësive për personat me aftësi të kufizuara për vetëpunësim, punësim në kompani private dhe ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve për një punësim sa më të qëndrueshëm në Komunën e Skenderajt.

Në aspektin operacional ky plan ka për qëllim orientimin e punës së drejtorive relevante në Komunën e Skenderajt, organizatave që merren me aftësinë e kufizuar, OJQ-të në fushën e punësimit dhe kompanitë private.

Plani është punuar në atë mënyrë që kostoja të mos mbetet vetëm barrë e Komunës së Skënderajt, por të punohet aktivisht në shfrytëzimin e skemave të ndryshme të agjencive të punësimit në nivel nacional, skemat e ministrive të linjës dhe donacionet tjera vendore dhe ndërkombëtare.

## 2. Plani Lokal i Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (2024-2027)

Plani i Lokal i Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në Skenderaj, synon që të krijojë kushte për rritjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale dhe punësimin e tyre, duke përfshirë institucionet e qeverisë komunale, kompanitë private dhe organizatat jo-qeveritare në identifikimin dhe përmbushjen e nevojave të kësaj kategorie për të qenë sa më të përgatitur për tregun e punës në komunën e Skenderajt.

Plani Lokal i Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara është dokument strategjik afatmesëm i Komunës së Skenderajt i cili orienton punën e dikastereve të ndryshme komunale, kompanitë private, OJQ-të për një periudhë tre vjeçare dhe hartohet nga drejtoritë relevante në partneritet dhe duke u konsultuar rregullisht me organizatat që merren me aftësinë e kufizuar.

Ky plan përcakton mënyrat e qasjes së politikave komunale për krijimin e kushteve, ngritjen e kapaciteteve dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara në bazë të nevojave të tyre në komunën e Skenderajt.

Plani promovon bashkëpunimin ndërmjet organizatave që merren me aftësinë e kufizuar qeverisë lokale dhe në të njëjtën kohë ndërlidh politikat ndër-sektoriale në mes të drejtorive të Komunës së Skenderajt, që ndërlidhet me zhvillimi ekonomik dhe krijimin  kushteve më të mira për punë.

## 3. Falënderime:

DZHENIT Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

ZP Zyra e Punësimit

Handikos Skenderaj

Iniciativa Qytetare Skënderaj

Kompania "R&Rukolli"

# 4. Metodologjia:

Përgatitja e Planit Lokal të Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Skenderajt, është hartuar nga Handikos Skenderaj në bashkëpunim të ngushtë me Komunën e Skenderajt dhe në bashkëpunim me organizatat tjera të shoqërisë civile. Ky plan është realizuar me mbështetjen e UNDP dhe me fonde nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të projektit "Së bashku mund ta bëjmë ndryshimin". Metodologjia e cila ka ndihmuar për hartimin e Planit të Veprimit është përcaktuar përmes 6 etapave të ndryshme, ky plan është realizuar me përfshirjen e të gjithë aktereve në komunën e Skenderajt, të cilët kanë të bëjnë me realizimin e 2 objektivave të identifikuar. Për të arritur deri në rezultate e këtij plani lokal të veprimit janë aplikuar disa metoda, në të cilat është përfshirë rishikimi i ligjeve në fuqi, strategjia nacionale për personat me aftësi të kufizuara dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe takime me akterët e ndryshme siç janë të personat me aftësi të kufizuara, organizatat e shoqërisë civile, përfaqësuesit politik dhe në fund organizimi i një punëtorie 2 (dy) ditore ku është punuar në finalizimin e planit lokal të veprimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Skenderajt.

Fazat përmes të cilave ka kaluar hartimi i këtij plani:

1. Faza përgatitore;
2. Identifikimi i prioriteteve;
3. Bashkëpunimi me institucione dhe drejtori të Komunës së Skenderajt;
4. Konsultimi me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe personat me aftësi të kufizuara;
5. Organizimi i punëtorisë për finalizimin e draftit të planit;
6. Diskutimi në publik dhe;
7. Aprovimi nga Komuna e Skenderajt.

Këto etapa kanë ndihmuar në hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të kufizuara në Komunën e Skenderajt, ku përmes këtyre etapave janë realizuar takim me personat me aftësi të kufizuara dhe me institucionet lokal të cilat kanë kontribuar në përpilimin e këtij plani.

Pjesa më e rëndësishme gjatë hartimit të këtij plani ka qenë punëtoria 2 (dy) ditore ku të gjithë akterët relevant dhe si rezultat kanë dalë objektivat dhe aktivitetet si vijon:

# 5. Objektiva 1

1. Krijimi i kushteve dhe mundësive të barabarta për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Skenderajt;

Për arritjen e kësaj objektive janë paraparë aktivitetet si vijon:

1.1. Krijimi i një databaze të saktë për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Skenderajt – Përmes këtij aktiviteti parashihet të bëhet një identifikim i personave me aftësi të kufizuara në të gjithë komunën, këtu përfshihet gjithashtu vlerësim i shkathtësive, nevojave dhe një analizë e përgjithshme e mundësive dhe kërkesave të kësaj kategorie për vetë-punësim dhe punësim.

1.1.1. Mirëmbajtja dhe përditësimi i databazës – Përmes këtij aktiviteti parashihet që; databaza e krijuar të mirëmbahet dhe të përditësohet me qëllim të posedimit të informacioneve më të sakta lidhur me numrin e PAK të punësuar.

1.2. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në nivel institucional – Përmes këtij aktiviteti synohet që institucionet komunale të plotësojnë kuotat e parapara me ligj për punësimin e personave me aftësi të kufizuara (50 +1). Ky aktivitet parasheh që personat me aftësi të kufizuara me shkollim superior të kenë prioritet në punësim duke respektuar ligjet dhe rregulloret në fuqi të cilat lidhen me punësim.

1.3. Punësimi i PAK në kompanitë private përfshirë OJQ-të – Përmes këtij aktiviteti synohet punësimi i personave me aftësi të kufizuara në kompani private duke përfshirë edhe sektorin joqeveritar.

1.4. Vetëpunësimi i personave me aftësi të kufizuara përmes granteve komunale – ky aktivitet parasheh që veçanërisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport të vendosin lehtësira për personat me aftësi të kufizuara në marrjen e granteve të cilat lidhen me punësim.

1.4.1. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në kompani private përmes granteve komunale – Ky aktivitet ka për qëllim që të nxisë edhe kompanitë private që të krijojnë vende pune për personat me aftësi të kufizuara përmes granteve të cilat ata mund të marrin nga institucionet komunale.

1.5. Aplikimi për grante në Ministritë e Linjës dhe Agjencionet Qeveritare – Ky aktivitet parasheh mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara që të aplikojnë dhe të përfitojnë grante dhe mundësi punësimi edhe nga ministritë dhe agjencionet qeveritare të cilat kanë për synim punësimin.

1.6. Vetëpunësimi i personave me aftësi të kufizuara përmes granteve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare – Duke u bazuar edhe nga përvoja e mëhershme, përmes këtij aktiviteti parashihet që të punohet në thithjen e granteve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

1.7. Informimi në baza të rregullta i PAK për mundësitë për grante (komunale, të nivelit qendror, dhe organizatat ndërkombëtare) dhe forma të tjera të punësimit – Ky aktivitet parasheh që veçanërisht Handikos Skenderaj dhe organizatat tjera të cilat merren me aftësinë e kufizuar që ti informojnë personat me aftësi të kufizuara për mundësitë e punësimit. Handikos Skenderaj do të krijon infrastrukturën për informim të personave me aftësi të kufizuara në komunën e Skenderajt.

1.8. Fushatat vetëdijësuese për punësimin e PAK, në sektorin publik dhe privat dhe për vetë-punësim – Qëllimi i këtij aktiviteti është që të ngritët sa më shumë vetëdija edhe e institucioneve por edhe e sektorit privat për rëndësinë dhe mundësinë që personat me aftësi të kufizuara kanë për punësim.

1.8.1. Organizimi i sesioneve informuese për kompanitë private – Në kuadër të këtij aktiviteti parashihet që të organizohen sesione informuese vetëm me kompanitë private, pasi që akoma ka paragjykime për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

1.8.2. Organizimi i sesioneve informuese për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre – Në kuadër të këtij aktiviteti parashihet që personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në baza të rregullta për mundësitë e punësimit dhe vetëpunësimit.

## 5.1 Objektiva 2

2. Aftësimi dhe riaftësimi profesional për punësimin e personave me aftësi të kufizuara

2.1. Identifikimi dhe zgjerimi i profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave së tregut të punës, veçanërisht në lëminë e IT (web design, drop shopin, marketing dixhital, forex, gastronomi, rrobaqepësi/dizajn, etj.) – Ky aktivitet ka për qëllim përgatitjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara për tregun e punës. Ky aftësim parashihet edhe në kuadër të shkollave përmes profileve ekzistuese, por edhe përmes aftësimit përmes trajnimeve dhe kurseve të ndryshme për këtë kategori, me qëllim që të jenë sa më të gatshëm për tregun e punës.

2.2. Informimi dhe orientimi i nxënësve me aftësi të kufizuara të klasave të IX-ta për profilizim profesionale – Ky aktivitet parasheh që të rinjtë me aftësi të kufizuara të informohen sa më herët dhe të orientohen në karrierë.

2.3. Ngritja e kapaciteteve të PAK në kompani private (Trajnime në Punë) – Ky aktivitet parasheh përgatitjen e të rinjve me aftësi të kufizuara në aspektin praktik në kompani të ndryshme. Përveç përgatitjes, aty ku tregohen rezultate kompanitë edhe ti punësojnë në mënyrë të përhershme personat me aftësi të kufizuara.

6. Objektivi specifik 1: Krijimi i kushteve dhe mundësive të barabarta për Punësimin e PAK në komunën e Skenderajt:

| Aktiviteti | Treguesi | Mjetet e verifikimit | Synimi | Institucioni zbatues | Institucion i mbështetës | Afati kohor | | | Buxheti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | V 1 | V 2 | V 3 | |
| 1.1. Krijimi i një databaze të saktë për PAK në komunën e Skenderajt<br><br>1.1.1 Mirëmbajtja dhe përditësimi i databazës | Numri total i PAK në komunën e Skenderajt<br><br>Numri i PAK me kualifikim superior/mesëm<br><br>Numri i PAK të punësuar në sektorin publik<br><br>Numri i PAK të punësuar në sektorin privat<br><br>Numri i PAK të vetë-punësuar - Vetë-punësimi në baza vullnetare në kuadër të projekteve të ndryshme | Databaza e krijuar | Pasqyrimi i numrit, kategorive dhe gjendjes sa më të qartë për PAK | Handikos Skenderaj | Komuna<br><br>OPAK<br><br>OJQ | x | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | (Pasqyrë më e saktë lidhur me kategoritë, diagnozat, kualifikimet, certifikimet dhe aftësitë e ndryshme profesionale)<br><br>Databaza e përditësuar | | | | | | | | |
| 1.2. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në nivel institucional | Komuna merr veprime konkrete për punësimin e PAK në përputhje me ligjin në fuqi dhe duke krijuar kushte, teknologji dhe mjedis të përshtatshëm | Numri i të punësuarve – së paku 3 në vit | Rritja e numrit të PAK të punësuar në institucionet komunale | Komuna me drejtoritë përkatëse, OPAK | Donatorët<br><br>OJQ<br><br>OPAK<br><br>Institucionet tjera publike | x | x | x | Në bazë të koeficientit të zyrtarëve përcaktohet buxheti për këtë aktivitet. |
| 1.3. Punësimi i PAK në kompanitë private përfshirë OJQ-të | Kompanitë private dhe OJQ-të marrin veprime konkrete për punësimin e PAK, së paku të punësohen 10 PAK gjatë periudhës 3 vjeçare, duke ofruar gjithashtu mbështetje | Numri i të punësuarve | Rritja e numrit të PAK të punësuar në kompani private dhe OJQ | Kompanitë private dhe OJQ-të që operojnë në komunë, OPAK | Zyra e punësimit në Skënderaj<br><br>Donatorët<br><br>Komuna | x | x | x | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe teknologji për mbështetjen e punësimit të qëndrueshëm | | | | | | | | |
| 1.4. Vetë-punësimi i PAK përmes granteve komunale<br><br>1.4.1. Punësimi i PAK në kompani private përmes granteve komunale | Numri i granteve të dhëna nga institucionet komunale së paku 6 | Numri i të punësuarve | Rritja e numrit të PAK të vetë-punësuar dhe punësuar në kompani private (OJQ) përmes granteve komunale | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, DKRS, Zyra për Barazi Gjinore, OPAK | Zyra e Kryetarit të komunës | x | x | x | |
| 1.5. Aplikimi për grante në Ministritë e Linjës dhe Agjencionet Qeveritare | Numri i granteve të përfituara nga ministritë për punësimin e PAK, së paku 6 | Numri i të punësuarve | Rritja e numrit të të vetëpunësuarve nga grantet qeveritare | Ministritë e linjës, agjencionet, Zyra e Presidences, OPAK | OPAK | x | x | x | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.6. Vetë-punësimi i PAK përmes granteve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare | Numri i PAK të punësuar përmes granteve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare, së paku 15 | Numri i të punësuarve | Zvogëlimi i numrit të të papunëve nga PAK | Organizatat vendore/ndërkombëtare, OPAK, OJQ, komuna, Zyra e Punësimit | OJQ, komuna, Zyra e Punësimit | x | x | x | |
| 1.7 Informimi në baza të rregullta i PAK për mundësitë për grante (komunale, të nivelit qendror, dhe organizatat ndërkombëtare) dhe forma të tjera të punësimit | Një person përgjegjës për informim në kuadër të Handikos Skenderaj | Numri i informacionit të shpërndarë për PAK | PAK më të informuar dhe udhëzuar lidhur me mundësi për punësim | Handikos Skenderaj | Donatorët<br>OJQ<br>OPAK | x | x | x | |
| 1.8. Fushatat vetëdijusuese për punësimin e PAK, në sektorin publik dhe privat dhe për vetë-Duhet të përcaktohen edhe afate kohore të detajuara për çdo fazë të fushatës, duke përfshirë planifikimin, implementimin, dhe monitorimin. | Numri i fushatave të Të caktohet një numër i qartë i sesioneve informuese dhe të specifikohen temat dhe qëllimet e tyre. Çdo vit do të organizohen së paku 3 sesione informuese | Numri i broshurave, fletëpalosjeve, emitimi i informacionit në mediat elektronike dhe të shkruara; | Vetëdijësimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e PAK | Handikos Skenderaj | Komuna<br>OJQ<br>OPAK<br>Donatorë | x | x | x | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | |
| 1.8.1 Organizimi i sesioneve informuese për kompanitë private | Numri i sesioneve informuese të organizuara (2 x në vit) | Takimet e realizuara, listat e pjesëmarrësve, fotografi. | Informimi i kompanive private në lidhje me rëndësinë/përfitimet nga punësimi i PAK | Handikos Skenderaj dhe OJQ-të tjera | Komuna, OJQ-të | x | x | x | |
| 1.8.2. Organizimi i sesioneve informuese për PAK dhe familjarët e tyre | Numri i takimeve informuese të organizuara me PAK dhe familjar (12 takime për vit – 1 për çdo bashkësi lokale) | Takimet e realizuara | Informimi rreth mundësive për punësim për PAK dhe mbështetja për familjet e tyre | OPAK, OJQ-të | Komuna, OJQ-të | x | x | x | |

6.1 Objektivi specifik 2: Aftësimi dhe riaftësimi profesional për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar në Skenderaj:

| Aktiviteti | Treguesi | Mjetet e verifikimit | Synimi | Institucioni zbatues | Institucion i mbështetës | Afati kohor | | | Buxheti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | V 1 | V 2 | V 3 | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1. Identifikimi dhe zgjerimi i profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave së tregut të punës, veçanërisht në lëminë e IT (web design, drop shopin, marketing dixhital, forex, gastronomi, rrobaqepësi/dizajn, etj.) | Numri i profileve të përshtashëm për personat me aftësi të kufizuar.<br>Numri i PAK që janë aftësuar nga të gjitha kategoritë e PAK<br>Aftësimi profesional i rreth 30 PAK | Programet e hartuara<br>Profilet e akredituara<br>Listat e PAK që janë certifikuar | Ngritja e kapaciteteve profesionale të PAK | Zyra e punësimit<br>Qendra e Kompetencës Skënderaj<br>IAAP "Anton Çetta"<br>QAP | Komuna<br>OPAK<br>OJQ<br>Bizneset<br>Donatorët | x | x | x | |
| 2.2. Informimi dhe orientimi i nxënësve me aftësi të kufizuara të klasave të IX-ta për profilizim profesionale | Numri i fëmijë me aftësi të kufizuara rreth 150 nxënës | Takimet informuese nëpër shkolla fillore (23 shkolla fillore) | Informimi sa më i plotë i nxënësve rreth mundësive për përzgjedhje të profesioneve | Drejtoria e Arsimit (Komuna), Qendra e Kompetencës, OPAK, | OJQ-të, Donatorët, | x | x | x | |
| 2.3. Ngritja e kapaciteteve të PAK në kompani private (Trajnime në Punë) | Numri i PAK të aftësuar për profesione të caktuara, rreth 15 PAK | Numri i PAK të involvuar | Ngritja e potencialeve të PAK për punësim në sektorin privat | OPAK, OJQ, bizneset | Donatoret, komuna, OJQ-të, Zyrat e punësimit. | x | x | x | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opstina Skenderaj
Municipality of Skenderaj

# PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR DRAFT-PLANIN E VEPRIMIT PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2024-2027

Duke duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Skenderajt Nr.110-385 i datës 03.12.2008 dhe Nenit 6 pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Zyra për Informim bën njoftimin për:

**Konsultim publik për Draft-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2024-2027**

Me 25.03.2024, është mbajtur takimi i parë i grupit punues i udhëhequr nga kryesuesja e grupit, Gentiana Zeqiri dhe në pjesëmarrje të të gjithë anëtarëve tjerë. U prezantua Draft-Plani dhe u dhanë rekomandimet. Në këtë takim anëtarët kanë diskutuar për rëndësinë e planit që nga përmbajtja, bazën ligjore të nevojshme si dhe listën e indikatorëve të cilat duhet të realizohen me qëllim të informimit publik. Grupi punues u dakordua që Ky draft-Plan të dalë në diskutim publik nga data 24.04.2024, kurse diskutimi publik të mbahet me datë 07.05.2024 në sallën e Kuvendit Komunal nga ora 14:00.

Me 24.04.2024, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për Draft-Planin e Veprimit për Punësimin e Përsonave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027. Njoftimi është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Publikimi në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike

Plani u publikua në këtë link në faqen zyrtare:
https://kk.rks-gov.net/skenderaj/category/konkursey-njoftimet/?page=4

**KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË**

Më datë: 07.05.2024 mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues nga Handikos, qytetarë të ndryshëm.

Dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Në ueb faqe: https://kk.rks-gov.net/skenderaj/wp-content/uploads/sites/27/2024/04/Njoftim-publik.pdf

Konsultimi publik filloi në orën 14:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

Konsultimin e shpalli të hapur udhëheqësja e grupit punues Gentiana Zeqiri e cili në pika të shkurtëra prezantoi përmbajtjen e Draft Planit të veprimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara 2024-2027, i cili ka për qëllim t'i ofroj kësaj kategorie të ndjeshme te shoqërisë, qasje me të lehtë të trajnimi, aftesimi dhe punësimi. Si dhe u prezantua puna e grupit ne punetorin dy ditore dhe të arriturat që kanë pasur qëllim draft planin. Gjithashtu u prezantua se ky dokument mbeshtet nga programi Reload 2 në bashkepunim me komunen e Skenderajt dhe rjedh nga organizata handikos ne Skenderaj.

**Gentiana Zeqiri, kryesuese e komisionit:** Përshëndetje të gjithë, faleminderit që jeni në këtë diskutim publik lidhur me draft-planin e për punësimin e personave me aftësi te kufizuara 2024-2027. Komisioni i themeluar për hartimin e këtij plani, ka mbajtur takime para këtij diskutimi, dhe është prezantuar ky dokument në formën e draftit, i cili përmban veprime konkrete, objektiva dhe masat për punësimin e personave me aftësi te kufizuara. Si dokument përfshin periudhën 3 vjeçare. Pasi të përfundojnë të gjitha procedurat e parapara me udhëzimin për standardet minimale të konsultimeve publike, draft-plani do të shkojë edhe në Kuvend, i cili sapo ta miratojë, do të bëhet i plotfuqishëm.

“Plani i veprimit për punësimin e personave me aftësi te kufizuara 204-2027 është një dokument që rrjedh nga një dokument paraprak i cili ka qenë mjaft konkret dhe rezultativ, duke i përmbushur objektivat dhe arritur të trajnoj, aftësoj dhe punësoj këtë kategori të ndjeshme të shoqërisë. Plani i ri është dokument 3 vjeçare i cili gjithashtu është vazhdimësi e planit paraprak. Ky planë është i mbështetur nga Programi Rajonal për Demokraci Lokale Reload 2 dhe Komuna e Skenderajt dhe përmbajnë qëllimin dhe objektivat e qarte për të arritur misioni përfundimtarë.

Gentiana Zeqiri : A ka dikush ndonjë koment tjetër rreth këtij Plani?

Edona Gashi: Çka ka me bere saktë ky planë?

Mirsad Gashi: Qysh ka arrite me punesu plani paraprak? A ka ndikua plani me punësua këtë kategori apo si ka qene?

Gentiana Zeqiri: Po fillimisht është bere një plane pastaj kur është hape një thirrje për aplikim ne si Handikos kemi aplikuar dhe kemi prezantuar qe kemi edhe planin për punësimin e personave me aftësi te kufizuara andaj ke qene kriter qe ka ndikuar direkt ne fitimin e projektit i cili projekt pastaj ka mbështetur; trajnimin, përgatitjen dhe punësimin.

Gentiana Zeqiri: Plani synon te përgatisë, trajnoj dhe punësoj personat me aftësi të kufizuar siç ka ndodh me planin paraprak i cili ka qene arsye e fitimit të një projekti nga Bashkimi Evropian dhe ka ndikuar ne punësimin e shume personave me aftësi te kufizuara.

Nëse jo, ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Konsultimi përfundoi në orën: 14:42

Baki Beqiri

Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim

KOMUNA SKENDERAJ OPSTINA SKENDERAJ
NPL "Eko Natyra" SH.A.
Data Pranuar Dorzuar / Datum Primjen/Dostavljen 27/02/2024 Skenderaj

| Njësia Org. / Org. Jedin. | Shif.Klas. / Klas. ked. | Nr. Prot. / Br. Prot. | Nr. Faqeve / Br. Stranica |
|---|---|---|---|
| 001 | 001 | 023/24 | 007 |


NPL "EKO NATYRA" SH.A. SKENDERAJ

# RAPORT VJETOR 2023



Skenderaj 2024

PËRMBAJTJA


I. INFORMATA TE PËRGJITHSHME ........ 3
II. HYRJE ........ 4
III. FJALA E KRYESUESIT TE BORDIT ........ 5
IV. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV ........ 6
V. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES ........ 7
VI. STRUKTURA ORGANIZATIVE ........ 10
VII. PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I NDËRMARRJES........ 11
VIII. AKTIVITETET E PROKURIMIT........ 11
IX. PASQYRAT FINANCIAR ........ 12
X. DEPARTAMENTI JURIDIK ........ 13
XI. PËRFUNDIMI ........ 14

## I. INFORMATA TE PËRGJITHSHME

| | |
|---|---|
| Emri i Ndërmarrjes: | *NPL "Eko Natyra" SH.A. Skenderaj* |
| Pronar: | *Komuna Skenderaj* |
| **Aksionar:** | • *Behxhet Maliqi*<br>• *Avdullah Geci*<br>• *Kushtrim Draga* |
| **Bordi i Drejtorëve:** | • *Albert Ismajli ................ kryesues*<br>• *Artan Ramadani.............anëtar*<br>• *Valentina Rama..............anëtar*<br>• *Mirlinda Hajdari............anëtar*<br>• *Shemsi Maksuti ............. anëtar* |
| **Kapitali Themeltar:** | *10.000,00€* |
| **Objekti:** | *Rruga "Ali Gashi" p.n.Skenderaj* |
| **Makineri:** | *Kombi ............................. 2 copë*<br>*Kamionetë ..................... 1 copë*<br>*Autocisternë .................. 1 copë*<br>*Kultivator ....................... 1 copë*<br>*Veturë .............................. 1 copë* |
| **Numri i te punësuarve:** | *40 punëtor* |
| **Mosha mesatare e te Punësuarve:** | *41 vjeç* |
| **Struktura gjinore e te punësuarve:** | *21 Meshkuj*<br>*19 Femra* |

## II. HYRJE

Gjatë gjithë vitit 2023, kompania kishte një ecuri progresive drejt realizimit të planit operativ dhe financiar.

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2022.

Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj.

Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit.
Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese.
Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë.

Raporti vjetor i punës së Kryeshefit Ekzekutiv është bërë sipas aktiviteteve dhe punëve të cilat janë paraparë në Planin e Biznesit të Ndërmarrjes për vitin 2023

## III. FJALA E KRYESUESIT TE BORDIT TE DREJTORËVE

*Të nderuar,*

Gjatë tërë vitit 2023 Bordi është angazhuar me përkushtim të lartë që ndërmarrja të ketë kontinuitet të punëve në arritjen e rezultateve në raport me objektivat e planifikuara.

Përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësive ligjore ka qenë fokusi kryesor i Bordit. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Nr. 06/L-016).

Bordi i Drejtorëve i NPL"Eko Natyra" Sh.A, në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për kompaninë si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë fokusi kryesor i Bordit te Drejtorëve për një qeverisje korporative të ndërmarrjes.

Në saje të angazhimit të të gjithë drejtorëve të bordit nuk kanë munguar as sukseset në përmbushjen e obligimeve, ku kemi marr vendime te shumta të cilat kanë ndikuar ne rritjen e performancës se ndërmarrjes dhe ne stimulimin dhe përkrahjen e punëtorëve.

Po ashtu edhe angazhimi i stafit menaxhues është për t'u vlerësuar.

Në vijim, në këtë raport-vështrim, do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023 Bordi i Drejtorëve i NPL"Eko Natyra" Sh.A ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, 11 mbledhje te rregullta dhe 1 (një) mbledhje te jashtëzakonshme, ku gjatë kësaj periudhe janë marr 10 (dhjetë) vendime.

Po ashtu edhe konsultat dhe kontaktet tjera midis drejtorëve të Bordit dhe menaxhmentit të kompanisë kanë qenë të shpeshta.

Kryesuesi i Bordit
Albert Ismajli

## IV. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

*Te nderuar,*

NPL"Eko Natyra" Sh. A. vitin 2023 arriti që ta përmbyll me një rezultat të mirë këtë vit qe po e lemë pasë, i cili pothuajse është një realizim i Planit te Biznesit të vitit 2023 mbi 95%.

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes gjatë vitit 2023 kanë qenë në drejtim të realizimit të objektivave të planifikuara në Planin e Biznesit për vitin 2023, si dhe në drejtim të tejkalimit te këtij Plan Biznesi duke shtuar shërbimet edhe përtej këtij Plani, e duke i tejkaluar te gjitha pengesat dhe vështirësitë qe kishim gjatë këtij viti, si një ndërmarrje ne zhvillim e sipër e qe kishim shume sfida.

Kemi qenë të përkushtuar maksimal për një zhvillim të gjithmbarshëm të kompanisë duke qenë të kujdesshëm në menaxhim me një Profesionalizëm, Transparencë, Integritet dhe frymë ekipore.

Në kuadër të këtij përkushtimi do të kemi një plan afatmesëm strategjik për zhvillimin e kompanisë, ku do të vendosim objektiva të qarta mbi mundësinë e zgjerimit të shërbimeve me synim te rritjes dhe zhvillimit te ndërmarrjes paralelisht me rritjen e kapaciteteve si financiare po ashtu edhe ne makineri, pajisje dhe mjete te punës.

Kryeshef Ekzekutiv
Shemsi Maksuti

## V. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes gjatë vitit 2023 kanë qenë në drejtim të realizimit të objektivave të planifikuara për këtë vit si dhe në drejtim të tejkalimit të pengesave dhe vështirësive tjera të ndërmarrjes.

Ne jemi angazhuar maksimalisht si zotim i ndërmarrjes për ofrimin e shërbime efikase dhe cilësore, ku si shërbime kemi mbuluar Pastrimin e hapësirave te brendshme te institucioneve Publike ne Skenderaj si dhe Mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike si parqet, sheshet, rrugët dhe trotuaret, andaj gjatë kësaj periudhe janë të pasqyruara të gjitha veprimet e ndërmarra në kryerjen e këtyre shërbimeve si:

- ✓ **Pastrimi,** ne jemi përkushtuar që institucioneve publike të cilave u kryejmë shërbimin e pastrimit te ambientit të brendshëm të jetë efikas dhe cilësor, ku për momentin jemi duke ju shërbyer pa ndonjë vërejtje. Me qëllim të shërbimit sa më efikas ne kemi ndërmarre edhe një hap në këtë drejtim, pas kontrollit kohë pas kohe kemi konstatuar se mund të jetë më e mirë dhe më efikase ndërrimi-transferimi i disa punëtorëve nga një institucion në tjetrin, ku kemi bërë ndërrimin-lëvizjen e dy (2) punëtorëve përkohësisht, ku është vërejtur se ka qene një hap i mire dhe ka sjellë ndryshime pozitive në kryerjen e shërbimeve më efikase, ketë vit kemi pasur punë dhe angazhime shtesë ne objektin e Shtëpisë se Kulturës e cila ka qene ne renovim pothuajse gjatë ter vitit, si dhe ne objektin e Komunës e cila edhe ajo kishte bere ngjyrosjen e brendshme me ngjyre dhe kishim pune dhe angazhim shtese.

- ✓ **Mirëmbajtja,** ne sa i përket mirëmbajtjes së hapësirave publike të shfrytëzuara dhe të pa shfrytëzuara te lira, përkundër numrit te vogël te punëtoreve ne jemi duke përmirësuar gradualisht cilësinë dhe efikasitetin e këtij shërbimi jo vetëm sipas marrëveshjeve që kemi me komunën por edhe kemi asistuar edhe në shërbime tjera me kërkesë të DSHP-së si :

1. **Mirëmbajtja e hapësirave të shfrytëzuara,** ne jemi duke mirëmbajtur këto hapësira publike si:

- **Sheshin "Adem Jashari",** me rreth 5700$m^2$
- **Oborrin e Shtëpisë së Kulturës "Hasan Prishtina",** me rreth 2660$m^2$
- **Oborrin e QKMF-së,** me rreth 3250$m^2$
- **Oborrin e Komunës,** me rreth 1800$m^2$

- **Oborrin e QPS-së,** me rreth 1450m$^2$
- **Parkun "Shaban Polluzha" , kohë pas kohe, (mbledhja e mbeturinave)** me rreth 2000m$^2$
- **Parkun "Idriz Rreci",** me rreth 26460m$^2$
- **Parkun Amerikat të "Lirisë",** me rreth 750m$^2$, vetëm stazat për momentin.
- **Mirëmbajtja e hapësirës përreth palestrës Sportive "Ilaz Kodra",** me rreth 7300m$^2$
- **Hapësira afër Çerdhes "Nëna Zahide", kohë pas kohe,** me rreth 1960m$^2$
- **Parkingu afër Çerdhes "Nëna Zahide", kohë pas kohe,** me rreth 1380m$^2$
- **Parkingu te banesë e "Binqës", koha pas kohe,** me rreth 2150m$^2$
- **Parkingu në rrugën "Xheve &Fehmi Lladrofci", kohë pas kohe,** me rreth 760m$^2$
- **Parkun nder Gjykate,** rreth 850 m$^2$
- **Poligonin sportiv "Multi Etnik"** me mbledhjen e mbeturinave dhe fshirjen

2. **Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve,** ne jemi duke mirëmbajtur rrugët dhe trotuaret edhe pas shume sfidave dhe vështirësive pasi që kemi shume objekte duke u ndërtuar brenda qytetit ku gjate bartjes se materialit ndërtimor dhe gërmimeve te dheut, rrugët dhe trotuaret janë duke u mbushur me balte, por prapë se prapë jemi duke u përpjekur qe ato te jene te pasteta, pra ne jemi duke mirëmbajtur rrugët kryesore të qytetit si arterie e qarkullimit dhe lëvizjeve të mëdha Brenda qytetit si:
   - **Rruga "18 Qershori"**
   - **Rruga "IlaZ Kodra"**
   - **Rruga "28 Nëntori"**
   - **Rruga Xhevë dhe Fehmi Lladrofci"**
   - **Rruga "Sala dhe Hamit Jashari"**
   - **Rruga "17 Shkurti"**
   - **Rruga "Fadil Rrustemi"**
   - **Rruga "Adem Demaqi"**
   - **Rruga "Ahmet Delija"**
   - **Rruga "Gjergj Fishta"**
   - **Rruga "Xhon Buzuku I dhe II"**
   - **Rruga "Osman Geci"**
   - **Rruga e Tregut te Gjelbërt**

**Ne gjate këtij viti kemi intervenuar edhe ne keto pika kritike qe kane qene me mbeturina si:**

- **Pastrimi i oborrit të Objektit në Zyrën e vendit Likoc**
- **Pastrimi i oborrit të Objektit në Zyrën e vendit Kline e Epërme**
- **Pastrimi i oborrit të Objektit në Zyrën e vendit Prekaz**

Ne po ashtu gjatë këtij viti kemi intervenuar edhe ne oborret e objekteve shëndetësore me terkes te Drejtorisë se Shëndetësisë si "

- **Pastrimi i QMF-se ne Turiqec**
- **Pastrimi i QMF-se ne Llaushe**
- **Pastrimi i QMF-se ne Runik**
- **Pastrimi i QMF-se ne Kline te Epërme**
- **Pastrimi i AM-se ne Aqarevë**
- **Pastrimi i AM-se ne Izbicë**

3. **Mirëmbajtja me kërkesë të DSHP-së**, ne kohë pas kohe angazhohemi në mirëmbajtje si:

- **Pikën e zezë me mbeturina në shesh afër objektit të Postës së Kosovës**
- **Pikën e zezë me mbeturina përreth tregut të Gjelbër**
- **Pikën e zezë me mbeturina tek objektet banesore me karakter Banimi Social**
- **Pastrimi i rrugës Turiqec-Kllodernicë**
- **Pastrimi i rrugës me 4 korsi segmenti prej Xhamisë se Skenderajt deri te rruga 17 Shkurti**
- **Pikën e zezë me mbeturina në shesh ne objektin ish Jugobanka**

Po ashtu ne për këtë vit kalendarik qe ne po raportojmë jemi duke menaxhuar me shërbimin shtesë, menaxhimin me parkingun publik tek poligoni sportiv multietnik mbrapa shtëpisë së kulturë, ku këtë vit kemi pasur disa ndërprerje te punës ne shërbim te qytetareve pasi që ishte si një projekt i pa përfunduar dhe për arsye te punimeve kemi mbyllur hyrjet përkohësisht, kemi punuar me kushte minimale të punës, pa kushte teknike të sigurisë dhe ndriçimit si dhe pa ngrohje ne sezonin e dimrit, por kah mesi i këtij viti janë ekzekutuar punimet e mbetura ne gjysme dhe ka përfunduar i tërë projekti ne pjesën e dyte te vitit. Mirëpo fal angazhimit te punëtorëve tanë ne jemi duke vazhduar me menaxhim pa ndonjë problem.

## VI. STRUKTURA ORGANIZATIVE

NPL "Eko Natyra" SH. A. brenda periudhës Janar – Dhjetor 2023 në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ka pasur disa ndryshime të cilat kanë reflektuar edhe në përqindjen e strukturës së përgjithshme të të punësuarve.

Në tabelën në vijim do të paraqesim gjendjen e të punësuarve në Kompani nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, si dhe krahasimet me vitin paraprak.

Skema organizative e NPL "Eko Natyra" Sh. A.

| Departamenti | Nr. te Punësuarve | 2023 | 2022 |
|---|---|---|---|
| Bordi i Drejtorëve | 4 | 0 | 4 |
| Menaxhment | 2 | 0 | 3 |
| Administrate | 3 | 2 | 1 |
| Pastrues i hapësirave te brendshëm | 21 | 0 | 20 |
| Mirëmbajtës i Hapësirave Publike te jashtme | 10 | 0 | 10 |
| | | | |
| GJITHSEJTË | 40 | 2 | 38 |

**Struktura gjinore**

| Departamenti | Nr. te Punësuarve | M | F |
|---|---|---|---|
| Bordi i Drejtorëve | 4 | 3 | 1 |
| Menaxhment | 2 | 2 | 0 |
| Administrate | 3 | 2 | 1 |
| Pastrues i hapësirave te brendshëm | 21 | 4 | 17 |
| Mirëmbajtës i Hapësirave Publike te jashtme | 10 | 10 | 0 |
| | | | |
| GJITHSEJTË | 40 | 21 | 19 |

## VII. PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I NPL "EKO NATYRA" SH.A

Krahasuar ne Planifikimin dhe zhvillimin e ndërmarrjes për vitin 2023 të paraparë ne Plan Biznes të ndërmarrjes, ne kemi arritur ta përmbushim atë, por kemi bërë hapa përtej tij duke arritur ne rritjen e numrit te shërbime shtese dhe lidhje te kontratave te reja ne favor te ndërmarrjes.

Ne si menaxhment në vitin 2023 kemi arritur që krahasuar me vitin paraprak ta shtojmë edhe një shërbim më shumë krahasuar me vitin paraprak e cili do ndikoje direkt ne zhvillimin dhe rritjen e ndërmarrjes, e ky shërbime është Larja dhe Fshirja e rrugëve ne Qytet.

Ne si menaxhment kemi pasur edhe takime te niveleve te kryeshefave ekzekutiv me ndërmarrjet tjera përmes "PAMKOS-it" ku kemi biseduar për shume çështje dhe kemi shkëmbyer e provoja te ndryshme ne zgjedhjen e problemeve te ndryshme.

Ne si menaxhment gjate këtij viti qe po raportojmë kemi pasur edhe takime, biseda e vizita me subjekte te ndryshme, ku kemi biseduar dhe kemi shkëmbyer edhe përvoja nga me te ndryshmet, kemi marrë këshilla, kemi pas takime me GIZ-in Gjerman, KFOR-in Slloven.

## VIII. AKTIVITETET E PROKURIMIT

Ne si ndërmarrje ende nuk kemi plotësuar stafin e sektorit te prokurimit, ende jemi duke i shfrytëzuar furnizimet me kontrata te komunës, ndërsa për furnizim me pajisje jemi duke e shfrytëzuar zyrën e prokurimit te komunës e cila ajo po i zhvillon procedurat edhe për ndërmarrjen tone.

Vitin qe po raportojmë kemi pasur një procedurë te prokurimit për furnizim me pajisje, ku zyra e prokurimit ka zhvilluar procedurat ne kemi bere specifikacionin ndërsa Drejtoria e Shërbimeve Publike i ka bere pagesat.

Për vitin e ardhshëm po ashtu ne nuk kemi mjete dhe as planifikim për te zhvilluar ndonjë procedure te prokurimit, veçse komuna ka planifikuar te na beshtes edhe me disa Makineri e cila ajo do t`i bëjë pagesat dhe procedurat e prokurimit ndërsa neve mundet me na u kërkuar vetëm specifikat teknike.

Ne aktualisht jemi duke i shfrytëzuar kontratat për furnizim me material për zyre, furnizim me material shpenzues, furnizimin me derivate.

## IX. FINANCAT

Ndërmarrja publike "Eko Natyra" SH.A. si ndërmarrje Komunale me 100% aset i Komunës së Skenderajt është e themeluar një vit e gjysmë me parë me një kapital fillestar në shumë prej 10.000.00€ (dhjet mijë euro) te deponuara në xhirollogarinë Bankare te Ndërmarrjes.

Mirëpo si ndërmarrje fal menaxhmentit dhe stafit punonjës si dhe me mbështetjen e komunës dhe donatoreve, ndërmarrja fillon të zhvillohet si dhe të krijoj kapital dhe aset në pronësi të saj, ne kemi paraqitur ne tabelën e më poshtme pasurin e krijuar deri në fund të viti 2023 me klasifikime të llojeve të pasurisë si dhe me krahasime te vitit paraprak si:

| **Klasifikimi i pasurive** | 2023 | 2022 |
|---|---|---|
| Ndërtesat | - | - |
| Toka | - | - |
| Makineri | 30,850.00 | 30,850.00 |
| Vegla | 9,629.00 | 1,630.00 |
| Automjetet | - | - |
| Tjera | - | - |
| Inventar | 1,500.00 | 1,500.00 |
| Mobilje | - | - |
| Teknologji informative | 1,200.00 | 1,200.00 |
| **Gjithsej** | **43,179.00** | **35,180.00** |

Ne si ndërmarrje e re ende kemi mbetur vetëm me dy burime të të hyrave te rregullta dhe krijimit të buxhetit të ndërmarrjes si dhe mundësia e përfitimit te ndonjë donacioni apo grandi, njëri burim nga pagesat për shërbime ndaj komune si dhe burimi tjetër nga te hyrat vetanake nga biletat e parkingut publik, te paraqitura si me poshtë si:

| Përshkrimi | 2022 | 2023 |
|---|---|---|
| Të hyrat e bartura nga viti i kaluar | 7,929.26 | 9,314.55 |
| Të hyrat vetanake | 9,272.00 | 18,938.00 |
| Të hyrat nga Marrveshjet me Komunen | 185,942.40 | 227,622.00 |
| Të hyrat nga Masa 1.6 mbeshtetje nga Qeveria | - | 7,280.00 |
| Të hyrat nga Masa 1.4 mbeshtetje nga Qeveria | - | 3,960.00 |
| Subvencion nga Kryetari I komunes | - | 1,000.00 |
| Rimbursim nga ATK | - | 900.00 |
| Kthim I mjeteve | - | 26.10 |
| **Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual** | **203,143.66** | **269,040.65** |

Ndërmarrja pas realizimit te hyrave të cilat i kishte në dispozicion për vitin kalendarik 2022, i shpenzoj në realizimin e planit të biznesit për vitin 2022, e qe ishte një realizim i shpenzimeve të arsyeshme dhe ndikuese në aktivitetet e ndërmarrjes dhe ndikimi në ofrimin e shërbimeve efikase dhe cilësore, realizimin e shpenzimeve e kemi paraqitur në kategori ekonomike me krahasim të viti paraprak, të paraqitura ne tabelën e me poshtme si:

| **Kategoria ekonomike** | **2022** | **2023** |
|---|---|---|
| Paga dhe rroga | 131,169.09 | 162,225.85 |
| Mallra dhe shërbime | 41,496.40 | 32,780.91 |
| Shpenzime komunale | - | - |
| Transfere dhe subvencione | - | - |
| Shpenzime kapitale | - | - |
| Shpenzime administrative | 326.90 | 342.42 |
| Shpenzime ATK | 29,244.44 | 34,003.37 |
| **Gjithsej** | **202,236.83** | **229,352.55** |
| Punet e pranuara me proqese | | |
| TOTAL | 202,236.83 | 229,352.55 |

## X. DEPARTAMENTI JURIDIK

Sa i përket qeshjeve Juridike ne ndërmarrjen tone për këtë vit qe po raportojmë ne kemi ndërmarrë hapa për ta fuqizuar Departamentin Juridik ku kemi pranuar një zyrtar ligjore i cili do te jete një ndihmese e madhe ne përcjelljen e legjislacionit dhe ndryshimeve ne legjislacion, po ashtu do jete boshti kyç ku përmes departamentit Juridik do te hartohen dokumente standarde dhe komfort ligjeve te aplikueshme për ndërmarrjen.

Ne çështjet Juridike ne si ndërmarrje gjate këtij viti pra 2023 kemi nxjerr këto shkresa zyrtare si :

| AKTIVITETIT | VENDIME | KËRKESA | ANKESA | NJOFTIME | KONTRATA | KONKURSE | RAPORTE | PLANE | RREGULLORE | MARRËVESHJE | TE TJERA | SHKRESA TE PRANUARA |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | 42 | 13 | 1 | 3 | 24 | 2 | 2 | 1 | 0 | 1 | 6 | 2 |

N gjate këtij viti kemi pranuar dy shkresa nga gjykatat për dy rastet qe jemi ne kontest, rastin e Arben Veliu dhe Dardan Isufi, te cilat janë ne proces.

## XI. PËRFUNDIMI

NPL "Eko Natyra" Sh. A. edhe gjatë vitit 2023 ka vazhduar të funksionoj sipas planifikimeve të prezantuar dhe aprovuara me Planin e Biznesit 2023.

Pengesat për zhvillimin e ndërmarrjes ku ne dëshirojmë vazhdojnë të ndikohen nga faktorë të ndryshëm, duke filluar nga ata financiar, teknik dhe operativ, mirëpo ne do angazhohemi maksimalisht me profesionalizëm dhe integritet ne përmirësimin e gjendjes duke përmirësuar apo edhe eliminuar këta faktor qe mos te jenë ndikues në zhvillimin e ndërmarrjes e te na përcjellin ne vazhdimësi prej viti ne vit.

Ne do angazhohemi ne një fryme ekipore me te gjithë menaxhmentin dhe kapacitetet qe kemi brenda resurseve njerëzore, qe ne vitet ne vijim te kemi një performancë shumë me te lartë në zhvillimin e ndërmarrjes .

Kryeshefi Ekzekutiv

Shemsi Maksuti

NPL Eko Natyra SH.A. SKENDERAJ

Pyetje për drejtorin e DKA-se, Kastriot Duraku,:
1. Pyetje rreth parregullsive qe kane ndodhur me shpërndarjen e bursave.
2. Pyetje rreth skandalit te drejtoreshës ne gjimnazin "Hamez Jashari".
3. Pyetje rreth skandalit te po kësaj drejtoreshe për lëshimin e fletëkalimeve.

**Abdulla Gashi**-IDEAL

---

Për drejtorinë e Urbanizmit,
1.Kur pritet të fillojnë punimet për rregullimin e ujërave të zeza në F.Polac?
2.Rrugët e trasuara tashmë dy vite më parë në Polac, por edhe pjesët tjera ku ka nevojë, kur pritet te asfaltohen?

**Liridona Koci,** Këshilltare Komunale, PDK